

**LIGJ**  
**Nr. 9643, datë 20.11.2006**

**“PËR PROKURIMIN PUBLIK”**

**...dhe aktet nënligjore në zbatim të tij**

## **Përmbledhje**

- **Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar);**
- **VKM Nr.184, datë 17.3.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të prokurimit publik dhe për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, më mjete elektronike”(i ndryshuar);**
- **VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar);**
- **VKM Nr.918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”(i ndryshuar).**
- **VKM Nr. 521, datë 20.9.2017 “Për miratimin e procedurës për përzgjedhjen ekandidaturave për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”**
- **Vkm Nr. 81, datë 14.2.2018 “Për krijimi, organizimin dhe funksionimin e Agjensisë së Blerjeve të Përqëndruara”**

Nr. 9643, datë 20.11.2006

## PËR PROKURIMIN PUBLIK

### I azhnuar me:

- Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007
- Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007
- Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009
- Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010
- Ligjin Nr. 22/2012, datë 01.03.2012
- Ligjin Nr. 131/2012, datë 27.12.2012
- Ligjin Nr. 182/2014, datë 24.12.2014
- Ligjin 47/2017, datë 13.4.2017

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

#### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.
2. Qëllimi i këtij ligji është:
  - a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
  - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
  - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
  - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
  - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
  - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

##### Neni 2

##### Parimet e përzgjedhjes

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;
- c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

### **Neni 3** **Përkufizime**

Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Procedurat përzgjedhëse të prokurimit” janë procedurat e ndërmarrja nga autoritetet kontraktore për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime.
2. “Kontratat publike” janë kontratat me shpërblim, të lidhura nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj.
- 2/1. “Kontratat sektoriale” janë kontrata publike, të lidhura nga autoritetet kontraktore, që veprojnë në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe atij postar, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë, që kanë si qëllim kryerjen e veprimtarive, të përcaktuara në nenin 58/1 të këtij ligji.
3. “Kontratat e konsulencës” janë kontratat për shërbime publike konsulence, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përjashtuar llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë.
4. “Fondet publike” janë:
  - a) çdo vlerë monetare e Buxhetit të Shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;
  - b) çdo vlerë monetare e buxhetit vendor, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;
  - c) fonde ndihme ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën kërkohet zbatimi i procedurave të këtij ligji;
  - ç) të ardhura nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit.
5. “Kontratrat publike për shërbime” janë kontratat publike që kanë objekt kryerjen e shërbimeve. Kontrata publike, që ka si objekt mallra dhe shërbime, vlerësohet si “kontratë publike për shërbime”, nëse vlera e shërbimeve në kontratë tejkalon atë të mallrave në të njëjtën kontratë. Kontratrat publike, që kanë objekt shërbimet, por që përfshijnë edhe punime të lidhura në mënyrë dytësore me objektin kryesor të kontratës, vlerësohen “kontrata publike për shërbime.
6. “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si “kontratë publike furnizimi”, nëse vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit.
7. “Mall” është çdo gjë materiale me vlerë ekonomike.
8. “Kontratrat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.
- 8/1. “Marrëveshje kuadër” quhet një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve kontraktore dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara”.
9. “Punim” është përfundimi i ndërtimit ose i veprave civile, që përmbushin një funksion ekonomik ose teknik.
10. “Sistem dinamik blerjeje” është një procedurë, tërësisht elektronike, blerjeje mallrash të zakonshme në treg, që përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktor, me afat të kufizuar dhe e

hapur për çdo operator ekonomik, që përmbush kriteret e përzgjedhjes e që paraqet një ofertë në përputhje me specifikimet.

**11.** “Blerje elektronike” është procesi që përfshin një mënyrë elektronike për paraqitjen e çmimeve të reja, të ndryshimeve dhe/ose vlerave të reja mbi elemente të veçanta të ofertës dhe që kryhet pas vlerësimit paraprak të ofertave, duke i klasifikuar ato nëpërmjet metodave të vlerësimit automatik. Disa lloje kontratash shërbimi dhe disa lloje kontratash pune, që kanë si objekt kryesor punën intelektuale, nuk mund të jenë objekt i blerjes elektronike.

**12.** “Kontraktues”, “furnizues” dhe “sipërmarrës i shërbimit” është çdo person fizik, juridik apo ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla, që ofrojnë në treg sipërmarrjen e një ose disa punëve, furnizimin me mallra ose shërbime.

**13.** “Operatorë ekonomikë” janë të gjithë kontraktuesit, furnizuesit dhe sipërmarrësit e shërbimeve, pa bërë dallim ndërmjet tyre.

a) “Ofertues” është operatori ekonomik, që paraqet një ofertë në një prokurim publik.

b) “Kandidat” është operatori ekonomik, që kërkon të ftohet në një procedurë të kufizuar ose të negociuar prokurimi publik.

**14.** “Autoritet kontraktor” është çdo ent, që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. Këto ente janë:

a) institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet qendrore të pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore;

b) çdo ent:

i) themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar;

ii) i cili ka personalitet juridik;

iii) i financuar kryesisht nga shteti, autoritetet rajonale apo vendore, ose nga ente të tjera publike apo i administruar prej tyre ose me një bord administrativ, manaxherial apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve të tyre emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga entet e tjera publike;

c) organizatat e formuara nga një ose disa nga këto autoritete apo nga një ose disa nga këto organe publike;

ç). (shfuqizuar)

**14/1.** “Autoritet kontraktor” është edhe:

a) çdo autoritet kontraktor, siç është përcaktuar në pikën 14, kur ai kryen secilën prej veprimtarive të parashikuara në nenin 58/1 të këtij ligji;

b) sipërmarrja publike, nëse kontrata shpallet fituese për qëllime të ushtrimit të secilës prej veprimtarive të parashikuara në nenin 58/1. Për qëllim të kësaj dispozite, “sipërmarrje publike” është çdo sipërmarrje, mbi të cilën autoritetet kontraktore, të parashikuara në pikën 14, mund të ushtrojnë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, një ndikim dominues, për shkak të pronësisë që kanë mbi të, pjesëmarrjes së tyre financiare në të apo nëpërmjet rregullave që e qeverisin atë. Ndikim dominues vlerësohet kur autoritetet

kontraktore, të renditura në pikën 14, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në lidhje me një sipërmarrje:

i) kanë shumicën e kapitalit të nënshkruar të sipërmarrjes; ose;

ii) kontrollojnë shumicën e votave të lidhura me aksionet e lëshuara prej sipërmarrjes; ose iii) mund të emërojnë më tepër se gjysmën e trupit administrativ, manaxherial apo mbikëqyrës të autoritetit;

c) çdo ent tjetër, që nuk është përmendur në shkronjat “a” e “b”, kur kryen njërin prej veprimtarive të parashikuara në nenin 58/1 të këtij ligji ose kryen një kombinim të tyre, mbështetur në të drejtat e veçanta apo ekskluzive, të dhëna nga një autoritet përgjegjës.”

15. “Të drejta të veçanta apo ekskluzive” janë të drejtat e dhëna nga një autoritet përgjegjës i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet dispozitave legislative, rregullatore apo administrative, efekti i të cilave është të kufizojë ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 58/1 të këtij ligji, për një apo më shumë ente, e që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në aftësinë e enteve të tjera për të kryer atë veprimtari.”

16. “Organ qendror blerës” është autoriteti kontraktor, i cili:

a) siguron për autoritetet kontraktore mallra dhe/ose shërbime;

b) përzgjedh fituesit për kontrata publike për punime, mallra ose shërbime, të caktuara për autoritetet kontraktore.

17. “Procedurë e hapur” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik i interesuar mund të dorëzojë një ofertë.

18. “Procedurë e kufizuar” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor mund të dorëzojnë oferta.

19. “Procedurë me negociim” është procedura, përmes së cilës autoriteti kontraktor i përzgjedh vetë operatorët ekonomikë dhe negociacion kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre.

20. “Kërkesë për propozim” është procedura, me anë të së cilës autoriteti kontraktor kërkon oferta nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë të përzgjedhur prej tij, por pranon edhe oferta të paraqitura nga operatorë të tjerë ekonomikë, të interesuar<sup>9</sup>. 21. “Konkurs projektimi” është procedura, përmes së cilës autoriteti kontraktor përzgjedh me anë të një jurie, me konkurs, një studim ose projekt, që ka vetëm natyrë estetike.

22. “Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike.

23. “Mënyrë elektronike” është përdorimi i pajisjeve elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave (përfshirë këtu edhe përpunimin dixhital) që transmetohen, jepen e merren përmes kablllove, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik.

24. “Rregullat e prokurimit” janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

25. “Buletini i Njoftimeve Publike” është botimi ku publikohen prokurimet publike të nxjerra nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe njoftime të tjera publike.

26. “Dokumentet e tenderit” janë dokumentet, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave.

27. “Informacion” është dokumenti dhe informacioni për procedurat që, sipas kërkesës, i vihen në dispozicion çdo ofertuesi apo kandidati, i cili kundërshton një ose më shumë vendime të autoritetit kontraktor të marra gjatë procedurave të prokurimit. Dhënia e informacionit mund të kufizohet deri në atë masë që nevojitet për të përmbushur detyrimet e fshehtësisë apo të masave të sigurisë.

28. “Kufi monetar” është vlera monetare, sipas së cilës, në përputhje me këtë ligj apo me rregullat e prokurimit publik, përcaktohet procedura e prokurimit që do të përdoret nga autoriteti kontraktor.

29. “Shërbime postare” quhen ato shërbime, që kanë të bëjnë me zhdoganimin, klasifikimin, përcaktimin e itinerareve dhe dorëzimin e artikujve postarë.

30. “Artikull postar” është çdo artikull i adresuar në formën e tij përfundimtare, në të cilën do të transportohet, pavarësisht peshës. Përveç artikujve të korrespondencës, artikuj të tillë përfshijnë,

për shembull, edhe librat, katalogët, gazetatat, periodikët dhe pakot postare, me mallra, me apo pa vlerë tregtare, pavarësisht peshës.”

#### **Neni 4**

##### **Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji 12.

#### **Neni 5**

##### **Prokurimet për mbrojtjen kombëtare**

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes kombëtare, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në rastet e mëposhtme:

a) kur autoriteti kontraktor rrezikon të botojë të dhëna, që mund të cenojnë interesat thelbësorë të sigurisë kombëtare;

b) për blerjen e armëve, të municioneve dhe materialeve luftarake e të shërbimeve të lidhura me to. Ky përjashtim nuk duhet të ndikojë negativisht në konkurrencën e lirë për produktet që nuk u shërbejnë qëllimeve të mirëfillta ushtarake;

c) në raste të veçanta, të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, konflikte të armatosura, operacione luftarake, stërvitje ushtarake dhe pjesëmarrje në misione ushtarake jashtë shtetit.

#### **Neni 6**

##### **Kontratat sekrete, kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit**

Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësorë të shtetit.

#### **Neni 7**

##### **Përjashtimet e veçanta**

Ky ligj nuk zbatohet në kontratat e shërbimit publik për:

a) blerjen ose qiranë me çdo mjet financiar të pasurive të paluajtshme apo të të drejtave mbi to. Bëjnë përjashtim kontratat për shërbime financiare, të lidhura në atë çast, para ose pas kontratës së blerjes ose të qirasë së çdo forme, të cilat i nënshtrohen këtij ligji; b) blerjen, zhvillimin, prodhimin, bashkëprodhimin e programeve ose të reklamave për transmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi;

c) shërbime arbitrazhi dhe ndërmjetësimi, shërbimet e përfaqësimit nga avokati në arbitrazh dhe në proceset gjyqësore, shërbimet noteriale, avokatët e caktuar kryesisht, si dhe ekspertizës për nevoja të procedimit penal, rregulluar sipas Kodit të Procedurës Penale.

ç) shërbimet financiare për shitjen, blerjen apo transferimin e titujve ose instrumenteve të tjera financiare, veçanërisht veprimet e autoritetit kontraktor për akumulimin e vlerave monetare apo të kapitalit, si dhe shërbimet e bankës qendrore;

d) shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit, rezultatet e të cilave shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm autoritetit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme dhe me kusht që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet kontraktor.

dh) shërbimet e parashikuara në nenet 58/3, 58/4, 58/5, 58/6, 58/7 të kreut V/1 “Zhvillimi i procedurave për kontratat sektoriale.”

e) kontratat e punësimit.

Rastet përjashtimore, sipas shkronjave “a” deri në “e”<sup>17</sup> të këtij neni, rregullohen me akte të tjera ligjore ose nënligjore.

## **Neni 8**

### **Detyrimet ndërkombëtare**

Në rast se ky ligj bie ndesh me një detyrim që shteti ka në bazë të një marrëveshjeje me një ose më shumë shtete të tjera apo me një organizatë ndërkombëtare, atëherë zbatohen dispozitat e marrëveshjes në fjalë. Në të gjitha rastet e tjera, procedurat e prokurimit publik i nënshtrohen këtij ligji.

## **Neni 9**

### **Kontratat e shërbimit, të shpallura fituese në bazë të së drejtës ekskluzive.**

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e shërbimit publik, të lidhura nga një autoritet kontraktor me 18 një autoritet tjetër kontraktor ose bashkim autoritetesh kontraktore, bazuar në një të drejtë ekskluzive, që ata gëzojnë sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 10**

### **Shërbimet e konsulencës.**

Shërbimet e konsulencës shpallen në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe në rregullat e prokurimit publik.

## **Neni 11**

### **Blerja e përqendruar**

1. Kur më shumë se një autoritet kontraktor ka nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund:

a) t’i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, punimeve apo shërbimeve, në emër të të tjerëve;

b) ta udhëzojnë organin qendror blerës, të krijuar në përputhje me rregullat e prokurimit, të kryejë procedurat përkatëse të përzgjedhjes së fituesit të kontratës.

2. Autoriteti kontraktor mund t’i kërkojë organit qendror blerës të kryejë një procedurë të caktuar të përzgjedhjes së fituesit ose një sërë procedurash të tilla në emër të tij, kur blerja e përqendruar do të ishte më e leverdishme për shkak të rritjes së sasisë së kërkuar për furnizimet me mallra të ngjashme dhe kushte të ngjashme sipas tregut. Në kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së fituesit, organi qendror blerës zbaton dispozitat e këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave, me kërkesën e një autoriteti kontraktues ose me nismën e vet, mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet tjetër kontraktues si organ qendror blerës.

## **Neni 11/1**

### **Marrëveshja publike kuadër**

**(shfuqizuar)**

## **KREU II**



## **ORGANIZIMI I PROKURIMIT PUBLIK**

### **Neni 12**

#### **Përgjegjësia e autoritetit kontraktor**

**1.** Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij. **2.** Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

- a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
- b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;
- c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;
- ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
- d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
- dh) vlerën ose mënyrën e përllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
- e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
- ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
- f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;
- g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

**3.** Autoriteti kontraktor administron për të gjitha procesverbalet për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit.

**3/1.** Në rastin e prokurimit elektronik, raporti i realizuar nga vetë sistemi, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit me mjete elektronike, bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

**4.** Autoriteti kontraktor çdo 4 muaj duhet të dorëzojë në Agjencinë e Prokurimit Publik një raport për veprimtaritë e tij të prokurimit. Formatit dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen në rregullat e prokurimit.

**5.** Autoriteti kontraktor krijon njësi prokurimi brenda strukturës së vet, detyrat e përgjegjësive të së cilës përkufizohen në rregullat e prokurimit publik. Autoritetet kontraktore mund të kërkojnë mbështetje në formën e këshillave dhe udhëzimeve nga Agjencia e Prokurimit Publik gjatë krijimit të njësive të tyre të prokurimit, të veçanta ose të përbashkëta.

### **Neni 13**

#### **Agjencia e Prokurimit Publik**

**1.** Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit.

**2.** Agjencia e Prokurimit Publik:

- a) paraqet në Këshillin e Ministrave propozime për rregullat e prokurimit;
- b) nxit dhe organizon kualifikimin e punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;

c) harton dhe nxjerr Buletinin e Njoftimeve Publike, siç është përshkruar në rregullat e prokurimit. Agjencia e Prokurimit Publik shpall në Buletinin e Njoftimeve Publike listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar, në përputhje me nenin 45 të këtij ligji;

ç) harton dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik;

ç) (shfuqizuar)

d) në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi;

dh) paraqet një raport vjetor në Këshillin e Ministrave për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik;

e) bashkëpunon me institucionet ndërkombëtare dhe me ente të tjera të huaja për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik;

ë) planifikon dhe bashkërendon ndihmën teknike të huaj për Shqipërinë në fushën e prokurimit publik;

f) nxit dhe mbështet përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve;

g) verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, shqyrton rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit, si dhe monitoron mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore.

gj) (shfuqizuar)

h) (shfuqizuar)

i) në rast shkeljesh të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjoba sipas nenit 72 të këtij ligji ose i propozon drejtuesit të autoritetit kontraktor apo organeve më të larta masa disiplinore për personat e autoriteteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje;

j) (shfuqizuar)

k) harton dhe përshtat rregulloret e saj të brendshme kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me ligj.

**3.** Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për:

a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, përcaktuar në nenet 45 e 46 të këtij ligji;

b) veprime korruptive të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2633 të këtij ligji;

c) dënime për vepra penale, të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji;

ç) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit;

d) kur ka një vendim të formës së prerë të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta<sup>35</sup>.

**4.**(shfuqizuar)

**5.** Nëpunësit e Agjencisë së Prokurimit Publik gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa stafi ndihmës<sup>37</sup> emërohet nga Drejtori i Agjencisë dhe statusi i tyre rregullohet me Kodin e Punës.

**Avokati i Prokurimeve**  
(shfuqizuar)

**Neni 15**  
**Zgjedhja e Avokatit të Prokurimeve**  
(shfuqizuar)

**Neni 16**  
**Papajtueshmëritë me funksionet e Avokatit të Prokurimeve**  
(shfuqizuar)

**Neni 17**  
**Mbarimi i funksionit të Avokatit të Prokurimeve**  
(shfuqizuar)

**Neni 18**  
**Raportimi**  
(shfuqizuar)

**Neni 19**  
**Personeli dhe buxheti i Avokatit të Prokurimeve**  
(shfuqizuar)

**Neni 19/1**  
**Komisioni i Prokurimit Publik**

1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.
2. Komisioni i Prokurimit Publik është person juridik publik, i pavarur, që financohet nga Buxheti i Shtetit.
3. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

**Neni 19/2**

**Përbërja, zgjedhja dhe mandati i Komisionit të Prokurimit Publik**

1. Komisioni i Prokurimit Publik përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët një kryetar dhe një nënkryetar.
2. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik emërohen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave.
3. Këshilli i Ministrave publikon njoftimin për aplikim, të paktën, gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të kryetarit apo anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik dhe/ose jo më vonë se 30 ditë nga dita e përfundimit të parakohshëm të mandatit, sipas nenit 19/5. Këshilli i Ministrave, pasi shqyrton aplikimet e paraqitura dhe verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret për

emërim, i dërgon Kuvendit listën e kandidatëve të kualifikuar sipas renditjes, si dhe listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për emërim.

**4.** Gjatë përzgjedhjes së kryetarit dhe/ose anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, Kuvendi nuk është i detyruar të ndjekë renditjen e paraqitur nga Këshilli i Ministrave. Nëse vlerësohet e nevojshme, Kuvendi ka të drejtë të ftojë për intervistë kandidatët që plotësojnë kriteret për emërim.

**5.** Nënkryetari i Komisionit të Prokurimit Publik duhet të ketë diplomë në drejtësi dhe zgjidhet me një shumicë votash të të gjithë anëtarëve në mbledhjen e parë të këtij Komisioni. Në rast të largimit nga detyra të nënkryetarit, për ndonjë nga shkaqet e parashikuara në këtë ligj, Komisioni, me plotësimin e numrit të anëtarëve të tij, mblidhet për të përzgjedhur nënkryetarin e ri.

**6.** Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik kanë një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

**7.** Anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik përfitojnë pagë mujore dhe/ose shpërblime të tjera financiare në të njëjtën masë me gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

**8.** Kryetari dhe nënkryetari i Komisionit të Prokurimit Publik përfitojnë një pagë mujore, respektivisht 10 për qind dhe 5 për qind më të lartë se anëtarët e tjerë.

**9.** Kryetari dhe/ose, në mungesë të tij, nënkryetari, përfaqëson Komisionin e Prokurimit Publik në marrëdhënie me të tretët, si edhe në marrëdhënie me institucionet dhe organizmat e tjerë, vendas apo të huaj.

**10.** Rregullat e detajuara mbi procedurën përzgjedhëse, sipas pikës 3, të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

### **Neni 19/3**

#### **Kriteret për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik**

**1.** Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar;

b) ka arsim të lartë në drejtësi; c) me përjashtim të nënkryetarit, njëri prej anëtarëve mund të ketë diplomë në inxhinieri, ekonomi apo ndonjë fushë të ngjashme;

ç) ka mbi 8 vite përvojë pune, nga të cilat, të paktën, 3 vite në fushën e prokurimeve.

**2.** Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar;

b) ka arsim të lartë në drejtësi;

c) ka mbi 8 vite përvojë pune, nga të cilat, të paktën, 3 vite në fushën e prokurimeve dhe, të paktën, 2 vite në një pozicion drejtues.

**3.** Nuk mund të zgjidhet anëtar apo Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik, personi që: a) ka qenë i/e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; b) është larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore ose ka ndonjë masë disiplinore në fuq

### **Neni 19/4**

#### **Papajtueshmëritë e funksionit të anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik**

Funksioni i Kryetarit dhe i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik është i papajtueshëm me:

a) anëtarësimin në partitë politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre;

- b) administrimin apo drejtimin e shoqërive tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi;
- c) çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies dhe/ose veprimtarive kërkimore shkencore.

### **Neni 19/5**

#### **Mbarimi i funksionit të anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik**

1. Funksioni i Kryetarit dhe anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik mbaron me përfundimin e mandatit ose para kohe kur:
  - a) jep dorëheqjen;
  - b) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - c) është, për një periudhë 6-mujore, në pamundësi fizike për të ushtruar detyrën dhe/ose humbet përfundimisht aftësinë për të ushtruar detyrën.
2. Kryetari apo anëtari i Komisionit të Prokurimit Publik shkarkohet nga Kuvendi, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë, si më poshtë:
  - a) për shkelje të dispozitave të këtij ligji apo të akteve të tjera ligjore;
  - b) për kryerjen e një veprimtarie që krijon konflikt interesash, në përputhje me legjislacionin që rregullon konfliktin e interesave;
  - c) nëse zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të tij.
3. Në rastin e konstatimit të njëres prej shkeljeve, sipas pikës 2, të këtij neni, Kuvendi, me propozim të komisionit parlamentar përgjegjës, pezullon nga detyra kryetarin apo anëtarin, për të cilin është konstatuar shkelja, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë.

### **Neni 19/6**

#### **Struktura dhe organika e Komisionit të Prokurimit Publik**

1. Struktura dhe organika e Komisionit të Prokurimit Publik miratohen nga Kuvendi, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar.
2. Numri i punonjësve dhe buxheti i Komisionit të Prokurimit Publik miratohen nga Kuvendi, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Punonjësit e Komisionit të Prokurimit Publik gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa personeli ndihmës emërohet nga kryetari dhe marrëdhëniet e tyre të punës rregullohen nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë

### **Neni 19/7**

#### **Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik**

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura prej tij kur në mbledhje janë të pranishëm, të paktën, 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari apo nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.
2. Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative, në përputhje me nenin 64/3 të këtij ligji.
3. Në përfundim të shqyrtimit, vendimi i marrë nga Komisioni, përveç palëve në proces u bëhet i njohur edhe subjekteve të tjera që preken nga ky vendim, si edhe publikohet në faqen e internetit të këtij institucioni, brenda 2 ditëve nga dalja e tij.

4. Askush nuk duhet të ndikojë mbi anëtarët e komisionit në vendimmarrje. Çdo përpjekje, e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, për të ndikuar, dënohet me gjobë, sipas këtij ligji, pavarësisht procedimit civil apo penal, që mund të ketë filluar.

5. Rregullat e hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik miratohen nga vetë Komisioni me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.”.

### **Neni 19/8**

#### **Përfshirja nga shqyrtimi i ankesave i kryetarit, anëtarëve apo punonjësve**

1. Kryetari, anëtarët apo punonjësit e Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të marrin vendim apo të marrin pjesë në procesin vendimmarrës lidhur me një ankesë, në rastet kur ata kanë ndonjë lidhje ose marrëdhënie çfarëdo me ankimuesin apo operatorin ekonomik, përfaqësuesin ligjor ose të autorizuar prej tij apo me përfaqësuesit ligjorë, ndonjë nga anëtarët e strukturave administrative apo mbikëqyrëse të ankimuesit, ose me stafin përgjegjës të autoritetit kontraktor, përfshirë këtu marrëdhënie biznesi apo marrëdhënie familjare të drejtpërdrejtë ose farefisnore deri në shkallë të dytë, lidhje martesore, edhe në rast divorci ose marrëdhënie krushqie deri në shkallë të dytë, si edhe në rast të verifikimit të shkaqeve të tjera për përfshirje, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Kryetari, anëtarët apo punonjësit e Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të marrin vendim apo të marrin pjesë në procesin vendimmarrës lidhur me një ankesë në rastet kur ata kanë qenë të punësuar më parë nga autoriteti kontraktor apo operatori ekonomik palë në proces, pa kaluar, të paktën, 2 vjet nga përfundimi i marrëdhënieve të punës.

3. Palët e interesuara kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen e kryetarit, anëtarëve apo punonjësve të Komisionit të Prokurimit Publik nga marrja e vendimit apo procesi vendimmarrës lidhur me një ankesë të paraqitur, kur konstatojnë një nga rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni. Në këtë rast, vendimi për përfshirjen e një anëtari apo një punonjësi të Komisionit të Prokurimit Publik merret nga kryetari, ndërsa vendimi për përfshirjen e kryetarit merret nga Komisioni i Prokurimit Publik, i kryesuar nga nënkryetari, me shumicë votash.

### **Neni 19/9**

#### **Raportimi**

1. Komisioni i Prokurimit Publik përgatit raportin vjetor, i cili i prezantohet Kuvendit nga kryetari në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës.

2. Përmbajtja e detajuar e raportit vjetor do të përcaktohet në rregullat e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik. Raporti vjetor duhet të përmbajë, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

a) numrin total të ankimeve dhe vlerën e tyre për secilin autoritet kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi;

b) numrin total të ankimeve të refuzuara dhe vlerën e tyre, për secilin autoritet kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi;

c) numrin total të ankimeve të pranuar dhe vlerën e tyre për secilin autoritet kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi;

ç) numrin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik të ankimuara në gjykatën administrative;

d) kushtet për pranimin e ankimeve dhe arsyet më të zakonshme për paraqitjen e ankimeve;

dh) informacion mbi problematikat e identifikuara në funksionimin e sistemit të ankimit për prokurimin publik.

3. Me kërkesë të Kuvendit, Komisioni i Prokurimit Publik mund të raportojë edhe për periudha më të shkurtra kohore apo për çështje të caktuara.

4. Raporti vjetor i Komisionit të Prokurimit Publik publikohet në faqen e internetit të këtij institucioni.”.

### **KREU III RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROKURIMIT**

#### **Neni 20**

Mosdiskriminimi Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

#### **Neni 21**

##### **E drejta për informim**

1. Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2. Autoriteti kontraktor vë në dijeni<sup>56</sup> jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit:

a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në tender; b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;

c) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për klasifikimin e ofertave së përzgjedhur.

3. Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet kontraktore mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cenon interesin publik apo interesat ligjorë dhe ekonomikë të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë.

#### **Neni 22**

##### **Format e komunikimit**

1. I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në këtë ligj bëhen me shkrim ose me mjete elektronike.

2. Në rastet kur autoriteti kontraktor komunikon në formë elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese, të disponueshme dhe të ndërperueshme me produktet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht. Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

3. Në rast se komunikimi ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe autoritetit kontraktor kryhet në ndonjë formë tjetër, të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë nen, përmbajtja e tij duhet të dokumentohet menjëherë me shkrim.

4. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje. Forma e përdorur për komunikim, shkëmbim dhe ruajtjen e informacionit duhet të

garantojë se autoriteti kontraktor mund të shqyrtojë përmbajtjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati ligjor për dorëzimin e tyre, i përcaktuar nga ky ligj.

## **Neni 23**

### **Specifikimet teknike**

**1.** Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

**2.** Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

**3.** Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj."

**4.** Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.

Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

**5.** Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

## **Neni 24**

### **Anulimi i një procedure prokurimi**

**1.** Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:



- a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;
  - b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;
  - c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;
  - ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;
  - d) nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;
  - dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji<sup>64</sup>.
- 2.** Autoriteti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve, që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.
- 3.** Në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, autoriteti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.
- 4.** Autoriteti kontraktor boton njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është botuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë<sup>65</sup> nga marrja e vendimit për anulim

## **Neni 25**

### **Fshehtësia e procesit**

Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

## **Neni 26**

### **Veprimet korruptive dhe konflikti i interesave**

- 1.** Autoriteti kontraktor refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje në tender nëse:
- a) ofertuesi apo kandidati i jep ose premtion t’i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari apo punonjësi një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim apo procedurë, që ndërmerr autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit;
  - b) ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit. Refuzimi dhe arsyet për një veprim të tillë duhet të pasqyrohen në procesverbalet e procedurave të prokurimit, sipas nenit 12 të këtij ligji dhe duhet t’i komunikohet, menjëherë dhe zyrtarisht, kandidatit ose ofertuesit në fjalë. Vendimi mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.
- 2.** Vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, nuk pengojnë kallëzimin penal në organet përkatëse, kur aktet apo veprimet në fjalë përbëjnë vepër penale.
- 3.** Në rast se në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara

këtij momenti, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit

### **Neni 27**

#### **Kufijtë monetarë**

1. Për qëllimet e këtij ligji zbatohen kufijtë monetarë, si më poshtë:
  - a) kufiri i lartë monetar;
  - b) kufiri i ulët monetar.
2. Kufijtë monetarë përcaktohen në rregullat e prokurimit.
3. Këshilli i Ministrave rishikon kufijtë monetarë çdo dy vjet.

### **Neni 28**

#### **Metodat e përlogaritjes së vlerës në kontratat publike**

1. Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, të përlogaritur nga autoriteti kontraktor në çastin e botimit të njoftimit të kontratës të parashikuar në nenin 38 të këtij ligji ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një botim i tillë. Përlogaritja merr parasysh shumën e plotë të vlerësuar për t'u paguar, duke përfshirë çdo formë obsioni apo rinovimi të kontratës.
2. Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj.
3. Metodat për llogaritjen e vlerës së kontratave publike përcaktohen në rregullat e prokurimit.

### **Neni 29**

#### **Procedurat standarde të prokurimit**

1. Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesve të kontratave publike, zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj. Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:
  - a) procedurë e hapur;
  - b) procedurë e kufizuar;
  - c) procedurë me negociim, me ose pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
  - ç) kërkesë për propozime;
  - d) konkurs projektimi;
  - dh) procedurë "shërbim konsulence"
2. Procedura e hapur mund të përdoret për të gjitha kontratat. Procedura e kufizuar mund të përdoret atëherë kur është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet fazës së përzgjedhjes, ku trajtohet kualifikimi i kandidatëve dhe fazës së përcaktimit të kontratës fituese, ku shqyrtohet oferta. Dallimi ndërmjet procedurës së hapur dhe procedurës së kufizuar bëhet sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor përdor procedurën e hapur dhe procedurën e kufizuar për kontratat mbi kufirin e ulët monetar. Procedura me negociim përdoret vetëm në rrethana të veçanta, siç përcaktohet në nenet 32 e 33 të këtij ligji dhe në rregullat e prokurimit publik.
4. Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim, me ose pa shpallje paraprake dhe kërkesën për propozime për kontratat me vlerë më të ulët se kufiri i ulët monetar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.
5. Për prokurimet me vlerë të vogël, nën kufirin e ulët monetar, të mallrave, shërbimeve apo punëve, autoritetet kontraktore mund të përdorin procedura të thjeshtuara, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

### **Neni 30**

#### **Procedura e hapur**

1. Procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurimet.
2. Në procedurën e hapur autoriteti kontraktor boton një njoftim, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji, i cili përmban një përshkrim të objektit që do të prokurohet dhe rregullat e veçanta procedurale.
3. Të gjithë ofertuesit e dorëzojnë ofertën e tyre, përkatësisht, ofertën ekonomike, ofertën teknike dhe provën për përmbushje të kriterëve përzgjedhëse, sipas kërkesave të neneve 45 e 46 të këtij ligji.
4. Pas mbarimit të afatit maksimal për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në njoftimin e kontratës, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, autoriteti kontraktor hap ofertat, verifikon kualifikimet apo mangësitë e ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 45 e 46 të këtij ligji dhe përzgjedh kontratën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 55 të këtij ligji.

### **Neni 31**

#### **Procedura e kufizuar**

1. Procedura e kufizuar përdoret nga autoriteti kontraktor për të kryer një prokurim që çon në dhënien e ndonjë kontrate publike, kur:
  - a) malli, shërbimi ose puna përkatëse, për shkak të karakterit të tij/tyre shumë të ndërlikuar ose të veçantë, mund të furnizohen, sigurohen ose ekzekutohen nga operatorë ekonomikë, të cilët kanë kapacitetin e duhur teknik, profesional ose financiar;
  - b) është ekonomikisht më e leverdishme për autoritetin kontraktues, fillimisht, të shqyrtojë kapacitetin dhe kualifikimet e operatorëve të interesuar ekonomikë dhe më pas të ftojë ata që kanë kualifikimet minimale specifike të caktuara të paraqesin ofertat.
2. Në procedurën e kufizuar autoriteti kontraktor boton një njoftim, sipas nenit 38 të këtij ligji, i cili përmban:
  - a) një përshkrim të objektit të kontratës që do të prokurohet;
  - b) një tregues të kriterëve përzgjedhëse, sipas neneve 45 e 46 të këtij ligji;
  - c) një ftesë, për të shprehur interesin për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit;
  - ç) kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, siç përcaktohen në nenin 5571.
3. Pas mbarimit të afatit kohor të shpallur për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të këtij ligji.
4. Më pas autoriteti kontraktor dërgon ftesën për ofertë për kandidatët e përzgjedhur, në përputhje me nenin 40 të këtij ligji, duke u kërkuar atyre të paraqesin ofertat.
5. Pas mbarimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, autoriteti kontraktor hap ofertat dhe përcakton kontratën fituese, në mbështetje të kriterëve të përcaktuara në nenin 55 të këtij ligji.

### **Neni 32**

#### **Procedura me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit**

1. Kur vlera e kontratës së prokurimit është më e lartë se kufiri i ulët monetar, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës kur:

a) në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme, të hapura ose të kufizuara, të gjitha ofertat janë të pavlefshme apo nuk përmbushin kërkesat e dispozitave ligjore kombëtare dhe për sa kohë që në kontratë nuk është bërë ndryshim thelbësor, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik;

b) natyra e punëve, mallrave ose shërbimeve, apo rreziku i lidhur me to nuk lejon përcaktimin paraprak të çmimit të plotë dhe, në veçanti:

i) në rastet e kontratave për shërbime, veçanërisht për shërbime intelektuale, si psh shërbimet, që kanë të bëjnë me projektimin e punëve, për sa kohë natyra e shërbimeve është e pamundur të përcaktohet me saktësi të pranueshme, që të lejojë përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në përputhje me procedurat e tenderit, të hapur ose të kufizuar;

ii) në rastet e kontratave për punë kërkimore, eksperimentimi ose zhvillimi, por jo me qëllime përfitimi apo rimbursimi të kostove të kërkimit e të zhvillimit.

**2.** Kur vlera e kontratës është nën kufirin e ulët monetar, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, sa herë e gjykon të nevojshme, me kusht që të respektohen parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës.

**3.** Autoriteti kontraktor negocion me ofertuesit, për t'i përshtatur ofertat e tyre me kërkesat e përcaktuara në njoftim, me specifikimet dhe dokumentet shtesë, nëse ka të tilla, për të përzgjedhur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

**4.** Autoriteti kontraktor duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit gjatë zhvillimit të dialogut individual me secilin prej tyre. Asnjë informacion diskriminues apo që mund t'u sjellë avantazhe disa ofertuesve mbi të tjerët nuk duhet të bëhet i njohur.

**5.** Autoriteti kontraktor mund të marrë masa që procedura me negociim të kryhet në faza të ndryshme, duke zbatuar kriteret e vlerësimit, të shpallura në njoftim apo në specifikime, për reduktimin e numrit të ofertave që duhen negociuar. Ky obsion, nëse përdoret, duhet të shpallet në njoftim ose në specifikime.

### **Neni 33**

#### **Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit**

**1.** Autoriteti kontraktor, për kontratat me vlerë mbi ose nën kufirin e ulët monetar, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, vetëm në rrethana të veçanta, në përputhje me këtë nen dhe në rregullat e prokurimit publik. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet të çojë në shmangien e konkurrencës ose në diskriminimin e kandidatëve.

**2.** Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për të gjitha llojet e kontratave publike si më poshtë:

a) kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme nuk është siguruar konkurrenca minimale dhe për sa kohë që në kushtet fillestare të kontratës të mos jetë bërë asnjë ndryshim thelbësor<sup>74</sup>;

b) kur për arsye që lidhen me të drejtat ekskluzive ose të drejtat e autorit, kontrata nuk mund të ekzekutohet përveçse nga një operator i vetëm ekonomik;

c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure për rrethohen në rregullat e prokurimit.

ç) për mallrat e kuotuar dhe të blera në bursën e mallrave, në përputhje me rregullat e prokurimit publik;

d) për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lëvrime shumë të shkurtër, ose për një rast veçanërisht të leverdishëm, që paraqitet në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim, dukshëm, më të ulët se çmimet normale të tregut dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik;

dh) (shfuqizuar)

**3.** Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për kontratat e mallrave:

a) në rast se mallrat e kërkuara janë prodhuar vetëm për qëllime kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Këtu nuk përfshihen prodhimi me shumicë, për qëllime tregtare apo për të mbuluar shpenzimet e kërkimit e zhvillimit;

b) për lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm, për zëvendësimin e pjesshëm të lëvrimeve normale ose instalimeve apo si shtesë të mallrave, instalimeve ekzistuese, pasi ndryshimi i furnizuesit do ta detyrojë autoritetin kontraktor të kërkojë mallra me karakteristika të ndryshme teknike, që mund të rezultojnë në papajtueshmëri dhe në vështirësi të mëdha teknike për vënien në punë apo mirëmbajtjen e tyre. Kontrata shtesë, në këtë rast, duhet të nënshkruhet brenda një afati 3-mujor nga përfundimi i kontratës kryesore.

**4.** Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për kontratat e shërbimit me kandidatin e suksesshëm, të dalë pas përfundimit të konkursit të projektimit, sipas nenit 35 të këtij ligji.

**5.** Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për kontratat e punëve dhe të shërbimeve:

a) për punë apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, janë bërë të domosdoshme, me kusht që t'i jepen operatorit ekonomik, që realizon këto ndërtime apo shërbime, si dhe kur vlera e punës dhe/ose shërbimeve shtesë nuk e tejkalon 20 për qind të vlerës së kontratës fillestare:

i) kur ndërtimet apo shërbimet suplementare nuk mund të ndahen nga kontrata fillestare, pa shkaktuar vështirësi të mëdha, teknike e ekonomike, për autoritetin kontraktor;

ii) kur këto ndërtime e shërbime, edhe pse të ndara nga kontrata fillestare, janë të domosdoshme për përmbushjen e saj.

b) për ndërtime apo shërbime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e ndërtimeve apo të shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti kontraktor i ka akorduar kontratën fillestare, me kusht që këto ndërtime ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është shpallur fitues i kontratës fillestare me procedurën e hapur ose të kufizuar. Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të përfshihet në njoftimin e kontratës fillestare dhe autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë koston e përgjithshme të përllogaritur të ndërtimeve ose shërbimeve në vijim. Procedura e mësipërme mund të përdoret vetëm brenda 3 viteve nga lidhja e kontratës fillestare. Në çdo rast shtesa e kontratave nuk duhet të kalojë vlerën 20 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

**6.** Zgjedhja e operatorëve ekonomikë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese. Autoriteti kontraktues, sa më shpesh të jetë e mundur, duhet t'i ndërrojë sipërmarrësit që do të ftojë.

## **Neni 34**

### **Kërkesa për propozime**

**1.** Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e kërkesës për propozim për kontrata me vlerë nën kufirin e ulët monetar. Në bazë të kësaj procedure, autoriteti kontraktor kërkon oferta nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë të zgjedhur prej tij, ose mund të përdorë

komunikimin elektronik të parashikuar në nenin 36 të këtij ligji. Për këtë përzgjedhje kërkohen të ftohen të paktën 5 operatorë ekonomikë, përveç rasteve kur kjo është e pamundur, për arsye teknike ose për mungesë të konkurrencës. Kjo procedurë nuk duhet të përdoret për të shmangur procedurat konkurruese të prokurimit. Në çdo rast autoriteti kontraktor duhet të pranojë oferta nga çdo ofertues tjetër, veç atyre të ftuar nga vetë ai.

2. Kur autoriteti kontraktor përdor komunikimin elektronik, ai duhet të publikojë një njoftim elektronik, sipas nenit 38 pika 4 të këtij ligji dhe të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

### **Neni 34**

#### **Shërbim konsulence**

1. Autoriteti kontraktor, që ndërmerr një procedurë “shërbim konsulence”, njofton qëllimin e prokurimit me anë të botimit të njoftimit të kontratës, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e parashikuar në nenin 39 të këtij ligji.

2. Procedurat e hollësishme të zhvillimit të kësaj procedure prokurimi parashikohen në rregullat e prokurimit.

### **Neni 35**

#### **Konkurs projektimi**

1. Autoriteti kontraktor mund të organizojë konkursin e projektimit, si pjesë e një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese, për një plan apo projekt të zgjedhur nga një juri, mbi bazën e një procedure konkurrimi, kryesisht në fushën e planifikimit urban, rural, arkitektonik, inxhinierik etj.

2. Procedura konkurs projektimi mund të organizohet:

a) si pjesë e një procedure, që shërben për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik;

b) për përfitimin vetëm të projektit kundrejt çmimit.

3. Autoriteti kontraktor që ndërmerr një konkurs projektimi, njofton qëllimin e prokurimit me anë të botimit të njoftimit për pjesëmarrje në konkurs, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e parashikuar në nenin 39 të këtij ligji.

4. Procedurat e hollësishme të organizimit për të dyja format e konkursit të projektimit, sipas pikës 2 të këtij neni, parashikohen në rregullat e prokurimit.

5. Rregullat e konkursit u komunikohen të gjithë të interesuarve, që kërkojnë të marrin pjesë në të. Pjesëmarrja në konkurs mund të kufizohet në një numër kandidatësh të përzgjedhur, në bazë të kriterëve të qarta dhe jodiskriminuese, që u janë bërë të njohura të gjithë personave të interesuar, me kusht që numri i kandidatëve të ftuar, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit, të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një konkurrim të drejtë.

6. Pranimi i pjesëmarrjes në konkurs nuk mund të kufizohet:

a) për shkak të shtetësisë, territorit apo rezidencës;

b) për shkak të qenies person fizik ose juridik.

7. Komisioni krijohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregullat e prokurimit. Ai përbëhet nga persona, që nuk kanë konflikt interesash me pjesëmarrësit në konkurs dhe merr vendime në mënyrë të pavarur, në bazë të kriterëve të përcaktuara në njoftimin për konkurs, duke respektuar parimin e fshehtësisë.

### **Neni 35/1**

#### **Marrëveshjet kuadër**

**1.** Për kontratat publike, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër pas kryerjes së një procedure të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence apo me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, ndërsa për kontratat sektoriale, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër edhe pas kryerjes së një procedure me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit.

**2.** Palët në marrëveshjen kuadër zgjidhen duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, në përputhje me nenin 55 të ligjit.

**3.** Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër lidhen në përputhje me procedurat e parashtruara në pikat 5 e 6 të këtij neni. Këto procedura mund të zbatohen vetëm ndërmjet enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, të cilët kanë qenë që në fillim palë në marrëveshjen kuadër. Kur lidhen kontrata, të bazuara në një marrëveshje kuadër, palët nuk mundën, në asnjë rrethanë, të bëjnë ndryshime thelbësore të kushteve tëparashtruara në marrëveshjen kuadër, veçanërisht në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni.

**4.** Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më e gjatë se katër vjet, përveç rasteve të jashtëzakonshme, plotësisht të justifikueshme, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër.

**5.** Kur një marrëveshje kuadër arrihet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Për prokurimin e këtyre kontratave, autoriteti kontraktor komunikon me shkrim me operatorin palë në marrëveshjen kuadër, duke i kërkuar atij të plotësojë ofertën, në përputhje me kërkesat.

**6.** Kur një marrëveshje kuadër lidhet me disa operatorë ekonomikë, këta të fundit duhet të jenë, të paktën, tre, në numër, për sa kohë që ekziston një numër i mjaftueshëm operatorësh ekonomikë, për të përmbushur kriteret e përzgjedhjes dhe/ose të pranimit të ofertave, që përmbushin kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, në përputhje me nenin 55 të ligjit.

Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, të arritura ndërmjet disa operatorëve ekonomikë, mund të lidhen në një nga këto mënyra:

a) nëpërmjet zbatimit të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimin;

b) kur jo të gjitha kushtet janë të parashtruara në marrëveshjen kuadër, kur palët gjenden sërisht në konkurrim, sipas të njëjtave kushte dhe, nëse është e nevojshme, në bazë të kushteve të formuluar më saktësisht dhe aty ku kjo është e përshtatshme, kur parashikohen kushte të tjera në specifikimet e marrëveshjes kuadër, në përputhje me procedurën në vijim:

i) për çdo kontratë, që do të prokurohet, autoritetet kontraktore duhet të këshillohen, me shkrim, me operatorët ekonomikë, që janë në gjendje të zbatojnë kontratën;

ii) autoritetet kontraktore duhet të caktojnë një kufi kohor, të mjaftueshëm për dorëzimin e ofertave, për secilën kontratë specifike, duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit, që do të prokurohet, dhe kohën e nevojshme për të dorëzuar ofertat;

iii) ofertat do të dorëzohen me shkrim dhe përmbajtja e tyre duhet të mbetet konfidenciale, derisa kufiri i përcaktuar kohor për përgjigje të ketë skaduar;

iv) autoritetet kontraktore do t'ia japin secilën kontratë ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kriterëve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në specifikimet e marrëveshjes kuadër.

**7.** Autoritetet kontraktore nuk mund t'i keqpërdorin marrëveshjet kuadër për të penguar, kufizuar apo çrregulluar konkurrencën.

**8.** Në çdo rast, marrëveshja kuadër zbatohet sipas përcaktimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.

## **KREU IV PROKURIMI ELEKTRONIK**

### **Neni 36**

#### **Rregullat e zbatueshme të komunikimeve elektronike**

**1.** Pa cenuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe dispozitat e nenit 22 të këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, si më poshtë:

a) informacionet, që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, janë në dispozicion të palëve të interesuara. Mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës;

b) ofertat elektronike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik, si dhe për bazat e të dhënave shtetërore; c) përpara përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar për dorëzimin e ofertave ose të kërkesave për pjesëmarrje, ofertuesit marrin përsipër të paraqesin dokumentet, certifikatat dhe dëshmitë, të përmendura në nenet 45 dhe 46 të këtij ligji, nëse këto të fundit nuk ekzistojnë në format elektronik.

**2.** Pa paragjykuar parimin e mosdiskriminimit dhe detyrimet e nenit 22 të këtij ligji, rregullat e mëposhtme zbatohen për nënshkrimin në formë elektronike për gjithçka që ka të bëjë me paraqitjen dhe pranimin e ofertave dhe dokumenteve të lidhura me to:

a) kur ligji i prokurimit publik parashikon nënshkrimin nga ana e një personi, kjo kërkesë quhet e përmbushur për të gjitha dokumentet e tenderit, nëse nënshkrimi elektronik i përdorur është i besueshëm dhe i përshtatshëm për qëllime, për të cilat dokumenti elektronik është krijuar ose është komunikuar, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat konkrete ose në përputhje me ligjet dhe rregullat me aplikim të përgjithshëm për tregtinë në formë elektronike;

b) nënshkrimi në formë elektronike do të konsiderohet i besueshëm dhe në përputhje me këtë ligj nëse:

i) nënshkrimi është i dukshëm dhe brenda materialit për të cilin prezantohet, i lidhur logjikisht me personin që firmos dhe jo me ndonjë person tjetër;

ii) dokumentet origjinale ose të dhënat e përdorura për nënshkrimin në mënyrë elektronike në momentin e firmosjes kanë qenë nën kontrollin ekskluziv të personit që nënshkruan dhe mbeten të tilla gjatë procesit të prokurimeve dhe për një kohë të arsyeshme pas përfundimit të procesit të prokurimit dhe siç parashikohet nga legjislacioni ose rregullat e prokurimit publik;

iii) çdo ndryshim në nënshkrimin elektronik, i bërë pas kohës së firmosjes, mund të dallohet me një kujdes të arsyeshëm;

iv) asnjë nga parashikimet në këtë nen nuk ka për qëllim të kufizojë mundësinë e çdo personi ose operatori ekonomik që, në çdo mënyrë të lejuar nga legjislacioni në fuqi, të provojë apo të kundërshtojë besueshmërinë e nënshkrimit elektronik.

### **Neni 37**

#### **Blerja elektronike dhe sistemi dinamik i blerjes**

Për të kryer një procedurë elektronike prokurimi, autoriteti kontraktor ndjek rregullat e blerjes elektronike dhe të sistemit dinamik të blerjes, të përshkruara në rregullat e prokurimit publik, në



përputhje me legjislacionin në fuqi, me parimet e përmendura në nenin 2 të këtij ligji dhe me standardet ndërkombëtare e europiane.

**Neni 37/1**  
**(shfuqizuar)**

**KREU V**  
**ZHVILLIMI I PROCEDURAVE**

**Neni 38**  
**Njoftimet**

1. Autoriteti kontraktor, që kryen procedura prokurimi për kontrata publike me anë të procedurës së hapur, të kufizuar, me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, kërkesës për propozim ose shërbim konsulence, në përputhje me nenet 30, 31, 32, 34 e 34/1 të këtij ligji, ose kur fillon procedurën për konkurs projektimi, sipas nenit 35 të ligjit, bën njoftimin publik për kryerjen e llojit përkatës të prokurimit publik.
2. Njoftimet për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në të paktën një gazetë me shpërndarje në Europë.
3. Njoftimet për prokurimet me vlerë nën kufirin e lartë monetar, por mbi kufirin minimal monetar botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.
4. Të gjitha njoftimet e prokurimeve shpallen në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

**Neni 39**  
**Përmbajtja e njoftimeve**

1. Në njoftimet që botohen, sipas nenit 38 të këtij ligji, duhet të përfshihen të gjitha informacionet që i lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit.
2. Në njoftimin për procedurë të hapur duhet të përcaktohen edhe vendi, adresa dhe afati i fundit kohor, ku e kur do të dërgohen ofertat, si dhe gjuha ose gjuhët në të cilat duhet të hartohen ofertat. Në njoftim duhet të përcaktohen edhe mënyra dhe kushtet për marrjen e dokumenteve të tenderit, siç parashikohet në nenin 41 të këtij ligji.
3. Përmbajtja e njoftimeve standarde përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

**Neni 40**  
**Ftesa për ofertë**

1. Autoriteti kontraktor fton nëpërmjet një komunikimi me shkrim ose me mjete elektronike njëherësh të gjithë kandidatët e përzgjedhur në procedurën e kufizuar dhe në procedurat me negociim, me njoftim të objektit të kontratës, sipas neneve 31 e 32 të këtij ligji, për të dorëzuar ofertat ose për të negociuar.
2. Ftesa për kandidatët përfshin edhe:
  - a) një kopje të dokumenteve të tenderit dhe çdo dokument tjetër mbështetës;
  - b) një referencë për akses të dokumenteve të tenderit dhe të dokumenteve të tjera, të përcaktuara më sipër me rrugë elektronike.
3. Modelet e ftesës për ofertë apo të ftesës për negociim përshkruhen në rregullat e prokurimit. Ftesa, në çdo rast, duhet të përmbajë të paktën:

- a) një referencë për njoftimin e kontratës që botohet;
  - b) të dhëna për vendin dhe afatin e fundit kohor të paraqitjes së ofertave, si dhe gjuhën ose gjuhët në të cilat duhet të hartohet oferta
  - c) informacion për çdo dokument shtesë që duhet dorëzuar ose në mbështetje të deklaratave të ofertuesve, në përputhje me nenet 45 dhe 46 të këtij ligji, ose për të plotësuar informacionin e përmendur në këto nene;
  - ç) renditjen sipas përparësisë të kriterëve të vendosura për përcaktimin e ofertës fituese, si dhe specifikimet apo dokumentin përshkruar, në rastet kur këto nuk janë botuar në njoftimet e ftesës.
- 4.** Autoriteti kontraktor, kur përdor procedurën e kufizuar dhe procedurën me negociim, fton për të paraqitur ofertë të gjithë kandidatët që kualifikohen në fazën e parë të procedurës. Autoriteti kontraktor mund të vazhdojë procedurën e prokurimit vetëm kur janë të paktën 2 kandidatë, me përjashtim të procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit. Në njoftimin për tender, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kriteret objektive, jodiskriminuese, si dhe rregullat që do të zbatohen.

#### **Neni 41**

##### **Dokumentet e tenderit**

- 1.** Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.
- 2.** Autoriteti kontraktor, kur i kërkohet nga operatorët ekonomikë, do të vërë në dispozicion të të interesuarve dokumentet e tenderit, kundrejt pagesës. Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.”.

#### **Neni 42**

##### **Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit**

- 1.** Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit
- 2.** Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.
- 2/1.** Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.
- 3.** Autoriteti kontraktor, gjatë takimit me operatorët ekonomikë, duhet të mbajë protokoll, ku përfshihen edhe kërkesat e dorëzuara gjatë takimit për sqarime për dokumentet e tenderit, si dhe përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, por, në çdo rast, pa identifikuar burimet e këtyre kërkesave. Ky protokoll duhet t'u vihet menjëherë në dispozicion të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë tërhequr dokumentet e tenderit, që të orientohen në përgatitjen e ofertave.

## Neni 43

### **Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për dorëzimin e ofertave**

**1.** Autoriteti kontraktor, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, të përcaktuar në këtë nen dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera.

**2.** Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 52 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

#### **2.1(shfuqizuar)**

**3.** Në procedurën e kufizuar, në procedurën me negociim, me shpallje të njoftimit, në procedurën shërbim konsulence dhe në procedurën konkurs projektimi, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar:

a) afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 20 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik;

b) në procedurën e kufizuar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 20 ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë te kandidatët.

**4.** Nëse, për çfarëdo arsye, dokumentet e tenderit, dokumentet mbështetëse ose informacionet shtesë, edhe pse të kërkuara në kohën e duhur, nuk paraqiten brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftimin e kontratës, ose nëse ofertat mund të hartohen vetëm pas një vizite në terren, pas një verifikimi të çastit të dokumenteve, në mbështetje të dokumenteve të tenderit, atëherë afatet kohore për dorëzimin e ofertave zgjaten me 10 ditë, me qëllim që të gjithë operatorët ekonomikë të marrin informacionin e nevojshëm për të hartuar ofertat.

**5.** Në procedurën e hapur, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 30 ditë nga dita kur është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

**6.** Në procedurën e kufizuar ose në procedurën me negociim, me shpalljen e njoftimit të kontratës, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar:

a) afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 15 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik;

b) në procedurën e kufizuar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 15 ditë nga data në të cilën është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë;

**6/1.** Në procedurën shërbim konsulence dhe në procedurën konkurs projektimi, me vlerë nën kufirin e lartë monetar:

a) afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 15 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik;

b) afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 15 ditë nga data në të cilën është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë.

**7.** Në rastet e procedurave të prokurimit nën kufirin e ulët monetar, afati kohor minimal për dorëzimin e ofertave është 10 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

**8.** Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore për marrjen e ofertave, të parashikuara në pikat 2 e 5 të këtij neni, për procedura të hapura, mund të shkurtohen 7 ditë, ndërsa afatet kohore për marrjen e kërkesës për pjesëmarrje, të parashikuara

në shkronjat "a" e "b" të pikës 3 dhe në shkronjat "a" e "b" të pikës 6 dhe të pikës 6/1105 të këtij neni, për procedurat e kufizuara, shërbim konsulence, konkurs projektimi106 dhe me negociim, mund të shkurtohen 5 ditë."

#### **Neni 44**

##### **Operatorët ekonomikë**

1. Kandidatët ose ofertuesit, që ofrojnë shërbimet përkatëse, nuk duhet të refuzohen vetëm për shkak se u kërkohet të jenë persona fizikë ose juridikë. Në rastet e kontratave publike për shërbime apo punë, si dhe të kontratave publike të furnizimit për shërbime shtesë dhe/ose veprimtari instalimi, autoritetet kontraktore mund t'u kërkojnë personave juridikë të paraqesin në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit.

#### **Neni 45**

##### **Kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve**

1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga një procedurë prokurimi çdo kandidat ose ofertues, kur ka të dhëna se janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për ndonjë nga veprat e mëposhtme:
  - a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;
  - b) korrupsion;
  - c) mashtrim;
  - ç) pastrim parash, vepra për qëllime terroriste;
  - d) falsifikim
2. Çdo kandidat ose ofertues skualifikohet nga një procedurë prokurimi, në rastet kur:
  - a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;
  - b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;
  - c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
  - ç) **(shfuqizuar)**
  - d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
  - dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
  - e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre
  - ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.
3. Autoriteti kontraktor pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente:

a) vërtetim nga dosja gjyqësore, ose në rast se nuk sigurohet kjo, një dokument të njëvlershëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent, gjyqësor apo administrativ, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikat 1 e 2, shkronjat “a”, “b” e “c”; b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

## **Neni 46**

### **Kualifikimi i ofertuesve**

1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurorhet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.

3. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

## **Neni 47**

### **Raportimi i skualifikimit**

Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës.. Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.

## **Neni 48**

### **Paraqitja dhe pranimi i ofertave**

1. Autoriteti kontraktor përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së ofertave.
2. Kur autoriteti kontraktor jep sqarime ose bën ndryshime në dokumentat e tenderit, vepron në përputhje me nenin 42 të këtij ligji.
3. Vendimi për shtyrje të afatit përfundimtar u njoftohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet.
4. Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë:
  - a) ofertat dorëzohen me shkrim, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf, me përjashtim të rasteve të përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, kur autoriteti kontraktor, sipas kërkesës, pajis ofertuesit me një dëshmi, ku shënohen data dhe ora e pranimit të ofertës;
  - b) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore.
5. Ofertat e marra pas mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së tyre u kthehen të pahapura ofertuesve, që i kanë paraqitur ato

#### **Neni 49**

##### **Sigurimi i ofertës**

1. Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik.
  - a) vlera e sigurimit duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e përlogaritur e kontratës së prokurimit;
  - b) autoriteti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës. Këto kërkesa nuk duhet të lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me sjelljen e ofertuesit që dorëzon një ofertë, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
    - i) tërheqjes ose ndryshimit të ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
    - ii) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
    - iii) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.
- 1/1.(shfuqizuar)**
2. Në rast se autoriteti kontraktor e ka kërkuar sigurimin e ofertës, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk e pretendon vlerën e sigurimit, nëse: 119 a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

#### **Neni 50**

##### **Vlefshmëria, modifikimi dhe tërheqja e ofertave**

1. Ofertat janë të vlefshme gjatë periudhës kohore të specifikuar në dokumentet e tenderit.
2. Autoriteti kontraktor, përpara përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertave, mund t’u kërkojë ofertuesve të zgjasin këtë periudhë për një afat të caktuar. Në këtë rast: a) ofertuesi mund të refuzojë kërkesën, pa humbur sigurimin e ofertës nëse është kërkuar 120 dhe vlefshmëria e ofertës së tij përfundon me mbarimin e periudhës fillestare të vlefshmërisë;
- b) kur ofertuesi pranon zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, me të zgjatet edhe sigurimi i ofertës nëse është kërkuar një sigurim i tillë apo paraqitet një sigurim i ri oferte, që mbulon periudhën e

zgjatur të vlefshmërisë. Ofertuesi, që nuk zgjat periudhën e sigurimit të ofertës ose që nuk paraqet një sigurim të ri oferte, vlerësohet se e ka refuzuar kërkesën për zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

## **Neni 51**

### **Ndalimi i modifikimit të ofertave**

1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji.
2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.
3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 32 dhe 33 të këtij ligji.

## **Neni 52**

### **Hapja e ofertave**

1. Autoriteti kontraktor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas zgjatjes e këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në dokumentet e tenderit.
2. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.
3. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga autoriteti kontraktues, si dhe çmimi i çdo oferte, lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së prokurimit, sipas nenit 12 të këtij ligji.
4. Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.
5. Procesverbali i hapjes së ofertave shpallet në faqen e internetit dhe bëhet i disponueshëm si i gjithë dokumentacioni i tenderit.
6. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, hapja e ofertave bëhet si më poshtë:
  - a) Autoriteti kontraktor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar, të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në dokumentet e tenderit, sipas rregullave të prokurimit me mjete elektronike.
  - b) Duke qenë se dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesit regjistrohet automatikisht në sistem, pikat 2, 3, 4 e 5 nuk zbatohen në rastin e prokurimit me mjete elektronike.123

## **Neni 53**

### **Shqyrtimi i ofertave**

1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:

a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;

b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, i bërë sipas pikës 2 të këtij neni;

c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji;

ç) në rastet e parashikuara në nenin 26 të këtij ligji.

## **Neni 54**

### **Alternativat**

1. Autoriteti kontraktor i autorizon ofertuesit të paraqesin alternativat, kur kriter për shpalljen fitues është oferta me përparësi më të mëdha ekonomike.

2. Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës duhet të përcaktojë nëse i autorizon alternativat, në të kundërt, ato nuk lejohen.

3. Autoriteti kontraktor, kur autorizon alternativa, përcakton në dokumentet e tenderit kërkesat minimale për çdo alternativë dhe çdo kërkesë tjetër për paraqitjen e tyre.

4. Vetëm alternativat që i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, merren në shqyrtim.

## **Neni 55**

### **Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese**

1. Oferta fituese duhet të jetë:

a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose

b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese.

2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.

4. Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një përshkrim të shkurtër të procesit të vlerësimit, i cili pasqyrohet në procesverbal, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Në rastin e prokurimit me



mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit.

5. Autoriteti kontraktor përcakton ofertën më të mirë pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

### **Neni 56**

#### **Oferta anomalisht e ulët**

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

### **Neni 57**

#### **Administrimi i informacionit në proces**

1. Pas hapjes së ofertave, pa cenuar detyrimet e përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces, derisa të nënshkruhet kontrata.

2. Pas hapjes së ofertave dhe deri në shpalljen e ofertës fituese, asnjë ofertues nuk duhet të bëjë asnjë komunikim të pajustificuar me autoritetin kontraktor ose të përpiqet, në çfarëdo mënyre, për të ndikuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

### **Neni 58**

#### **Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës**

1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

2. Brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të fituesit, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik për botimin në Buletinin e Njoftimeve Publike. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, njoftimi i fituesit dërgohet në platformën elektronike të prokurimit, ditën e nesërme të punës nga marrja e vendimit. Njoftimi përmban minimalisht këtë informacion:

- a) emrat e ofertuesve pjesëmarrës;
- b) vlerat e ofertave;
- c) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;
- ç) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij;
- d) ankesa, nëse ka pasur ose jo të tilla.

3. Autoriteti kontraktor dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën, sipas afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në çdo rast kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

4. Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga autoriteti kontraktor.

5. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “çmimi më i ulët” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të jetë jo më e madhe se 2 për qind e fondit limit.

Kjo nuk cenon të drejtën e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 të këtij ligji, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e prokurimit. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike.

6. Lidhja e kontratës para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para se të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ, sipas kreut VII të këtij ligji, e bën atë absolutisht të pavlefshme.

## **KREU V/1 ZHVILLIMI I PROCEDURAVE PËR KONTRATAT SEKTORIALE**

### **Neni 58/1**

#### **Kontratat sektoriale**

1. Ky kre përmban dispozita të veçanta, që zbatohen nga autoritetet kontraktore, të cilat veprojnë në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe atij postar, kur ato prokurojnë kontrata sektoriale. Për qëllim të këtij kreu, kontratat sektoriale janë kontrata publike, të lidhura nga autoritetet kontraktore, siç parashikohet në pikën 14/1 të nenit 3, nëse kontrata është për kryerjen e secilës prej veprimtarive të mëposhtme:

a) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve fikse, që kanë për qëllim t’i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin a shpërndarjen e energjisë elektrike, të gazit apo të nxehtësisë ose furnizimin me energji elektrike, gaz a nxehtësi të këtyre rrjeteve;

b) shfrytëzimin e një zone gjeografike, për qëllime eksplorimi, me mundësinë për të nxjerrë naftë, gaz, qymyr apo karburante të tjera, të ngurta, furnizimin e aeroportevedhe të porteve detare a tokësore ose të strukturave të tjera, të terminaleve për transportuesit ajrorë, detarë ose të ujërave tokësore;

c) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t’i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin a shpërndarjen e ujit të pijshëm apo furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre rrjeteve a menaxhimin e tyre;

ç) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t’i ofrojnë publikut shërbime në fushën e transportit, nëpërmjet hekurudhave, sistemeve automatike, tramvajeve, autobusëve elektrikë a teleferikëve;

d) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t’i ofrojnë publikut shërbime në fushën e transportit me autobus;

dh) ofrimin e shërbimeve postare.

2. Autoritetet kontraktore, që prokurojnë kontrata sektoriale, zbatojnë dispozitat e kërreëve të tjerë të ligjit, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë kre.

3. Autoritetet kontraktore zbatojnë dispozitat e këtij kreu edhe për lidhjen e kontratave që parashikohen në shkronjën “c” të pikës 1 dhe që:

a) kanë lidhje me projekte inxhinierike hidraulike, të ujitjes apo të drenazhimit të tokës, me kusht që vëllimi i ujit, që do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm, të përbëjë jo më tepër se 20 për qind të vëllimit të përgjithshëm të bërë të disponueshëm nga këto projekte apo nga infrastruktura ujitëse a drenazhuese; ose

b) kanë lidhje me zhvendosjen apo trajtimin e ujërave të zeza, për sistemet e kanalizimeve dhe të trajtimit të këtyre ujërave dhe me veprimtaritë, që kanë lidhje me përfitimin e ujit të pijshëm. 4. Për sa u përket shërbimeve të transportit, të parashikuara në shkronjat “ç” e “d” të pikës 1 të këtij neni, një rrjet vlerësohet se ekziston atëherë kur shërbimi ofrohet në kushtet e punës, të parashtruara nga një autoritet përkatës, siç janë kushtet e linjave, që do të shërbehen, në kapacitetin që do të ofrohet apo në frekuencën e shërbimit.

5. Autoritetet kontraktore, që lidhin kontratat e parashikuara në shkronjën “dh” të pikës 1 zbatojnë dispozitat e këtij kreu edhe për kontratat, që kanë lidhje me ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: menaxhimin e shërbimit postar, para dhe pas dërgimit, transmetimit të dokumenteve të koduara, me mjete elektronike komunikimi, menaxhimin e bazave të të dhënave të adresave, transmetimin e postës së regjistruar elektronike, shërbimet financiare, filatelike dhe logjistike, veçanërisht, transportimin e mallrave të përdorimit të gjerë, si edhe paketimin e magazinimit e tyre.

### **Neni 58/2**

#### **Prokurimet, që përfshijnë disa veprimtari të ndryshme**

1. Një kontratë, që synon të mbulojë disa veprimtari të ndryshme, është objekt i rregullave të zbatueshme për veprimtarinë kryesore të synuar. Sidoqoftë, zgjedhja ndërmjet dhënies së një kontrate të vetme dhe dhënies së një numri kontratash të veçanta nuk mund të kryhet me objektivin e përjashtimit të saj nga fusha e këtij kreu apo, aty ku është e mundur, nga dispozita të tjera të këtij ligji.

2. Nëse njëra prej veprimtarive, për të cilën është përgatitur kontrata, është objekt i këtij kreu dhe veprimtaria tjetër i krerëve I e V të këtij ligji dhe nëse është objektivisht e pamundur të përcaktohet se cilën veprimtari kryesore mbulon kontrata, atëherë kontrata prokurohet në përputhje me krerët I e V.

3. Nëse njëra prej veprimtarive, për të cilën është përgatitur kontrata, është objekt i këtij kreu dhe tjetra nuk është objekt as i këtij kreu apo edhe i krerëve I e V dhe nëse është objektivisht e pamundur të përcaktohet se cilën veprimtari kryesore mbulon kontrata, atëherë kontrata prokurohet në përputhje me këtë kre.

### **Neni 58/3**

#### **Kontratat e lidhura për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta**

Ky kre nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale, të lidhura nga autoritetet kontraktore për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira të objektit të kontratës palëve të treta, me kusht që autoriteti kontraktor të mos ketë të drejtë, të veçantë apo ekskluzive, për ta shitur apo dhënë me qira objektin e kontratës dhe që autoritetet e tjera të mund ta shesin dhe ta japin me qira pa kufizime dhe me të njëjtat kushte si autoriteti kontraktor.

### **Neni 58/4**

## **Kontratat për sipërmarrje të lidhura, për një bashkim operatorësh ekonomikë apo për një ent kontraktor, që është pjesë e një bashkimi operatorësh ekonomikë**

1. Ky kre nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale të lidhura nga autoriteti kontraktor për një sipërmarrje të lidhur apo për një bashkim operatorësh ekonomikë, të formuar ekskluzivisht nga një numër autoritetesh kontraktore, për kryerjen e veprimtarive, që parashikohen në nenin 58/1, për një sipërmarrje të lidhur me njërin prej këtyre enteve kontraktore, me kusht që të përmbushen kushtet e parashtruara në pikën 3 të këtij neni.

2. Për qëllime të këtij neni, “sipërmarrje e lidhur” nënkupton çdo sipërmarrje:

a) llogaritë vjetore të së cilës janë të konsoliduara me ato të autoritetit kontraktor, në përputhje me rregullat e kontabilitetit;

b) mbi të cilën autoriteti kontraktor mund të ushtrojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikim dominues, sipas kuptimit të shkronjës “b” të pikës 14/1 të nenit 3, apo e cila mund të ushtrojë një ndikim dominues mbi autoritetin kontraktor, ose e cila, së bashku me autoritetin kontraktor, është subjekt i ndikimit dominues të një sipërmarrjeje tjetër, si rrjedhojë e pronësisë, pjesëmarrjes financiare apo e rregullave që e drejtojnë atë.

3. Pika 1 e këtij neni është e zbatueshme nëse, të paktën, 80 për qind e xhiros mesatare së sipërmarrjes së lidhur, gjatë tri viteve të mëparshme vjen si rezultat i ofrimit të këtyre shërbimeve, furnizimeve apo punimeve për sipërmarrjet, me të cilat ajo është lidhur. Kur, për shkak të datës në të cilën është krijuar apo ka filluar veprimtarinë një sipërmarrje e lidhur, xhiroja nuk është e disponueshme për 3 vitet pararendëse, mjafton që ajo sipërmarrje të tregojë se xhiroja e paraqitur më sipër është e besueshme, sidomos nëpërmjet parashikimeve të bëra për të ardhmen e biznesit. Kur më tepër se një sipërmarrje e lidhur me autoritetin kontraktor ofron të njëjtat shërbime, furnizime ose punime të ngjashme, përqindja e mësipërme llogaritet duke marrë parasysh xhiron e përgjithshme, që vjen, përkatësisht, nga ofrimi i shërbimeve, furnizimeve apo punimeve të atyre sipërmarrjeve të lidhura.

4. Ky kre nuk është, gjithashtu, i zbatueshëm për kontratat e lidhura:

a) prej një bashkimi operatorësh ekonomikë, të krijuar ekskluzivisht nga një numër entesh kontraktore, për kryerjen e veprimtarive brenda kuptimit të asaj që parashikohet në nenin 58/1 të këtij ligji, për njërin prej këtyre enteve kontraktore;

b) nga një ent kontraktor, pjesë e një sipërmarrjeje të përbashkët, me kusht që kjo sipërmarrje të jetë krijuar për të kryer veprimtarinë në fjalë, brenda një periudhe prej, të paktën, tre vjetësh dhe që instrumenti i krijimit të sipërmarrjes së përbashkët të përcaktojë se entet kontraktore, të cilat e formojnë atë, janë pjesë e saj, të paktën, për të njëjtën periudhë kohore.

## **Neni 58/5**

### **Përfshirjet specifike për sektorin e energjisë dhe të ujit**

1. Ky kre nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale, të lidhura nga autoritetet kontraktore të parashikuara në shkronjat “b” e “c”, të pikës 14/1 të nenit 3, për qëllime të kryerjes së një veprimtarie, që ka të bëjë me ofrimin e gazit apo të nxehtësisë për rrjetet e përmendura në paragrafin e parë, të pikës 1 të nenit 58/1 të këtij ligji, nëse: a) prodhimi i gazit apo i nxehtësisë është një pasojë e pashmangshme për kryerjen e një veprimtarie tjetër, që nuk përshkruhet në nenin 58/1 të këtij ligji; b) qëllimi i ofrimit të gazit ose i nxehtësisë është vetëm për të përdorur prodhimin për qëllime ekonomike dhe kur ai nuk kalon 20 për qind të xhiros mesatare të operatorit ekonomik gjatë periudhës së tri viteve të mëparshme, përfshirë vitin në të cilin është lidhur kontrata.

2. Ky ligj nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale, të lidhura nga autoritetet kontraktore, siç parashikohet në shkronjat “b Përrjashtimi i shërbimeve të transportit me autobus Autoriteti kontraktor, që kryen veprimtarinë e parashikuar në shkronjën “dh” të pikës 1 të nenit 58/1 të këtij ligji, në bazë të të drejtave të veçanta, nuk zbaton dispozitat e këtij kreu, nëse shërbimet e rregullta të transportit mund të ofrohen, gjithashtu, nga shoqëri të tjera transporti, në të njëjtën zonë dhe me të njëjtat kushte.

## **Neni 58/8**

### **Procedurat për prokurimin e kontratave sektoriale**

1. Për procedurat e prokurimit të të gjitha kontratave sektoriale, autoritetet kontraktore gjithmonë mund të përdorin procedurën e hapur, të kufizuar apo të negociuar, me shpallje të njoftimit.

2. Autoritetet kontraktore mund të prokurojnë kontrata sektoriale me procedurë me negociim, pa shpallje të njoftimit, kur:

a) nuk është dorëzuar asnjë ofertë apo nuk ka asnjë ofertë apo aplikim të përshtatshëm në përgjigje të procedurës së hapur, të kufizuar ose të negociuar, me shpallje paraprake të njoftimit, me kusht që të mos ketë ndryshime thelbësore të kushteve fillestare të kontratës;

b) për arsye teknike apo artistike, ose për arsye, që kanë lidhje me të drejtat ekskluzive, kontrata mund të ekzekutohet vetëm nga një operator ekonomik i veçantë;

c) për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor, i parashikuar në nenin 43 të këtij ligji, për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me shpallje të njoftimit, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen, në asnjë rast, nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit;

ç) një kontratë shpallet fituese, në bazë të marrëveshjes kuadër, me kusht që të respektohen kërkesat e nenit 58/9 të këtij ligji.

3. Procedurat me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoren për kontratat sektoriale, objekti i të cilave janë:

a) kur mallrat e përfshira prodhohen krejtësisht për qëllime kërkimore, eksperimentimi, studimi apo zhvillimi. Kjo dispozitë nuk zbatohet për prodhimin në sasi me qëllim krijimin e një qëndrueshmërie ekonomike apo mbulimin e kostove kërkimore dhe të atyre zhvillimore;

b) për furnizime shtesë nga furnitori fillestar, të vlerësuara qoftë si zëvendësim i pjesshëm i furnizimeve normale apo i instalimeve ekzistuese ose si zgjerim i furnizimeve apo i instalimeve aktuale, ku një ndryshim i furnitorit do ta detyronte autoritetin kontraktor të blinte materiale, që do të kishin specifikime të ndryshme teknike, të cilat do të rezultinin në mospërputhshmëri ose në vështirësi të mëdha teknike gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Në këtë rast, kontrata shtesë nënshkruhet brenda një kufiri kohor prej 3 muajsh nga përfundimi i kontratës fillestare dhe nuk duhet të kalojë vlerën 20 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare;

c) për furnizime të kuotuar dhe të blera në tregun e mallrave të përdorimit të gjerë;

ç) për blerje me leverdi, kur është e mundur të prokurohen furnizime, duke shfrytëzuar një mundësi veçanërisht të mirë, të disponueshme vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, me një çmim shumë më të ulët se çmimet normale të tregut;

d) për blerje furnizimesh, me kushte veçanërisht favorizuese, nga një furnitor, në likuidim përfundimtar të biznesit të vet ose nga marrësit apo likuiduesit e një falimentimi, me marrëveshje me kreditorët ose me një procedurë të ngjashme, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare në fuqi.

**4.** Procedurat me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, mund të përdoren për kontratat sektoriale, objekti i së cilave janë:

a) për punime apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, nëpërmjet rrethanave të paparashikuara, bëhen të domosdoshme për ecurinë e punimeve apo të shërbimeve, të përshkruara në kontratë, me kusht që kontrata të lidhet me operatorin ekonomik, i cili është duke i kryer këto punime apo shërbime, për sa kohë që vlera e përgjithshme e kontratave të lidhura për punimet dhe shërbimet shtesë nuk duhet të kalojë 20 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare, kur punime a shërbime të tilla:

i) nuk mund të ndahen teknikisht apo ekonomikisht nga kontrata fillestare, pa shkaktuar probleme të mëdha për autoritetin kontraktor;

ii) megjithëse mund të ndahen nga kryerja e kontratës fillestare, janë tepër të domosdoshme për përfundimin e saj; b) për punime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e punimeve të ngjashme, që i besohen operatorit ekonomik, me të cilin të njëjtat autoritete kontraktore kanë lidhur kontratën fillestare, me kusht që këto punime apo shërbime të jenë në përputhje me një projekt bazë, për të cilin është lidhur kontrata fillestare, në bazë të një procedure prokurimi. Sapo projekti i parë është gati rregullat e kualifikimit duhet të vendosen nga autoriteti kontraktor, në bazë të kriterëve objektive dhe, kur kërkohet, kriteret dhe rregullat mund të ndyshojnë. Kriteret dhe rregullat për kualifikim duhet të jenë të disponueshme për operatorët ekonomikë, sipas kërkesës. Ndyshimet e këtyre kriterëve dhe të rregullave duhet t'u komunikohen të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar.

**5.** Kriteret dhe rregullat për kualifikim, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, mund të përfshijnë kriteret e përjashtimit, të renditura në nenet 45 e 46 të ligjit, për termat dhe kushtet e përcaktuara në të. Kur autoriteti kontraktor është i tillë, sipas kuptimit të pikës 14 të nenit 3 të ligjit, këto kriteret dhe rregulla do të përfshijnë kriteret e përjashtimit, të renditura në pikën 1 të nenit 45.

**6.** Kur kriteret dhe rregullat për kualifikim, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përfshijnë kërkesa, që kanë lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorit ekonomik, ky i fundit mundet, nëse është e nevojshme, të mbështetet në kapacitetin e operatorëve të tjerë, cilado qoftë natyra ligjore e lidhjes së tij me to. Në këtë rast, operatori ekonomik duhet t'i provojë autoritetit kontraktor se këto burime do t'i vihen atij në dispozicion përgjatë të gjithë kohës së vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit, për shembull, duke dhënë një deklaratë se do t'i marrë nga një tjetër operator ekonomik për këtë qëllim. Në të njëjtat kushte, një grup operatorësh ekonomikë, siç parashikohet në pikën 2 të nenit 44, mund të mbështetet në kapacitetin e pjesëmarrësve në grup ose të enteve të tjera.

**7.** Aty ku kriteret dhe rregullat për kualifikim, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përfshijnë kërkesa, që kanë lidhje me kapacitetin teknik dhe/ose profesional të operatorit ekonomik, ky i fundit mundet, aty ku është e nevojshme, të mbështetet te kapaciteti i enteve të tjera, cilado qoftë natyra ligjore e lidhjes ndërmjet tij dhe enteve të tjera. Në këtë rast, operatori ekonomik duhet t'i provojë autoritetit kontraktor se këto burime do të jenë të disponueshme gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit, për shembull, duke hartuar një deklaratë sipërmarrjeje nga këto ente, të cilat ia bëjnë të disponueshme këto burime operatorit ekonomik. Në të njëjtat kushte, një grup operatorësh ekonomikë, siç parashikohet në pikën 2 të nenit 44, mund të mbështeten në aftësitë e pjesëmarrësve në grup apo të enteve të tjera.

**8.** Një dokument i shkruar i operatorëve ekonomikë duhet të ruhet dhe mund të ndahet në kategori, në varësi të llojit të kontratës, për të cilën kualifikimi është i vlefshëm.

9. Kur një ftesë për konkurrim bëhet nëpërmjet një njoftimi, për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, ofertuesit, në një procedurë të kufizuar ose pjesëmarrësit në një procedurë me negociim, zgjidhen nga kandidatët e kualifikuar, në përputhje me këtë sistem.

10. Autoritetet kontraktore, të cilat krijojnë dhe vënë në zbatim një sistem kualifikimi, informojnë kandidatët për vendimin e tyre për kualifikimin, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh. Nëse marrja e vendimit zgjat më tepër se katër muaj nga dorëzimi i një aplikimi, autoriteti kontraktor informon kandidatin brenda dy muajve nga aplikimi, për arsyet që justifikojnë periudhën më të gjatë dhe për datën, kur aplikimi i tij do të pranohet ose refuzohet.

11. Kandidatët, të cilët nuk do të kualifikohen, njoftohen për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe, në asnjë rrethanë, më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së vendimit. Arsyet bazohen në kriteret e kualifikimit, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

12. Autoritetet kontraktore, të cilat krijojnë dhe vënë në funksionim një sistem kualifikimi, mund ta refuzojnë kualifikimin e një operatori ekonomik vetëm për arsye të bazuara mbi kriteret e kualifikimit, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Çdo njoftim për ta refuzuar kualifikimin i njoftohet me shkrim operatorit ekonomik, të paktën 15 ditë përpara datës së parashikuar të përfundimit të kualifikimit, së bashku me arsyen që justifikon veprimin e propozuar.

## **KREU VI ZBATIMI I KONTRATËS**

### **Neni 59**

#### **Kushtet për zbatimin e kontratës**

1. Autoriteti kontraktor mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.
2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës.

### **Neni 60**

#### **Rregullat që zbatohen për kontratën**

1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përkrahura në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese.
2. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, duhet të përmbushen në mirëbesim nga palët.
3. Pa cenuar dispozitat e këtij ligji dhe ndonjë dispozitë tjetër të zbatueshme nga autoriteti kontraktor, kontratat e prokurimit rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil.

### **Neni 61**

#### **Nënkontraktimi**

1. Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktjnë te palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar.
2. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës.
3. Autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

4. Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit kontraktor, për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij/saj dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët.

## **Neni 62**

### **Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës**

1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.
2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkohej të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës.

## **KREU VII**

### **PROCEDURAT E ANKIMIT ADMINISTRATIV**

## **Neni 63**

### **Të drejtat e personit të interesuar**

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.
  - 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.<sup>133</sup>
2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.
3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.
4. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor zgjat afatet kohore të procedurës së prokurimit për periudhën e pezullimit, të përmendur në pikën 3 të këtij neni. Në rast se afatet kohore të procedurës së prokurimit, të njoftuara për ofertuesit, ndryshojnë për shkak të shqyrtimit të ankesës, autoriteti kontraktor duhet të njoftojë të gjithë ofertuesit për arsyet e zgjatjes së afatit kohor.



5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.

7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor” Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.

8. Me marrjen e ankesës së ankimesit për në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor mban të pezulluar procedurën e prokurimit, me përjashtim të rasteve kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos ndryshe, në përputhje me pikën 2, të nenit 64, të këtij ligji. Autoriteti kontraktor ia dërgon të gjithë informacionin që disponon për procedurën e prokurimit të ankimit menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë, Komisionit të Prokurimit Publik.

9. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimesit, Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementeve formale të ankimit, brenda 5 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës. Kur për shqyrtimin e ankesës i kërkohet informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar. Përjashtimisht, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, për shkaqe të ligjshme, nuk arrin të marrë një vendim brenda afatit 15-ditor, duhet t'ia bëjë të ditur palëve në proces, arsyet e mosmarrjes së këtij vendimi. Nga ky moment, brenda 15 ditëve, Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të dalë me vendimin përfundimtar për shqyrtimin e ankesës

10. Çdo ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”

11. Për procedurat e prokurimit, për të cilat nuk bëhet njoftim publik, sipas nenit 38 të këtij ligji, nuk zbatohen dispozitat lidhur me procedurat e ankimit administrati

## **Neni 64**

### **Të drejtat e Komisionit të Prokurimit Publik**

1. Me marrjen e ankesës me shkrim, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të sigurohet që autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit. Pas një shqyrtimi paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vendos nëse do të lëshojë ose jo një urdhër të ndërmjetëm, në përputhje me pikën 2 të këtij neni dhe vë në dijeni për këtë autoritetin kontraktor.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë, pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin kontraktor, me anë të një urdhri të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit, nëse:

a) ka të dhëna se ankimesi nuk do të ketë sukses me ankesën;

b) pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin kontraktor ose ofertuesit.

**3.** Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik<sup>1</sup>, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, palët në proces dhe subjektet e tjera të prekura kanë të drejtë që,:

a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

**4.** Pas lidhjes së kontratës, kur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të nxjerrë një interpretim në lidhje me rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së këtij ligji;

c) (shfuqizuar)

**5.** Kur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një punonjës i autoritetit kontraktor ka kryer një shkelje të qëllimshme që prek parimet dhe qëllimin e këtij ligji, përveç masave korrigjuese të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, mund të bëjë kallëzim penal në organet përkatëse.

#### **Neni 64/1**

##### **Procedura e rishikimit administrativ**

**1.** Komisioni i Prokurimit Publik mund të fillojë një procedurë rishikimi administrativ, kur i paraqitet ankesë nga persona të interesuar në procedura prokurimi.

**2.** Gjatë rishikimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) t'u kërkojë palëve dokumentacion ose të dhëna, për të mbështetur pretendimet e tyre; b) të kërkojë të dhëna e shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material, që ka lidhje me hetimin administrativ;

c) të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me procedurën e rishikimit; ç) të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta.

**3.** Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të caktojë një afat për përgjigjen ndaj kërkesave të tij për të dhënat dhe për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, sipas legjislacionit që rregullon procedurat administrative.

#### **Neni 64/2**

##### **Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik**

**1.** Pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:

a) të pushojë gjykimin, duke qenë se veprimet ose mosveprimet e autoritetit kontraktor, që ka realizuar procedurën e prokurimit, nuk përbëjnë shkelje të këtij ligji ose të dispozitave administrative apo penale. Në këtë rast, Komisioni i Prokurimit Publik i sqaron, me shkrim, ankimuesit arsyet për pushimin e gjykimin;

b) t'i japë autoritetit kontraktor, të përfshirë, një vendim me shkrim, për të ndalur sjelljen e jashtëligjshme, brenda një afati të caktuar kohor.

2. Autoritetet kontraktore duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga marrja dijeni për vendimin. Nëse këto veprime i kanë sjellë efektet e tyre, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik u këshillon personave të dëmtuar të ngrenë padi në gjykatë ose të bëjnë kallëzim penal.
3. Nëse Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një zyrtar i autoritetit kontraktor ka kryer një shkelje të qëllimshme të këtij ligji, atëherë i raporton shkeljen autoritetit përkatës.

### **Neni 64/3**

#### **Ankimi në gjykatë**

1. Palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë
2. Shqyrtimi i këtij ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat e prokurimit, të lidhjes së kontratës publike të prokurimit të mallrave, shërbimeve apo punëve nga autoriteti kontraktor ose ekzekutimin e detyrimeve, sipas kontratës së prokurimit nga palët respektive.

## **KREU VIII**

### **HETIMI ADMINISTRATIV**

#### **Neni 65**

##### **Procedura e hetimit administrativ**

1. Agjencia e Prokurimit Publik verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 2 vjet nga nënshkrimi i saj.
2. Gjatë hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë:
  - a) të kryejë hetime administrative në vend, duke përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve ose dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton;
  - b) të kërkojë informacione e shpjegime nga çdo organ i administratës, qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin administrativ;
  - c) të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim dhe të thërrasë të gjithë personat pa imunitet;
  - ç) të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta.
3. Për të realizuar funksionet, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë të ketë akses në të gjitha zyrat e institucioneve të administratës publike, të cilat njihen si autoritete kontraktore, sipas këtij ligji.
4. Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë të caktojë një afat për përgjigjen ndaj kërkesave të saj për informacion dhe për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, sipas legjislacionit që rregullon procedurat administrative.
5. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të njoftojë personat përgjegjës të përfshirë në hetimin administrativ të nisur nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe të dokumentojë njoftimin.

#### **Neni 66**

##### **Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ**

1. Pas përfundimit të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:

a) të mbyllë hetimin, në qoftë se veprimet ose mosveprimet e autoritetit kontraktor nën hetim nuk përbëjnë shkelje të këtij ligji;

b) të propozojë masë disiplinore ose të vendosë gjobë, në përputhje me nenin 72 të këtij ligji, për shkeljet e gjetura.

2. Në çdo rast, palët do të njoftohen me shkrim për vendimin e marrë. Autoriteti kontraktor ka detyrimin t'u njoftojë vendimin e dhënë nga Agjencia e Prokurimit Publik personave përgjegjës, të përfshirë në hetimin administrativ dhe të dokumentojë njoftimin

**Neni**

**67**

**(shfuqizuar)**

**Neni 68**

**(shfuqizuar)**

**KREU IX**

**VEPRIMTARIA E AVOKATIT TË PROKURIMEVE**

**Neni 69**

**(shfuqizuar)**

**Neni 70**

**(shfuqizuar)**

**Neni 71**

**(shfuqizuar)**

**Neni 71/1**

**(shfuqizuar)**

**Neni 72**

**Kundërvajtjet administrative**

1. Mosrespektimi i rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kur përbën kundërvajtje administrative dënohet me gjobë si më poshtë:

a) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 20 000 deri 1 000 000 lekë;

b) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 15 000 deri në 30 000 lekë;

c) mospërmbushja e detyrimit për formën e komunikimit, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, të përcaktuar në nenin 21, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 100 000 lekë;

ç) mospërmbushja e detyrimit të parashikuar në nenin 23, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë;

d) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 25, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

- dh) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 28, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 1 000 000 lekë;
- e) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 33, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 20 000 lekë deri në 1 000 000 lekë
- f) mospërmbushja e njërit prej detyrimeve të përcaktuara në nenet 39, 40, 41 e 42, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë;
- g) mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në nenin 43, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 500 000 lekë; gj) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 45, të këtij ligji, me përjashtim të shkronjës “ë”, të pikës 2, të këtij neni, dhe në nenin 46, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 30 000 deri në 500 000 lekë;
- h) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në shkronjën “ë”, të pikës 2, të nenit 45, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 1 000 000 lekë; i) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 53, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë; j) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 56, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;
- k) mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 63, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;
- l) personat, që përipiqen të ndikojnë në vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me nenin 19/7, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.
- 1/1. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.
2. Në të gjitha rastet e mësipërme, kur personat përgjegjës nuk dënohen me gjobë, dhe në çdo rast tjetër të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, kërkohet dhënia e masave disiplinore ndaj tyre.
3. Kundër vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, personat e interesuar mund të bëjnë ankim në gjykatën kompetente.
4. Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.

### **Neni 73**

#### **Sanksionet për mosbashkëpunim**

1. Refuzimi i autoritetit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë.
2. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.
3. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, sipas pikës 1, të këtij neni, personat e interesuar mund të bëjnë ankim në gjykatën kompetente.

### **Neni 74**

**(shfuqizuar)**

## **KREU X DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 75**

#### **Rregullat e prokurimit**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë rregullat e prokurimit për zbatimin e tij.

#### **Neni 75/1**

##### **Dispozitë e vecantë**

1. Procedurat e nisura në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, përfshirë dhe ankimin, trajtohen sipas ligjit nr.7571.
2. Shkronja ç e pikës 3 te nenit 13, zbatohet edhe në rastin e kontratave të nënshkuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Pikat 2 shkronja "a" dhe 5 të nenit 33 zbatohen edhe për kontratat e lidhura pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në bazë të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, edhe kur kjo nuk është parashikuar në kontratën fillestare. Neni 75/2 Procedurat për kontratat sektoriale, të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të realizohen sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Neni 76 Emërimi i Avokatit të Prokurimeve Ngarkohet Kuvendi që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të emërojë Avokatin e Prokurimeve dhe të miratojë strukturën dhe organikën e Zyrës së tij.

#### **Neni 76/1**

##### **Emërimi i anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të emërojë kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik, në zbatim të pikës 2 të nenit 19/2 të këtij ligji.

#### **Neni 76/2**

Shqyrtimi i ankesave nga komisioni do të fillojë 4 muaj pas krijimit të tij. Deri atëherë shqyrtimi i ankesave do të bëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj.

#### **Neni 76/3**

##### **Përzgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit**

1. Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve ekzistues të Komisionit të Prokurimit Publik përfundon më 1 janar 2018.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në përputhje me parashikimet e neneve 19/2, pika 3, dhe 19/3, të këtij ligji, të shpallë njoftimin për aplikim, për përzgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të rinj brenda datës 1 korrik 2017.
3. Në rast se kryetari dhe/ose anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik nuk emërohen deri në datën 1 janar 2018, sipas parashikimeve të nenit 19/2, të këtij ligji, anëtarët aktualë do të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, deri në përfundimin e procedurës së emërimit.
4. Të zgjedhurit sipas dispozitave të këtij ligji, gjatë mandatit të parë të tyre ushtrojnë funksionet përkatëse si më poshtë: kryetari dhe nënkryetari për një periudhë 5-vjeçare dhe tre anëtarët e tjerë për një periudhë 3-vjeçare.

#### **Neni 76/4**

##### **Ankesat në proces**

1. Për shqyrtimin e ankesave të paraqitura në Komisionin e Prokurimit Publik përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në momentin e

paraqitjes së ankesës. **2.** Për shqyrtimin e ankesave të paraqitura pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik do të zbatojë rregullat për organizimin dhe funksionimin që janë në fuqi, për sa kohë që ato nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj. Këto rregulla do të zbatohen deri në miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 2, të nenit 76/5, të këtij ligji.

#### **Neni 76/5**

##### **Aktet nënligjore**

- 1.** Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore sipas parashikimeve të pikës 10, të nenit 19/2, të këtij ligji.
- 2.** Ngarkohet Komisioni i Prokurimit Publik që, brenda 30 ditëve nga fillimi i punës/emërimi, të miratojë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tij në përputhje me parashikimet e pikës 5, të nenit 19/7, të këtij ligji.

#### **Neni 77**

Shfuqizime Ligji nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, me të gjitha ndryshimet e tij, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

#### **Neni 78**

Hyrja në fuqi Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2007.

Shpallur me dekretin nr.5157, datë 15.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

**VENDIM**  
**Nr.184, datë 17.3.2010**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK DHE PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.659, DATË 3.10.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, ME MJETE ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19/6, pika 4, 22 e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

**I azhurnuar me:**

- VKM Nr.122, Datë22.02.2012

**VENDOSI:**

1.Miratimin e rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.Në tekstin, që i bashkëlidhet vendimit nr.659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a)Shkronja "b" e pikës 1 "Fusha e zbatimit" të kreut I "Dispozita të përgjithshme", ndryshohet, si më poshtë vijon :

"b) Këto rregulla nuk zbatohen për veprime të tjera administrative, jashtë sferës së prokurimit publik, ose kurdoherë që sipas ligjit dhe akteve nënligjore, kërkohet përdorimi i dokumenteve shkresore."b) Pas shkronjës "b" të pikës 1 "Fusha e zbatimit" të kreut I "Dispozita të përgjithshme", shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c) Këto rregulla zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe në procedurat e shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i Prokurimit Publik, përveçse kur sipas ligjit dhe akteve nënligjore parashikohet ndryshe."

c)Pas pikës 19 të kreut IV "Dispozita të fundit", shtohet pika 20, me këtë përmbajtje:

"20. Këto rregulla zbatohen, për aq sa është e mundur edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik."

3.Pika 2 e kreut IX të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**RREGULLORE**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**



## **Neni 1**

### **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik për shqyrtimin e ankesave mbi procedurat e prokurimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

## **Neni 2**

### **Përkufizime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

- a)"Komisioni" është Komisioni i Prokurimit Publik;
- b)"Ligji 9643/2006" është ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

## **Neni 2/1**

### **Baza juridike për funksionimin dhe veprimtarinë e Komisionit**

Komisioni i Prokurimit Publik funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", me ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", me akte të tjera, ligjore dhe nënligjore, si dhe me këtë rregullore.

## **Neni 3**

### **Parimet e veprimtarisë**

1.Në veprimtarinë e tij, Komisioni respekton parimet e:

- a)ligjshmërisë;
- b)barazisë dhe mosdiskriminimit;
- c)pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;
- ç) shqyrtimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme; dhe
- d)transparencës dhe informimit të publikut.

2.Në veprimtarinë e tij, Komisioni zbaton kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretit shtetëror ose tregtar.

## **KREU II**

### **ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

## **Neni 4**

### **Organizimi i Komisionit**

1.Komisioni është person juridik publik, në varësi të Kryeministrit. Ai përbëhet nga:

- a)Kryetari, zëvendëskryetari dhe 3 anëtarë, të emëruar sipas ligjit 9643/2006;
- b)punonjësit e Komisionit, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil; si dhe
- c)personeli ndihmës i Komisionit, i emëruar nga kryetari i Komisionit, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës.

2. Komisioni shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në cilësinë e organit më të lartë në fushën e prokurimeve. Ai vepron dhe vendos mbi ankesat në përputhje me rregullat e ligjit nr. 9643/2006 dhe të kësaj rregulloreje.

3. Struktura dhe niveli i pagave të punonjësve të Komisionit, duke përfshirë këtu edhe nivelin e pagës për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 5**

### **Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit**

1. Kryetari drejton dhe organizon veprimtarinë e Komisionit, si dhe përfaqëson Komisionin në marrëdhëniet me të tretët.

2. Në mungesë ose në rast konflikti interesi të kryetarit, detyrat e tij ushtrohen nga zëvendëskryetari.

## **Neni 6**

### **Kompetencat e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit**

1. Kryetari i Komisionit ka kompetencat e mëposhtme:

a) organizon veprimtarinë e Komisionit;

b) përfaqëson Komisionin në marrëdhënie me të tretët;

c) miraton aktet e nevojshme mbi organizimin dhe mbarëvajtjen e punës dhe detyrave të punonjësve të Komisionit;

d) përgatit projektbuxhetin vjetor të Komisionit dhe vendos mbi përdorimin e fondeve në përputhje me këtë plan;

e) i paraqet Kryeministri raportet mbi veprimtarinë e Komisionit;

f) emëron dhe shkarkon personelin ndihmës të Komisionit;

f/1) përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e rregullores së brendshme

g) vendos mbi çështje të tjera të cilat, sipas kuadrit ligjor në fuqi, janë në kompetencë të kryetarit.

2. Zëvendëskryetari ushtron kompetencat e kryetarit, në mungesë ose në rast konflikti interesi të tij, përveç kompetencave që ligji ia njeh shprehimisht kryetarit.

## **Neni 6/1**

### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit**

1. Anëtarët marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komisionit.

2. Anëtari i Komisionit ka të drejtë, të paktën dy ditë përpara relatimit të çështjes, të informohet dhe të disponojë kopje të projektvendimit dhe dokumentacionin në lidhje me të, si dhe të njihet me rendin e ditës së mbledhjes së radhës.

3. Anëtari i Komisionit ka të drejtë të kërkojë mbajtjen e rregullt dhe të plotë të procesverbalit të mbledhjes. Kopja e zbardhur e procesverbalit i vihet në dispozicion për nënshkrim jo më vonë se dy ditë.

4. Në çdo rast, anëtari i Komisionit ka të drejtë të paraqesë, në mbledhjen e Komisionit, për diskutim dhe vendimmarrje, çështje që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen, funksionimin dhe stafin mbështetës të këtij Komisioni.

5. Anëtari relator i çështjes, në zbatim të pikës 2 të këtij neni, ka detyrimin të sigurohet që secilit anëtar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni i plotë i çështjes.

6. Anëtari i Komisionit, kur e gjykon të nevojshme gjatë shqyrtimit të çështjes, ka të drejtë t'u kërkojë palëve paraqitjen përpara tij dhe/ose Komisionit apo inspektorëve me qëllim zhvillimin e seancave dëgjimore, përmbajtja e të cilave duhet të pasqyrohet në procesverbal.

#### **Neni 7**

##### **Inspektorët dhe personeli ndihmës**

1. Inspektorët e Komisionit ushtrojnë funksione ndihmëse dhe këshillimore për anëtarët e Komisionit, në kuadër të shqyrtimit të ankesave, si dhe çdo detyrë tjetër të caktuar nga kryetari ose Komisioni në funksion të shqyrtimit të ankesave.
2. Numri dhe funksionet e personelit ndihmës të Komisionit përcaktohen në strukturën dhe organikën e miratuar me urdhër të Kryeministrit.
3. Rregulla të detajuara mbi detyrat e inspektorëve dhe personelit ndihmës, përcaktohen në rregulloren e brendshme të Komisionit.
- 4) Inspektorët e Komisionit ushtrojnë funksionet e mësipërme në përputhje me pikën 2 të nenit 3 të kësaj rregulloreje

#### **Neni 8**

##### **Specialistët e pavarur dhe ekspertët**

1. Komisioni miraton listën vjetore të specialistëve dhe ekspertëve të pavarur të Komisionit për vitin pasues kalendarik me të paktën dy specialistë/ekspertë për çdo fushë ekspertize.
2. Lista vjetore e specialistëve dhe ekspertëve krijohet brenda datës 10 dhjetor, të çdo viti, në bazë të renditjes së kandidatëve të paraqitur pas konkurrimit me jetëshkrime. Komisioni, kur e çmon të përshtatshme zhvillon edhe intervista të kandidatëve.
3. Rregulla më të hollësishme për krijimin e listës dhe konkurrimit të kandidatëve përcaktohen në rregulloren e brendshme të Komisionit.

#### **Neni 9**

##### **Marrëdhëniet me të tretët**

1. Komisioni bashkëpunon me autoritetet shtetërore duke ruajtur pavarësinë dhe autonominë e tij.
2. Komisioni, në veprimtarinë e tij për shqyrtimin e ankesave, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga Agjencia e Prokurimit Publik, veçanërisht në rastet kur shqyrtohen pretendimet mbi përputhshmërinë dhe standardizimin e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike kombëtare.
3. Komisioni vendos kontakte dhe bashkëpunon me institucione të ngjashme në shtete të tjera, si dhe merr pjesë aktivisht në organizata ndërkombëtare.

#### **Neni 9/1**

##### **Rendi i ditës**

1. Mbledhja e Komisionit zhvillohet në bazë të një rendi dite të përcaktuar.
2. Kryetari i Komisionit e, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, vendos për rendin e ditës, duke mbajtur parasysh njoftimet, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 6/1, të kësaj rregulloreje. Në rendin e ditës duhet të përfshihen çështjet e propozuara nga anëtarët e Komisionit, sipas pikës 3 të këtij neni, si dhe çdo çështje tjetër në kompetencë të tij.
3. Njoftimi i anëtarit relator drejtuar kryetarit për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3 (tre) ditë përpara thirrjes së mbledhjes.

4. Rendi i ditës duhet t'u njoftohet me shkrim anëtarëve të Komisionit, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 6/1, të kësaj rregulloreje

### **Neni 10**

#### **Mbledhjet dhe votimi**

1. Kryetari i Komisionit merr masat duke njoftuar me shkrim për thirrjen e mbledhjes së Komisionit. Në mungesë dhe me porosi të tij, mbledhja thirret nga zëvendëskryetari.
2. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme vetëm nëse në të janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë, një prej të cilëve duhet të jetë kryetari ose zëvendëskryetari.
3. Komisioni vendos mbi bazë dokumentesh siç parashikohet në pikën 2 të nenit 6/1, të kësaj rregulloreje me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm. Anëtarët e Komisionit nuk mund të abstenojnë. Në rast votash të barabarta, vota e drejtuesit të mbledhjes është përcaktuese. Anëtarët e Komisionit dhe inspek torët, që kanë pengesë ligjore, nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë shqyrtimit, diskutimit dhe votimit të çështjes
4. Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë inspektorët dhe ekspertët e fushave të caktuara, pa të drejtë vote.
5. Në mbledhjet e Komisionit, përveçse mbi çështjet e ankimuara, mund të merren vendime edhe mbi çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë dhe funksionimin e Komisionit.
- 6) Gjatë zhvillimit të mbledhjes respektohen, por pa u kufizuar në to, rregullat e mëposhtme:
  - a) Respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e mbledhjes nga anëtarët;
  - b) Respektimi i rendit të ditës dhe qetësisë gjatë zhvillimit të mbledhjes;
  - c) Respektimi i kohës në dispozicion të anëtarëve pjesëmarrës për të parashtruar qëndrimin e tyre të ndryshëm, nëse ka, e cila përcaktohet nga kryetari përpara fillimit të mbledhjes.
  - ç) Çdo veprim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mbledhjes

### **Neni 11**

#### **Pavarësia e Komisionit**

Anëtarët e Komisionit janë të pavarur dhe të paanshëm në vendimmarrjen e tyre. Ata i nënshtrohen legjislacionit në fuqi.

### **Neni 12**

#### **Konfidencialiteti i të dhënave**

1. Anëtarët dhe punonjësit e Komisionit, si dhe ekspertët e pavarur, në ushtrimin e detyrave të tyre në kuadër të një procedure vendimmarrjeje për shqyrtimin e një ankese të veçantë, ruajnë të dhënat personale dhe të dhënat që lidhen me sekrete shtetërore ose tregtare.
2. Kryetari i Komisionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, merr masat për ruajtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që përbëjnë sekret shtetëror apo tregtar.

### **Neni 13**

#### **Transparenca e veprimtarisë**

1. Komisioni informon publikun mbi veprimtarinë e tij përmes publikimit në faqen zyrtare të raportit vjetor të punës. Ky informim mund të realizohet edhe nëpërmjet njoftimeve për shtyp.

2.Vendimet e Komisionit publikohen në faqen zyrtare të Komisionit. Vendimet publikohen të plotaduke përfshirë dhe votimin kundër , përveçse kur pjesë të caktuara përmbajnë të dhëna personale ose të dhëna të klasifikuara si sekret shtetëror apo tregtar.

3.Komisioni publikon në faqen zyrtare edhe informacionet e tjera me karakter publik.

#### **Neni 14**

##### **Raporti mbi veprimtarinë dhe komunikimi i të dhënave**

1.Komisioni çdo vit miraton raportin vjetor të veprimtarisë mbi çështjet e shqyrtuara dhe përdorimin e fondeve, të cilin ia paraqet Kryeministri. Raporti vjetor hartohet sipas modelit të aneksit nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2.Pavarësisht, pikës 1 të këtij neni, Komisioni raporton te Kryeministri sa herë që i kërkohet ose për çështje, që ai i çmon të rëndësishme.

3.Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të internetit.

### **KREU III**

#### **PROCEDURAT E VEPRIMIT**

#### **Neni 15**

##### **Kryerja e veprimeve procedurale**

1.Veprimet procedurale, kryhen në përputhje me ligjin nr. 9643/2006.

2.Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Komisioni cakton afate prekluzive, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

#### **Neni 16**

##### **E drejta e ankimit**

1.Të drejtën për të paraqitur ankesë pranë Komisionit e ka çdo person që ka një interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi dhe që autoriteti kontraktor pas paraqitjes së ankesës prej tij:

a)nuk ka shqyrtuar ankesën brenda 7 ditëve nga marrja e ankesës;

b)ka refuzuar ankesën; ose

c)ka vendosur mospranimin e ankesës.

2.Ankesa i paraqitet Komisionit brenda 7 ditëve në rrugë elektronike, përveçse kur sipas legjislacionit në fuqi parashikohet një mjet tjetër komunikimi. Ky afat, në varësi të shkakut të ankesës, fillon:

a)nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit brenda të cilit autoriteti kontraktor duhet ta kishte shqyrtuar ankesën;

b)nga dita e njoftimit të refuzimit të ankesës nga autoriteti kontraktor; ose

c)nga dita kur ankimuesi ka marrë njoftimin e mospranimit nga autoriteti kontraktor.

3.Ankimuesi i dërgon një kopje të ankesës së paraqitur në Komision njëkohësisht autoritetit kontraktor dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, në rrugë elektronike, përveçse kur sipas legjislacionit në fuqi parashikohet një mjet tjetër komunikimi.

#### **Neni 17**

##### **Forma dhe përmbajtja e ankesës**

**1.**Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

**2.**Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

a)Të dhënat identifikuese të ankimuesit;

b)Dokumentet e tenderit;

c)Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi;

ç) Bazën ligjore;

d)Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

dh) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;

e)Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;

ë) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

**3.**Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a)provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b)kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c)kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

## **Neni 18**

### **Regjistrimi i ankesës**

**1.**Ankesat paraqiten në mënyrë elektronike në selinë e Komisionit dhe regjistrohen menjëherë. Komisioni mban një regjistër të posaçëm elektronik për regjistrimin e ankesave, i cili publikohet në faqen zyrtare.

**2.**Regjistri i ankesave përmban:

a)numrin rendor të ankesës;

b)datën e paraqitjes së ankesës;

c)subjektin ankimues;

d)objektin e ankesës;

dh)numrin dhe llojin e dokumenteve që i bashkëlidhen ankesës;

e)ecurinë e procesit.

**3.**Komisioni nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e ankesave.

**4.**Formati i standardizuar i regjistrimit miratohet nga kryetari i Komisionit dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit. Kryetari i Komisionit përcakton rregulla më të detajuara për mënyrën e mbajtjes dhe administrimit të regjistrimit.

## **Neni 19**

### **Afati për vendimmarrjen**

**1.**Komisioni merr vendim mbi ankesën brenda 7 ditëve kalendarike nga regjistrimi i saj.

**2.**Për arsye të motivuara, Komisioni vendos zgjatjen e afatit të mësipërm, por jo më shumë se 20 ditë nga regjistrimi i ankesës.

**3.**Komisioni ia njofton vendimin për zgjatjen e afatit palëve, në formë elektronike brenda 3 ditëve nga marrja e tij.

## **Neni 20**

### **Caktimi i çështjeve dhe njohja me aktet**

1.Për çdo çështje të ankimuar kryetari apo në mungesë të tij, zëvendëskryetari, cakton me short si relator një nga anëtarët e tij duke siguruar shpërndarjen e barabartë të çështjeve ndërmjet anëtarëve.

1/1 Për çështje me vlerë të fondit limit më të lartë se kufiri i ulët monetar, çështja i caktohet me short tre anëtarëve. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rast se ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të shumicës së tyre.

2.Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të njihen paraprakisht me ankesën dhe materialet që i janë bashkëlidhur asaj sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 6/1.

## **Neni 21**

### **Përrjashtimi**

1.Kryetari ose anëtari i Komisionit nuk mund të jetë relator dhe nuk merr pjesë në vendimmarrjen mbi një ankesë, kur ai gjendet në një nga rastet e konfliktit të interesit të parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

2.Kur ekzistojnë shkaqet e mësipërme, anëtari i Komisionit njofton menjëherë kryetarin, i cili vendos mbi përrjashtimin.

3.Përrjashtimi i kryetarit vendoset në mbledhjen e Komisionit të thirrur dhe drejtuar nga zëvendëskryetari i Komisionit.

4.Palët, kur janë në dijeni mbi konfliktin e interesit të anëtarëve, paraqesin kërkesën për përrjashtim në momentin e paraqitjes së ankesës. Kur shkaku lind pas paraqitjes së ankesës, kërkesa për përrjashtim mund të paraqitet derisa Komisioni nuk ka dhënë vendim mbi ankesën.

5.Rregullat mbi përrjashtimin e anëtarëve të Komisionit zbatohen edhe për përrjashtimin e inspektorëve, ekspertëve dhe specialistëve të pavarur. Mbi përrjashtimin e tyre vendos Komisioni

## **Neni 22**

### **Pjesëmarrja dhe detyrat e inspektorëve**

1.Kryetari i Komisionit, me rotacion, cakton inspektorë për anëtarët e Komisionit, për një periudhë të caktuar kohe.

2.(Shfuqizuar)

3.Inspektori, të cilit i është caktuar një çështje, njihet me ankesën dhe materialet që i bashkëlidhen asaj.

4.Inspektori i caktuar verifikon ankesën nga ana formale dhe parapërgatit mendim me shkrim në lidhje me të.

5.Në procedurat në vijim, inspektori përgatit një relacion dhe projektvendimin mbi themelin e ankesës, si dhe mbi kërkesat apo detyrat e caktuara nga Komisioni për çështjen.

## **Neni 23**

### **Verifikimi i kushteve formale**

1.Komisioni zhvillon mbledhjen e tij të parë brenda 3 ditëve nga regjistrimi i ankesës me qëllim shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a)juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

blegjitimimin e ankuesit;

c)respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d)elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në nenin 17 pika 2 të kësaj rregulloreje.

2. Relatori verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës dhe nëse autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit. Ai i relaton Komisionit rezultatet e verifikimit.

3. Komisioni voton sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje dhe vendos:

a) Mospranimin e ankesës për shkak të mungesës së kushteve formale të saj, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në këtë rast, Komisioni ia njofton vendimin ankimuesit brenda 3 ditëve, duke i treguar edhe të drejtën për t'u ankuar në gjykatë, si dhe autoritetit kontraktues me qëllim që ky i fundit të marrë masat për vazhdimin e procedurës së prokurimit publik nëse e ka pezulluar atë;

b) Kalimin e ankesës për shqyrtim, duke marrë një prej vendimeve të parashikuara në nenin 25 të kësaj rregulloreje. Në këtë rast, me kërkesë të relatorit të bazuar në aktet e bashkëlidhura ankesës, Komisioni vendos edhe nëse duhet marrë mendimi i specialistëve/ekspertëve të pavarur, si dhe njofton ankuesin për afatin e parapagimit të ekspertëve. Njoftimi përmban edhe paralajmërimin se në rast të mosparapagimit të ekspertizës në afatin e caktuar, Komisioni nuk thërret dhe nuk merr si provë ekspertizën e kërkuar.

#### **Neni 24**

##### **Urdhrat e ndërmjetëm**

1. Komisioni kur vendos kalimin e ankesës për shqyrtim në themel mund të urdhërojë:

a) pezullimin e procedurës së prokurimit publik në rast se autoriteti kontraktues nuk e ka pezulluar atë me marrjen njoftim për ankesën;

b) vazhdimin e procedurës së prokurimit publik nga autoriteti kontraktues nëse çmon se pezullimi i procedurës së prokurimit dëmton interesin publik, autoritetin kontraktor ose ofertuesit.

#### **Neni 25**

##### **Shqyrtimi në themel**

1. Nëse kërkesa përmbush elementet formale, Komisioni vazhdon me shqyrtimin në themel të saj brenda të njëjtës mbledhje. Nëse vazhdimi nuk është i mundur sepse nevojitet marrja e një prove të caktuar, mbledhja e radhës zhvillohet brenda 7 ditëve nga regjistrimi i ankesës. Në raste të ndërlikuara, Komisioni vendos zgjatjen e afatit të mësipërm, por jo më shumë se 20 ditë nga regjistrimi i ankesës.

2. Komisioni ka të drejtë të kërkojë të dhëna dhe shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dokument apo provë që ka lidhje me hetimin administrativ.

3. Komisioni vendos mbi një ankesë në mbledhje me dyer të mbyllura.

4. Gjatë mbledhjeve mbahet procesverbal, i cili përmban edhe rezultatet e votimit të anëtarëve. Procesverbali nënshkruhet nga personi që e mban atë dhe nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje.

#### **Neni 26**

##### **Procedura të veçanta**

1. Në rastin e ankesave ndaj vendimeve përfundimtare të autoritetit kontraktor mbi sqarimet për dokumentet e tenderit, ankimuesi duhet të përcaktojë saktë objektin e ankesës së tij nëse ajo drejtohet kundër mënyrës së sqarimit apo kundër përputhshmërisë së vendimit të autoritetit kontraktor me standardet kombëtare të specifikimeve teknike.

2. Nëse ankesa drejtohet kundër mënyrës së sqarimit, Komisioni e trajton atë sipas rregullave të ankimit administrativ të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.



## **Neni 27**

### **Kufijtë e shqyrtimit të ankesës**

1. Komisioni shqyrtton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.
2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.

## **Neni 28**

### **Vendimi i Komisionit**

1. Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar:
  - a) Pushimin e procedimit administrativ për shkak se veprimet e treguara në ankesë nuk përbëjnë shkelje të legjislacionit mbi prokurimin publik apo kur pretendimet e ankuesit rezultojnë të paprovuara; ose
  - b) Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor.
2. Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës "b" të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:
  - a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;
  - b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim;
  - c) Të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së prokurimit;
  - d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit.
3. Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronja "b" të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006 dhe kontrata e prokurimit është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:
  - a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;
  - b) Të deklarojë një fakt të caktuar të rezultuar gjatë shqyrtimit administrativ. Ky vendim mund të përdoret në gjykatë si dokument që justifikon dëmshpërblimin gjyqësor të ankuesit për humbjet ose dëmet e pësuar nga shkelja e ligjit;
  - c) Të marrë masa konkrete ndaj personave përgjegjës në përputhje me dispozitat e ligjit 9643/2006. Këto masa mund të përfshijnë këshillimin e të dëmtuarit për të ngritur padi në gjykatë ose për të paraqitur kallëzim në gjykim, si dhe raportimin tek eprori përkatës i shkeljes së qëllimshme të ligjit prej zyrtarit të autoritetit kontraktor.

## **Neni 29**

### **Përmbajtja e vendimit**

- 1.Vendimi i Komisionit përmban numrin, datën, nënshkrimin, vulën e Komisionit anëtarët e pranishëm në mbledhje, relatorin e çështjes, votimi kundë, si dhe të drejtën e ankimit në gjykatë. Gjithashtu, çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë që arsyetimi i mendimit kundër ose paralel t'i bashkëlidhet vendimit
- 2.Vendimi i Komisionit duhet të arsyetohet.
- 3.Të gjitha kopjet e vendimit nënshkruhen nga kryetari.
- 4.Vendimi i njoftohet ankimuesit dhe autoriteti kontraktor dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.
- 5.Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve nga marrja dijeni mund t' i drejtohet Komisionit me kërkesë për rishikimin e vendimit. Rishikimi i vendimit kryhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative.

### **Neni 30**

#### **Shpenzimet procedurale**

- 1.Shpenzimet procedurale përfshijnë tarifën e ankesës dhe shpenzimet për konsultimin e specialistëve/ekspertëve të pavarur.
- 2.Kur Komisioni, në procedurën e shqyrtimit të një ankese, urdhëron thirrjen e specialistëve ose të ekspertëve dhe kryerjen e ekspertizës, duhet të përcaktojë detyrimin e palëve për parapagimin e tyre dhe afatin.
- 3.Parapagimi i shpenzimeve vërtetohet duke paraqitur dokumentacionin bankar përkatës.
4. Palët në proces mbulojnë shpenzimet e ekspertizës.
- 5.Komisioni përcakton në vendimin që përfundon procedimin administrativ edhe detyrimin se kujt i ngarkohen shpenzimet procedurale. Për ankesën pjesërisht të suksesshme, shpenzimet procedurale përcaktohen në përputhje me masën e pjesës së ankesës së pranuar.

### **Neni 31**

#### **Karakterit detyruar i vendimeve të Komisionit**

Autoritetet kontraktore, nëse brenda 10 ditëve nga marrja dijeni, nuk kërkojnë pranë Komisionit rishikimin e vendimit të tij, janë të detyruara ta zbatojnë atë në përputhje me urdhërimet e tij.

### **Neni 32**

#### **Arkivimi i dokumentacionit**

- 1.Komisioni krijon arkivin elektronik për të gjithë dokumentacionin për çdo çështje në përputhje me rregullat mbi arkivat.
- 2.Përveç arkivit elektronik, Komisioni mund të mbajë arkiv për dokumentacionin e paraqitur në formë shkresore, për rastet kur sipas ligjit apo akteve nënligjore është parashikuar një formë komunikimi, e ndryshme nga ajo elektronike.

## **KREU IV**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 33**

#### **Dispozitë kalimtare**

- 1.Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Komisioni vazhdon shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në gjendjen në të cilën ato ndodhen, duke respektuar për aq sa është e mundur rregullat e këtij vendimi.

2.Kryetari i Komisionit, me propozim të Komisionit, miraton rregulloren e brendshme, si dhe nxjerr aktet e tjera të parashikuara në këtë rregullore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e saj.

3.Komisioni, brenda dy javëve nga emërimi i anëtarëve të tij, krijon një listë të përkohshme ekspertësh deri në plotësimin e afatit të parashikuar nga neni 8 i kësaj rregulloreje.

## **ANEKSI NR.1**

### **RAPORTI VJETOR I KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

#### **I. Hyrje**

---

---

---

#### **II. Të përgjithshme**

##### **1. Struktura dhe organika**

---

---

---

##### **2. Marrëdhëniet me të tretët**

###### **a) Marrëdhëniet me autoritetet shtetërore**

---

---

---

###### **b) Marrëdhëniet me institucionet jashtë vendit**

---

---

---

###### **c) Pjesëmarrja organizata ndërkombëtare**

---

---

---

##### **3. Faqja e internetit**

---

---

---

### III. Veprimtaria e Komisionit

#### 1. Çështjet e shqyrtuara

---

---

---

#### 2. Rezultatet e shqyrtimit

---

---

---

#### 3. Pasqyra e problematikave gjatë shqyrtimit të ankesave

---

---

---

### IV. Buxheti

#### 1. Përdorimi i fondeve

---

---

---

#### 2. Parashtrime mbi mjaftueshmërinë e fondeve

---

---

---

### V. Vështirësitë gjatë ushtrimit të funksioneve

---

---

---

### VI. Objektivat për vitin pasardhës

---

---

---

## FORMULARI I ANKESËS DREJTUAR KOMISIONIT

Ankesë drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik  
Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit  
Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi postar/kodi zip

Nr. telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) Nr. faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për procedurën

1. Numër identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për prokurimin kundër të cilit bëhet ankimi (p.sh, kërkesë për propozime (KP), procedurë e hapur(PH), procedurë e kufizuar(PK), procedurë me negociim(PN), shërbim konsulence (SHK), konkurs projektimi (KP).

2. Autoriteti kontraktor

Emri dhe organizata qeveritare që administron procesin e prokurimit.

3. Vlera e përlllogaritur e prokurimit

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë).

4. Objekti i kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.

5. Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e përcaktimit të kontratës fituese

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore e ankesës

(shkruani shkëlqen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente etj.)

2. Deklaratë e hollësishme e fakteve dhe argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumenteve të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

Seksioni IV. Kundërshtimi paraprak ndaj autoritetit kontraktor

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt autoritetit kontraktor. Bashkëngjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1. Shkallët e ndjekura të ankimit:

Keni bërë ndonjë ankim për këtë procedurë prokurimi? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (p.sh, me shkrim, nëpërmjet faksit), organin shtetëror dhe llojin e vendimit të dhënë (duke përshkruar edhe nëse organi nuk është shprehur fare për ankimin tuaj).

Po  Jo

Nëse po të jepen detajet dhe dokumentacioni përkatës.

2. Dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës së ankimit

3. Pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar

Çfarë vendimi kërkonti të marrë Komisioni?

3. Lista e shtojcave

a) Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkëngjisni një kopje të lexueshme të të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjitha këtyre dokumenteve. Dokumentet duhet të përfshijnë normalisht çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentet e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë.

b) Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumenteve përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

c) Përcaktoni nëse kërkonti përjashtimin e ndonjërit prej anëtarëve të Komisionit për konflikt interesi.

d) Përcaktoni nëse kërkonti ekspertizë të posaçme për shqyrtimin e ankimit.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**Kujdes:** Një kopje e kësaj ankese duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit kontraktor dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nr. Fax, e-mail:

Nënshkrimi dhe vula e ankuesit

**VENDIM**  
**Nr. 914, datë 29.12.2014**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK**

**I azhurnuar me:**

- VKM Nr.402, datë 13.05.2015
- VKM Nr.1046, datë 23.12.2015
- VKM Nr.823, datë 23.11.2016
- VKM Nr.893, datë 21.12.2016
- VKM Nr.797, datë 29.12.2017
- VKM Nr.80, datë 14.02.2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullave të prokurimit publik, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Ngarkohen autoritetet kontraktore, të përcaktuara në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, për zbatimin e rregullave të miratuara me këtë vendim.
  3. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dhe të publikojë dokumentet standarde të tenderit.
  4. Vendimi nr. 1, datë 10.1.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe të gjitha udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, të dala në zbatim të këtij vendimi, shfuqizohen.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK KREU I ORGANIZIMI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Neni 1**

**Përgjegjësia e autoritetit kontraktor**

Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimet me fonde publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (më poshtë “LPP”), të këtyre rregullave dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (më poshtë “APP”), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP.

**Neni 2**

Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit

1. Në përputhje me nenin 11 të LPP dhe me qëllim realizimin dhe përdorimin më të mirë të fondeve publike, Këshilli i Ministrave mund t’ia ngarkojë rolin e organit qendror blerës një

autoriteti tjetër kontraktor për blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve të njëjta si dhe/ose lidhjen e marrëveshjes kuadër për punë, furnizime ose shërbime të caktuara, në emër dhe për llogari të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave. Çdo autoritet tjetër kontraktor mund të kërkojë dhe, rrjedhimisht, të bjerë dakord me organin qendror blerës për kryerjen e prokurimit në emër të tij.

**2.** Nëse disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë të njëjtin mall, punë ose shërbim, ata mund të bien dakord t'i caktojnë njërit prej tyre rolin e organit qendror blerës për të prokuruar në emër të tyre. Ministritë ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të prokurojnë në mënyrë të përqendruar për autoritetet kontraktore të varësisë. Në këtë rast, ministrat ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të përdorin blerjen e përqendruar, duke nxjerrë udhëzimet e duhura për autoritetet kontraktore të varësisë.

**2.1** Nëse një ose disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë mall/punë ose shërbim, ata mund të bien dakord të delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti tjetër kontraktor për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e.

**3.** Prokurimi i përqendruar mund të përdoret kur:

- a) blerja e përqendruar mundëson përfitime ekonomike për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme;
- b) autoriteti kontraktor, që luan rolin e organit qendror blerës, ka njohuri të mjaftueshme për artikujt që do të prokurohen.

**4.** Në bazë të një marrëveshjeje të shkruar ose të udhëzimeve administrative, organi qendror blerës kryen procedurën e prokurimit në emër të çdo autoriteti kontraktor, ndërsa ky i fundit përcakton specifikimet teknike, sasi të punëve / mallrave /shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe fondet përkatëse.

**5.** Organi qendror blerës shqyrton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse organi qendror blerës vlerëson se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me LPP ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre dhe njofton për këtë autoritetin kontraktor. Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me ekspertë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me ekspertë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet. Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore kanë marrë për bazë çmime të ndryshme për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përlllogarit të dhënave sasiore, sipas fondit përkatës.

**6.** Organi qendror blerës mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kontraktor, si dhe duhet t'i sigurojë këtij të fundit, sa herë që e kërkon, akses të plotë në çdo informacion për procedurën e prokurimit. **3 7.** Organi qendror blerës është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti kontraktor. Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurrimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.



8. Ky nen nuk zbatohet në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale kur autoritetet kontraktore janë ente private.

### **Neni 3**

#### **Buletini i Njoftimeve Publike**

APP-ja publikon Buletinin e Njoftimeve Publike çdo ditë të hënë dhe, në çdo rast tjetër, me vendim të posaçëm të saj. Në Buletin publikohen, në përputhje me LPP dhe rregullat e prokurimit publik:

- a) njoftimi i kontratës për procedurat e prokurimit me vlerë mbi dhe nën kufijtë e ulët monetarë, sipas parashikimit të nenit 8, të këtyre rregullave;
- b) njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës së lidhur dhe njoftimi i anulimit;
- c) lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik nga koncesionet/partneriteti publik privat apo nga pjesëmarrja në ankandet publike, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në bazë të pikës 3, të nenit 13, të LPP-së.
- ç) çdo informacion apo akt tjetër që APP-ja e gjykon të nevojshëm për publikim në përputhje me LPP, ligje të tjera apo rregullat e prokurimit publik.

### **Neni 4**

#### **Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik**

1. Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së. Ky regjistër duhet të përgatitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i ligjit për buxhetin. Autoritetet kontraktore, brenda 5 (pesë) ditëve nga hartimi i regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit, të dërgojnë në organin qendror blerës të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për objektet që do të prokurohen në mënyrë të përqendruar. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem. APP-ja nuk do të lejojë publikimin e regjistrave të parashikimeve, të cilët nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik. Një kopje e regjistrit të parashikimeve pas publikimit nga APP-ja duhet të dërgohet në degën e thesarit dhe në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

2. Çdo autoritet kontraktor, i cili do të luajë rolin e organit qendror blerës, dhe autoriteti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nëse është rasti), duhet të krijojë një regjistër parashikimi për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen prej tyre, menjëherë me mbledhjen e të dhënave, por, në çdo rast, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga marrja e tyre. Organi qendror blerës dhe autoriteti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nëse është rasti), kanë detyrimin të krijojë/të modifikojnë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës e krijimit të tij në sistem.

3. Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet shtetërore apo çdo autoritet kontraktor tjetër jobuxhetor përgatitin regjistrin 4 e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo planit të blerjeve nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse. Këto autoritete kontraktore kanë detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e krijimit të tij në sistem.

4. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste të justifikuara. Çdo ndryshim i regjistrin të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem. APP-ja nuk do të lejojë publikimin e ndryshimit të regjistrave të parashikimeve, nëse konstaton se ky ndryshim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik. Një kopje e këtyre ndryshimeve, pas publikimit të tyre nga APP-ja duhet t'u dërgohet degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

## **Neni 5**

### **Publikimi i njoftimit të kontratës**

1. Autoriteti kontraktor dërgon në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe publikim në faqen e internetit çdo njoftim për procedurën e hapur, të kufizuar, me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, kërkesë për propozim, konkurs projektimi si dhe shërbime konsulence.
2. Autoriteti kontraktor është i detyruar të dërgojë në APP, me shkresë përcjellëse, një kopje të shkruar të njoftimit të kontratës dhe një kopje elektronike (CD) të të gjitha dokumenteve të tenderit. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për barazvlefshmërinë e kopjes së sipërpërmendur, së bashku me dokumentet e tenderit të hartuara nga njësi e prokurimit dhe që administrohen nga autoriteti kontraktor, për efekte të tenderit. APP-ja është e detyruar që, njëkohësisht me publikimin e njoftimit të kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike, të bëjë edhe shpalljen në faqen e saj zyrtare të internetit, të këtij njoftimi dhe të dokumenteve të tenderit. Këshillimi dhe shkarkimi elektronik i dokumenteve të tenderit duhet të jenë lehtësisht të përdorshëm nga publiku. Përdorimi i këtyre dokumenteve, për efekt të pjesëmarrjes në tender, lejohet pa asnjë kufizim. E njëjta procedurë publikimi, këshillimi, shkarkimi dhe përdorimi do të ndiqet edhe në rastet e sqarimeve apo të ndryshimeve të dokumenteve të tenderit, të bëra pas publikimit të parë.
3. Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, hedhja e njoftimit të kontratës dhe e dokumenteve të tenderit në sistemin elektronik bëhet nga vetë autoriteti kontraktor. Shpallja e njoftimit në faqen e internetit të APP-së do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.
4. Një përmbledhje e njoftimit të kontratës mbi kufirin e lartë monetar duhet të botohet edhe në të paktën një gazetë me shpërndarje të gjerë në Evropë.

## **Neni 6**

### **Publikimi i njoftimit të fituesit, njoftimit të kontratës së lidhur dhe njoftimit të anulimit**

1. Autoriteti kontraktor dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të APP-së njoftimin e fituesit, në përputhje me parashikimet e nenit 58 të LPP.
2. Autoriteti kontraktor dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës.
3. Në rastin e prokurimit të përqendruar, autoritetet kontraktore përfituese duhet të dërgojnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë organit qendror blerës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Organi qendror blerës dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti kontraktor.

**3.1.** Në rastin e delegimit të prokurimit, autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e duhet të dërgojë/jnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë autoritetit kontraktor, i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Ky i fundit dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti kontraktor.

**4.** Autoriteti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit për anulim.

**5.** Njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës së lidhur dhe njoftimi i anulimit dërgohen në APP në formë elektronike (CD).

**6.** Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, hedhja në sistemin elektronik të njoftimit të fituesit, njoftimi i anulimit dhe njoftimit të kontratës së lidhur bëhet nga vetë autoriteti kontraktor. Shpallja e njoftimit të fituesit, njoftimi i anulimit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në faqen e internetit të APP-së do të bëhet publike ditën e nesërme të punës, nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

## **Neni 7**

### **Realizimi i procedurave të prokurimit**

**1.** Autoriteti kontraktor, në përfundim të çdo procedure prokurimi, pas lidhjes së kontratës e pasqyron këtë procedurë në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së.

**2.** Autoriteti kontraktor, çdo katër muaj, por jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti, dorëzon në organet qendrore, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara.

**3.** Çdo katër muaj, APP-ja duhet të dorëzojë në Këshillin e Ministrave një përmbledhje të procedurave të prokurimeve të realizuara në shkallë kombëtare.

**4.** Autoriteti kontraktor, në fillim të çdo viti, përgatit një regjistër të procedurave të prokurimit të kryera gjatë vitit paraardhës, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja. Një kopje e regjistrit u dorëzohet organeve qendrore, që vënë në dispozicion fonde, jo më vonë se data 15 janar. APP-ja publikon regjistrin kombëtar të procedurave të prokurimit publik të realizuara për vitin paraardhës, brenda datës 20 janar.

**5.** Çdo organ qendror blerës, në përfundim të çdo procedure prokurimi, pas lidhjes së kontratës e pasqyron këtë procedurë në regjistrin e procedurave të prokurimit të realizuara, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së.

## **KREU II**

### **RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROKURIMIT**

## **Neni 8**

### **Kufijtë monetarë**

**1.** Në përputhje me nenin 27 të LPP kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar: - 2 400 000 000 (dy miliardë e katërqind milionë) lekë; - 200.000.000 (dyqind milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar: 6 - 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike; - 8.000.000 (tetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave. Të njëjtët kufij monetarë zbatohen edhe për kontratat sektoriale.

2. Për prokurimet, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlerë të vogël, siç përsëritet në nenin 40 të këtyre rregullave. Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë.
3. Për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, si dhe për artikuj dhe shërbime protokollare që i shërbejnë veprimtarisë së përditshme të autoriteteve kontraktore, sipas legjislacionit në fuqi, vlera e përlogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup-artikujsh brenda një viti kalendarik është nën vlerën e kufirit të ulët monetar.
  - 3.1 Përjashtimisht gjatë vitit 2016, për procedurat e prokurimit që do të kryhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, për dy aktivitetet, Asambleja Parlamentare e Vendeve të Mesdheut dhe Asambleja Parlamentare e NATO-s, vlera e përlogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël është mbi vlerën e kufirit të ulët monetar, për prokurimin e artikujve apo grup - artikujsh për këto aktivitete.
4. Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP.

## **Neni 9**

### **Llogaritja e vlerës së kontratës**

1. Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit. Në llogaritjen e vlerës merret parasysh edhe shuma totale që duhet paguar në rast ripërtëritjeje të kontratës, kur një rast i tillë është parashikuar. Kjo vlerë ka për qëllim klasifikimin e kontratës sipas kufijve monetarë dhe planifikimin e publikimin e procedurës së prokurimit. Vlera e TVSH-së llogaritet si zë më vete, por nuk përfshihet në vlerën limit të publikuar në njoftimin e kontratës. TVSH-ja, kur është e zbatueshme, i shtohet vlerës së ofertës fituese për llogaritjen e vlerës totale të kontratës që do të lidhet.
2. Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar. Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë apo leasing, fondi limit llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë të cilave do të zgjatë kontrata. Autoriteti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë aplikimin e kontratës shumëvjeçare dhe të bëjë një përlogaritje të saktë të fondit, ku të jepen hollësi për investimin që do të kryhet, amortizimin për çdo vit dhe përbërësit/elementet e tjera të ngjashme me to.
3. Në llogaritjen e vlerës limit të kontratës në rastin e marrëveshjes kuadër, do të përfshihet vlera e të gjitha kontratave që mund të lidhen brenda afatit të kësaj marrëveshjeje.
4. Autoriteti kontraktor, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, mund të konvertojë vlerën limit të kontratës me një monedhë ndërkombëtare, të përzgjedhur prej tij sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës.

5. Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, 7 dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor. Në çdo rast, kur kontrata ndahet në lote, për efekt të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit lot.

### **KREU III DOKUMENTET E TENDERIT**

#### **Neni 10**

##### **Dokumentet standarde të tenderit**

APP-ja përgatit formatin e dokumenteve standarde të tenderit, që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit. Këto dokumente japin informacion që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoritetet kontraktore. Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në rastet kur vlerësohet nga autoriteti kontraktor në procedurat e prokurimit që nuk kërkojnë njoftim publik, sipas nenit 38 të LPP. Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij duhet të mbahen sekret.

#### **Neni 11**

##### **Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit**

1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.
2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin:
  - njoftimin e kontratës;
  - ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);
  - udhëzimet për kandidatët/ofertuesit; - kriteret e përgjithshme të kualifikimit/ pjesëmarrjes;
  - formularin për deklarimin e konfliktit të interesit, formulari i informacionit konfidencial;
  - ofertën ekonomike;
  - sigurimin e ofertës, nëse kërkohet;
  - njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandi-datëve;
  - ankesa;
  - njoftimin e fituesit;
  - kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës.
  - modelin e marrëveshjes kuadër;
  - sigurimin e kontratës;
  - njoftimin e kontratës së lidhur, njoftim i anulimit të procedurës.
3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.
  - a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:
    - projektin dhe specifikimet;
    - preventivin e hollësishëm dhe kostot;
    - grafikun e zbatimit;

- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.
- b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:
  - specifikimet teknike;
  - grafikun e lëvrimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.
- c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:
  - termat e referencës;
  - grafikun e ekzekutimit;
  - kërkesat për personelin kryesor;
  - kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

## **SEKSIONI I INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

### **Neni 12**

#### **Njoftimi i kontratës**

Njoftimi i kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit publik. Ky informacion përfshin: emrin dhe adresën e autoritetit kontraktor dhe të personit/ave përgjegjës për procedurën; objektin; referencën e njoftimit dhe procedurën e prokurimit; vlerën limit të përlllogaritur të kontratës dhe kohëzgjatjen e kontratës; një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren; kriteret e shpalljes së fituesit; kushtet e marrëveshjes kuadër; vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nëse kërkohet; vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre; gjuhën /gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve; informacione të mëtejshme të vlerësuara të dobishme nga autoriteti kontraktor. Në rastet e procedurave të prokurimit me faza, informacioni i dhënë në njoftimin e kontratës duhet t'i referohet fazës së parë të kualifikimit të procedurës. Në rastet e procedurave të prokurimit të rishpallura pas anulimit, njoftimi i kontratës duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar, si numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik, objekti dhe fondi limit.

### **Neni 13**

#### **Ftesa për ofertë**

Ftesa për ofertë u dërgohet vetëm kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë të kualifikimit përmes procedurës së prokurimit me faza. Ajo përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë kandidatëve të përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre. Ky informacion përfshin: - një referencë për njoftimin e publikuar të kontratës; - kriteret e shpalljes së fituesit; - kushtet e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti; - vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre; - gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve; - informacione të mëtejshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme.

### **Neni 14**

#### **Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët**

1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, si dhe veprimet që ndalohen me ligj. Në to shpjegohet se pjesëmarrësit në procedurën e prokurimit duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të tenderit, pa bërë asnjë ndryshim.
2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit

duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, autoriteti kontraktor mund të konvertojë vlerën e ofertës së paraqitur në një monedhë ndërkombëtare, të përzgjedhur prej tij në dokumentet e tenderit, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.

**3.** Në udhëzime duhet të përcaktohet që, nëse autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në tender duhet të kenë mundësi të ba rabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor mund të organizojë një konferencë paraprake (edhe në rastin e mallrave), ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime për paqartësitë që u lindin gjatë përgatitjes së dokumenteve. Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit kontraktor duhet t'u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë kërkuar dokumentet e tenderit. Në rastin e procedurave të prokurimit me mjete elektronike, kërkesat për sqarim bëhen sipas udhëzimeve të APP-së.

**4.** Çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik të interesuar, në përputhje me nenin 42 të LPP dhe me këto rregulla.

**5.** Gjatë përgatitjes së ofertave, kandidatët ose ofertuesit duhet të përfshijnë të gjitha detyrimet fiskale, që janë në fuqi deri në 28 (njëzet e tetë) ditë para hapjes së ofertave, me përjashtim të TVSH-së, e cila, nëse është e aplikueshme, do të llogaritet mbi vlerën e ofertës.

**6.** Ofertat ekonomike të dhëna nga ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi. Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm do të refuzohet nga autoriteti kontraktor, si e papranueshme.

**6/1.** Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën pesë ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë ofertuesit, me shkrim, të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton autoritetin kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë autoriteti kontraktor do të refuzojë ofertën. Nëse procedura e prokurimit është e pezulluar, koha e pezullimit nuk llogaritet në periudhën e vlefshmërisë së ofertës.

**7.** Udhëzimet japin informacion edhe për procedurën e rishikimit dhe të dorëzimit të ankesave. 10 Neni 15 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes Përmbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.

## **Neni 16**

### **Deklarimi i konfliktit të interesit dhe informacioni konfidencial**

1. Ky deklaram garanton autoritetin kontraktor që ofertuesit/kandidatët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Ai përmban të dhënat personale të ofertuesit/kandidatit dhe grupet e personave që konsiderohen si persona në konflikt interesi, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Nëpërmjet listës së informacionit konfidencial, kandidati/ofertuesi deklaron informacionin që kërkon të mbahet konfidencial.

## **Neni 17**

### **Oferta ekonomike**

Oferta ekonomike përmban vlerën e ofertës. Kësaj oferte i bashkëlidhet një listë e hollësishme çmimesh. Neni 18 Sigurimi i ofertës

1. Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas këtij neni. Në këtë rast, sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari. Sigurimi i ofertës nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar.
2. Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës limit, të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.
3. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet:
  - a) të mos vendosë asnjë kusht për pagimin;
  - b) të paguajë shumën brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës zyrtare të autoritetit kontraktor.
4. Nëse sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie të lëshuar nga një bankë, autoriteti kontraktor duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës jo më vonë se 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

## **Neni 19**

### **Njoftimi i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve**

Ky njoftim përmban arsyet e skualifikimit të një ofertuesi apo kandidati në një procedurë 11 prokurimi, në bazë të kërkesave të parashikuara në nenet 45, 46 dhe 47 të LPP.

## **Neni 20**

### **Ankesa**

Kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar mund të bëjnë ankesë pranë këtij të fundit, nëpërmjet një formulari standard, i cili përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.

## **Neni 21**

### **Njoftimi i fituesit**

1. Pas miratimit të raportit përmbledhës nga titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, siç parashikohet në këto rregulla, ofertuesi i suksesshëm njoftohet me shkrim për pranimin e ofertës dhe për lidhjen e kontratës.
2. Ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në sistemin elektronik të prokurimit, në përputhje me nenin 58 të LPP. Njoftimi duhet të përmbajë:



- referencën e procedurës;
- emrin dhe adresën e ofertuesit të shpallur fitues;
- përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve;
- kohëzgjatjen e kontratës dhe çmimin/vlerën e kontratës;
- emrat dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;
- emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;
- informacion nëse ka pasur ankesa, si dhe - kërkesën që kontrata të nënshkruhet, me kusht që të jetë bërë sigurimi i saj.

**3.** Autoriteti kontraktor do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën menjëherë pas publikimit të njoftimit të fituesit, por në çdo rast jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e këtij publikimi. Operatori ekonomik i shpallur fitues është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

**4.** Njoftimi i fituesit për marrëveshjen kuadër duhet të përmbajë:

- referencën e procedurës;
- emrin dhe adresën e ofertuesit/ofertuesve të shpallur fitues;
- përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, si dhe
- kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër.

## **Neni 22**

### **Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës**

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës përkufizojnë tërësinë e punëve që do të kryhen, të gjitha mallrat apo shërbimet që do të furnizohen, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit, si dhe detyrimet për përmbushjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

## **Neni 23**

### **Marrëveshja kuadër**

Marrëveshja kuadër përmban formën e marrëveshjes, listën e punëve/mallrave /shërbi-meve, si dhe termat dhe kushtet e marrë-veshjes.

## **Neni 24**

### **Sigurimi i kontratës**

**1.** Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

**2.** Gjatë ekzekutimit, nëse janë parashikuar pagesa periodike sipas grafikut të zbatimit të kontratës, kontraktori mund të kërkojë reduktimin e përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore, por jo më pak se 25% të vlerës korresponduese të sigurimit të kontratës.

**3.** Nëse ofertuesi i përzgjedhur nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në njoftimin e fituesit, atëherë autoriteti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës, nëse është kërkuar dhe lidh kontratën me ofertuesin e renditur të dytë në klasifikimin përfundimtar, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 58 të LPP. **4.** Sigurimi i kontratës nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.

## **Neni 25**

### **Njoftimi i kontratës së lidhur**

1. Autoriteti kontraktor dërgon për publikim njoftimin e kontratës së lidhur brenda 5 ditëve nga lidhja e kontratës.
2. Njoftimi duhet të përmbajë: - numrin e referencës së procedurës/kontratës dhe emrin e autoritetit kontraktor; - përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, çmimin dhe kohëzgjatjen e kontratës; - të dhëna të tjera nga autoriteti kontraktor.
3. Autoriteti kontraktor duhet të dërgojë për publikim kontratën fituese për një kontratë të lidhur nga një marrëveshje kuadër.

## **Neni 25/1**

### **Njoftimi i anulimit**

1. Autoriteti kontraktor dërgon për publikim njoftimin e anulimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të anulimit.
2. Njoftimi duhet të përmbajë: - numrin e referencës së procedurës dhe emrin e autoritetit kontraktor; - përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; - arsyet e anulimit të procedurës sipas përcaktimeve të nenit 24, të LPP-së.

## **SEKSIONI II**

### **INFORMACIONE TË VEÇANTA PËR KONTRATAT**

## **Neni 26**

### **Kontratat për punë publike**

1. Në dokumentet e tenderit për kontratat e punëve publike, projekti duhet të plotësohet me hollësi, duke dhënë çmimet për njësi, vëllimin dhe llojet e punëve.
2. Punët publike mund të prokurohen:
  - a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuar në projekt mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar. Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).
  - b) me kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.
3. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.
4. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve.
5. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre

kritereve.

**6.** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

**7.** Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë 14 këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**8.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

ç) **(Shfuqizuar).**

d) Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

**9.** Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë

kërkesat për kualifikim në përputhje me vlerën totale të përlogaritur të kontratave.

**10.(Shfuqizuar).**

## **Neni 27**

### **Kontratat e mallrave**

1. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

2. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

5. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuar të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që p rokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të 15 vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose

c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

6. Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo

gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ndalohet të kualifikojë operatorët ekonomikë, që sipas LPP, janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, për furnizimin/blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar kontratat në masën 70%. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar duhet të ketë përfunduar kontratat në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të furnizimeve, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit.

## **Neni 28**

### **Kontratat e shërbimeve**

1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një 16 ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e

operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**5.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

**6.** Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

## **Neni 29**

### **Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote**

Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

## **Neni 30**

### **Kërkesat e cilësisë**

**1.** Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

**2.** Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

## **Neni 31**

### **Kriteret për vlerësimin e ofertës**

**1.** Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët.

**2.** Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë

dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

**3.** Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

- a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

## **KREU IV LLOJET DHE PËRZGJEDHJA E PROCEDURËS**

### **Neni 32**

#### **Llojet e procedurave të prokurimit**

- 1.** Në përzgjedhjen e kontratave publike, autoriteti kontraktor zbaton procedurat e prokurimit publik të përcaktuara në LPP.
- 2.** Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik janë:
  - a) Procedurë e hapur;
  - b) Procedurë e kufizuar;
  - c) Procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
  - ç) Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
  - d) Shërbim konsulence;
  - dh) Konkurs projektimi;
  - e) Kërkesë për propozime;
  - ë) Prokurim me vlerë të vogël.

### **Neni 33**

#### **Procedura e hapur**

- 1.** Procedura e hapur, sipas nenit 30 të LPP-së, është procedura e prokurimit që mund të përdoret nga çdo autoritet kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, me një vlerë mbi kufirin e ulët monetar, pa pasur nevojë të argumentojë përdorimin e kësaj procedure.
- 2.** Autoriteti kontraktor mund të zgjedhë procedura të tjera prokurimi, vetëm në raste të justifikuara, të parashikuara në LPP dhe në këto rregulla.
- 3.** Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të APP-së, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.
- 4.** Afati kohor për këtë procedurë i parashikuar në nenin 43 të LPP-së është si vijon:
  - a) Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati për paraqitjen e

ofertave është jo më pak se 52 (pesëdhjetë e dy) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.

b) Në procedurën e hapur, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 30 (tridhjetë) ditë nga dita kur është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.

c) Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim elektronik të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore për marrjen e ofertave të parashikuara në shkronjat “a” e “b”, mund të shkurtohen 7 (shtatë) ditë. c.1) Në procedurën e hapur për kontratat e punëve publike, me fond limit nga 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë deri 2 400 000 000 (dy miliardë e katërqind milionë) lekë, nuk do të aplikohet shkurtimi i këtij afati.

### **Neni 34**

#### **Procedura e kufizuar**

1. Procedura e kufizuar është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret vetëm në rrethanat e parashikuara në nenin 31 të LPP-së.

2. Autoriteti kontraktor në përzgjedhjen e kësaj procedure duhet të mbajë parasysh:

a) aspektet për natyrën e kontratës;

b) afatet;

c) kostot përkatëse në zbatimin e procedurës, të ndarë në dy faza;

ç) gjendjen e tregut;

d) numrin e pritshëm të ofertesve.

3. Në asnjë rast, vlera dhe përmasat e një kontrate nuk mund të jenë arsyeja e vetme për të justifikuar kompleksitetin e kontratës ose përzgjedhjen e procedurës së prokurimit. Kjo procedurë nuk duhet të përdoret për punë/mallra/shërbime, që gjenden lehtësisht në treg ose që kanë specifikime teknike apo standarde të përgjithshme e të mirënjohura në treg.

4. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të APP-së, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Ky njoftim përmban karakteristikat e kontratës dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për procedurën e prokurimit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit.

5. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat, në bazë të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

6. Afati kohor për këtë procedurë, i parashikuar në nenin 43 të LPP-së, është si vijon:

a) Në procedurën e kufizuar, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së. Ndërsa, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë te kandidatët.

b) Në procedurën e kufizuar, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së. Ndërsa, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data në të cilën është dërguar tek kandidatët ftesa për ofertë;

c) Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim elektronik, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet



kohore të parashikuara në shkronjat “a” e “b”, mund të shkurtohen 5 (pesë) ditë.

### **Neni 35**

#### **Procedura me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës**

1. Procedura me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret vetëm në rrethanat e parashikuara në nenin 32 të LPP.

2. Autoriteti kontraktor mund ta përdorë këtë procedurë në kushtet e mëposhtme:

a) Kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme mbi ose nën kufirin e ulët monetar janë dorëzuar vetëm oferta të pavlefshme. Oferta vlerësohet e pavlefshme nëse nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në çdo rast, pavlefshmëria e ofertave nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit kontraktor. Kushtet e kontratës dhe kriteret e veçanta të pranimit, që nuk lidhen përpjesëtimisht me fondin limit, nuk duhet të ndryshojnë nga ato të procedurës së fundit të anuluar.

b) Kur natyra e kontratës nuk mundëson përcaktimin e vlerës totale (p.sh., riparimi i një rrjeti kompleks shërbimi, infrastruktura komplekse transporti, projekt kompleks IT, që përfshin financime të strukturuar apo kontrata, ku vëllimi i punës që kërkohet nuk do të ishte i dukshëm deri në çastin kur kjo punë fillon). Në këtë rast, urdhri i prokurimit nuk përmban fondin limit.

c) Kur natyra e kontratës i shërben vetëm kërkimit, testimi ose zhvillimit dhe nuk ka lidhje me sigurimin e përfitimeve apo me rikuperimin e kostove të kërkimit e të zhvillimit.

ç) Kur natyra e kontratës është e tillë që specifikimet nuk përkufizohen me saktësi (p.sh., projekte komplekse IT ose ndonjë kontratë tjetër komplekse, me rëndësi të ngjashme, në infrastrukturë ose në teknologjitë e ndryshimit të shpejtë).

3. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 60 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

4. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të APP-së, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla.

5. Afati kohor për pjesëmarrje në këtë procedurë, i parashikuar në nenin 43 të LPP-së, është si vijon:

a) Në procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së. 20

b) Në procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.

c) Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim elektronik, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore të parashikuara në shkronjat “a” e “b” mund të shkurtohen 5 (pesë) ditë.

6. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat.

7. Autoriteti kontraktor mund të negociojë individualisht me secilin nga ofertuesit e përzgjedhur deri në përcaktimin e ofertës fituese.

### **Neni 36**

## **Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës**

1. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret vetëm në rrethanat e parashikuara në nenin 33 të LPP.

2. Autoriteti kontraktor mund ta përdorë këtë procedurë në kushtet e mëposhtme:

a) Kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme mbi ose nën kufirin e ulët monetar nuk është dorëzuar asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje. Kushtet e kontratës dhe kriteret e veçanta të pranimit, që nuk lidhen përpjesëtimisht me fondin limit, nuk duhet të ndryshojnë nga ato të procedurës së fundit të anuluar. Në çdo rast, mosdorëzimi i asnjë oferte apo kërkesë për pjesëmarrje nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit kontraktor.

b) Kur për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik. Ekzistenca e kushteve të mësipërme duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

c) Në rastin e një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. Në këtë rast, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:-

- Shkaktimi i -një ngjarjeje të paparashikuar;

- Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;

- Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë;

- Nuk është e mundur të ndiqen procedurat standarde mbi ose nën kufirin e ulët monetar. Në të gjitha rastet, autoriteti duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme apo situata emergjente nuk janë shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij. Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure. Kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar lidhjen e kontratave afatgjata, por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme. Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit.

ç) Kur mallrat prodhohen vetëm për qëllime kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi, me përjashtim të prodhimit në masë për qëllime tregtare apo për rikuperimin e kostove të kërkimit dhe të zhvillimit.

d) Kur për lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm, për zëvendësimin e pjesshëm të lëvrimeve 21 normale a të instalimeve apo si shtesë e mallrave ose instalimeve ekzistuese, ndryshimi i furnizuesit do ta detyronte autoritetin kontraktor të kërkonte mallra me karakteristika të ndryshme teknike, që mund të rezultojnë në papajtueshmëri dhe në vështirësi të mëdha teknike për vënien në punë apo mirëmbajtjen e tyre. Kontrata shtesë duhet të nënshkruhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i kontratës fillestare dhe vlera e saj nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare.

dh) Për kontratat e shërbimeve ose punëve, nëse nevoja për punë/shërbime shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga autoriteti kontraktor, dhe që nuk mund të ndahen, teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative ose kosto të mëtejshme për autoritetin kontraktor, por që janë të nevojshme për përfundimin e kontratës fillestare. Autoriteti kontraktor mund ta përdorë këtë dispozitë vetëm me kusht që kontrata të lidhet me kontraktorin që po zbaton kontratën dhe vlera e plotë e kontratës shtesë të mos tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare.

e) Për ndërtime apo shërbime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e ndërtimeve apo të shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, me të cilin autoriteti kontraktor ka lidhur kontratën fillestare, me kusht që këto ndërtime ose shërbime të përputhen me projektin

bazë, për të cilin është shpallur fitues i kontratës fillestare me procedurën mbi ose nën kufirin e ulët monetar. Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të përfshihet në njoftimin e kontratës fillestare dhe autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë koston e përgjithshme, të përlllogarit, të ndërtimeve ose shërbimeve në vijim. Procedura e mësipërme mund të përdoret vetëm brenda 3 viteve nga lidhja e kontratës fillestare. Në çdo rast, vlera e shtesave të kontratave nuk duhet të kalojë 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

ë) Shfuqizuar.

**3.** Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 60 të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure.

**4.** Me përjashtim të rrethanave të parashikuara në pikën 2, shkronja “b”, pikën 3, shkronja “b”, dhe pikën 5, të nenit 33 të LPP-së, autoriteti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë.

**5.** Kur autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, duhet të provojë se kandidatët plotësojnë minimalisht kërkesat e neni 22

### **Neni 36**

#### **Shërbimet e konsulencës**

**1.** Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 34/1 të LPP-së, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.

**2.** Përcaktimet e parashikuara në këtë nen janë njësoj të zbatueshme për konsulentin, si person fizik ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve. Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh ose me një marrëveshje nënkonsulence, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur. Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme të pranimit, ndërkohë kriteret e veçanta të pranimit plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

**3.** Autoriteti kontraktor, përveç kriterëve të përcaktuara në LPP, për skualifikimin e kandidatëve ose të ofertuesve duhet të vlerësojë edhe mbi kushtet e konfliktit të interesit, si vijon:

a) Konfliktin ndërmjet konsulentëve. Konsulentët nuk mund të ofertojnë me të njëjtën përbërje të stafit. Për këtë qëllim, anëtarët e stafit të një konsulenti duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e tyre për konsulentin dhe mosangazhimin në konsulentë të tjerë ofertues në të njëjtën procedurë.

b) Konfliktin ndërmjet veprimtarive të konsulencës dhe prokurimit të mallrave, punëve ose shërbimeve. Në këtë rast, operatori ekonomik i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për mallra, punë ose shërbime për një projekt dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga ofrimi i shërbimeve të konsulencës që lidhen me këto mallra, punë ose shërbime. Nga ana tjetër, konsulenti i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për përgatitjen ose zbatimin e një projekti dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohen nga furnizimi i mallrave, kryerja e punëve ose shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës) që rrjedhin ose janë të lidhura

drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës për këtë përgatitje ose zbatim.

c) Konflikti ndërmjet detyrave të konsulencës. As konsulentët dhe as ndonjëri prej anëtarëve të stafit të tyre nuk duhet të punësohen për kryerjen e ndonjë detyre që për nga natyra e saj mund të jetë në konflikt me një detyrë tjetër të konsulentëve.

ç) Marrëdhënien me stafin e autoritetit kontraktor: konsulentët (përfshirë stafin e tyre dhe nënkonsulentët) nuk duhet të kenë marrëdhënie biznesi ose familjare me një anëtar të stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejt ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

**4. Hapat e procedurës së shërbimit të konsulencës janë:**

a) Autoriteti kontraktor përgatit preventimin e kostos dhe buxhetit. Preventivi i kostos bazohet në vlerësimin që autoriteti kontraktor u bën burimeve që i nevojiten për të përmbushur detyrën: kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe inputi fizik. Kostot duhet të ndahen në dy kategori kryesore:

i) tarifat (ose shpërblimi);

ii) rimbursimet.

b) Titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, me të njëjtën përmbajtje, siç përcaktohet në nenin 60 të këtyre rregullave. Titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhër për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, siç përcaktohet në nenin 58 të këtyre rregullave. Në rastin e shërbimit të konsulencës, të gjithë anëtarët e komisionit duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet.

c) Njësia e prokurimit apo edhe struktura të specializuara duhet të hartojnë projektkontratën me përkufizime të qarta të objektivave, qëllimeve dhe të synimit të detyrës në fjalë dhe dokumentet e tenderit.

ç) Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të APP-së, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla.

d) Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për shprehjen e interesit përcaktohen në nenin 43 të LPP dhe konkretisht është, si vijon: 23 - Në procedurën e shërbimit të konsulencës, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për shprehje interesi është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së. - Në procedurën e shërbimit të konsulencës, me vlerë nën kufirin e lartë monetar afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për shprehje interesi është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së. Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim elektronik, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore të parashikuara në këtë shkronjë mund të shkurtohen 5 (pesë) ditë.

dh) Autoriteti kontraktor shqyrton kualifikimet e kandidatëve që kanë shprehur interes në bazë të kriterëve për kualifikim jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e hapjes së procedurës. Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përshihen në një listë të shkurtër, e cila duhet të përmbajë të paktën 2 (dy) kandidatë.

e) Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i bën kërkesë për propozime me shkrim kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër. Kërkesa për propozime përfshin:

i) ftesa, ku deklarohen qëllimi i autoritetit kontraktor për të nënshkruar kontratën për shërbimet e konsulencës, burimi i fondeve, hollësi të tjera për kandidatin, adresa, data, ora e përcaktuar për dorëzimin e propozimeve;

ii) udhëzimet për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni i nevojshëm që do t'i ndihmonte ofertuesit për përgatitjen e propozimeve, si dhe informacione për procesin e vlerësimit, metodologjinë, kriteret e vlerësimit e faktorët e rëndësishëm përkatës të tyre dhe pikët minimale për cilësinë;

iii) periudhën e vlefshmërisë së propozimit;

iv) kushtet e projektkontratës, që do të prokurohet;

v) afatet kohore për dorëzimin e propozimeve;

vi) formularin e sigurimit të ofertës (nëse kërkohet).

ë) Autoriteti kontraktor përcakton një afat kohor për dorëzimin e propozimeve, që u jep ofertuesve, kohë të mjaftueshme për të përgatitur propozimet e tyre. Afati kohor për dorëzimin e propozimeve teknike dhe ekonomike, i parashikuar në nenin 43 të LPP, është si vijon:

- Në procedurën e shërbimit të konsulencës, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë te kandidatët;

- Në procedurën e shërbimit të konsulencës, me vlerë nën kufirin e lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data në të cilën është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë. Gjatë kësaj kohe, ofertuesit mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në kërkesën për propozime. Autoriteti kontraktor i jep këto sqarime me shkrim dhe ua dërgon të gjithë kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor zgjat afatet kohore për dorëzimin e propozimeve.

i) Propozimet teknike dhe ekonomike duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë, në zarfe të veçanta, të mbyllura. Pas mbarimit të afateve kohore për dorëzim, nuk duhet të pranohet asnjë ndryshim i propozimeve teknike ose ekonomike. Zarfet, që përmbajnë propozimet teknike, hapen menjëherë pas mbarimit të afatit për dorëzimin e propozimeve, ndërkohë që propozimet ekonomike mbeten të pahapura. Çdo zarf që merret pas mbarimit të afatit, kthehet i pahapur.

ii) Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- përvojën e konsulentit;

- cilësinë e metodologjisë së propozuar;

- kualifikimet e stafit kryesor të propozuar;

- transferimin e njohurive, nëse kërkohet. Nëse nuk kërkohet, pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit "kualifikimet e stafit kryesor të propozuar. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 e, më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Minimumi i pikëve të propozimit teknik për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik është 70 pikë. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit. Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim. Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij. Autoriteti kontraktor vë në dijeni ofertuesit që kanë dorëzuar propozime për çdo vlerësim teknik me pikë për secilin konsulent. Në çdo rast, autoriteti kontraktor njofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim dhe i kthen të pahapura propozimet ekonomike. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor njofton konsulentët që kanë realizuar pikët minimale kualifikuese për datën, orën dhe adresën për hapjen e propozimeve ekonomike.

gj) Propozimet ekonomike hapen publikisht, në prani të përfaqësuesve të konsulentëve që marrin pjesë, vetë ose përmes telekonferencës apo mjeteve të tjera elektronike, nëse është e mundur.

Emri i ofertuesit, pikët e vlerësimit teknik dhe çmimet e propozuara lexohen me zë të lartë dhe regjistrohen gjatë hapjes së propozimeve ekonomike. Për vlerësimin në çmim përfshihen të gjitha pagesat e konsulentëve, si dhe shpenzimet e tjera si p.sh., shpenzimet për udhëtime, përkthimin, printimin e raporteve ose shpenzimet sekretariale. Propozimit me çmimin më të ulët i jepet vlerësimi financiar prej 100 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepen vlerësime financiare ku çmimet e tyre janë në përpjesëtim me çmimin më të ulët.

h) Vlerësimi përfundimtar total në pikë realizohet duke mbledhur pikët për cilësinë dhe koston. Pikët për “koston” caktohen duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit të kontratës së prokurimit, si dhe rëndësinë përkatëse të cilësisë.

i) Pas identifikimit të ofertës më të mirë, autoriteti kontraktor njofton ofertuesit për klasifikimin përfundimtar. Autoriteti kontraktor fillon bisedimet për të sqaruar dhe për të përmirësuar kushtet e kontratës, metodologjinë, përbërjen e stafit dhe kushtet e veçanta. Bisedimet nuk duhet t'i ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet fillestare të kontratës ose propozimin e përzgjedhur. Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

j) Kur ofertuesi i suksesshëm nuk arrin të nënshkruajë kontratën ose nuk arrin të bëjë sigurimin e kontratës, autoriteti kontraktor fton për lidhjen e kontratës ofertuesin vijues në klasifikimin e ofertuesve.

k) Në rast se kontrata lidhet me një bashkim operatorësh, të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve duhet të nënshkruajnë kontratën dhe të jenë, individualisht dhe bashkërisht, përgjegjës për detyrën.

## **Neni 38**

### **Konkursi i projektimit**

1. Konkursi i projektimit është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 35 të LPP, nëpërmjet së cilës autoriteti kontraktor përzgjedh një studim ose projekt, që ka vetëm natyrë estetike.

2. Konkursi i projektimi mund të organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik ose vetëm për përfitimin e një projekti.

a) Në rastin kur autoriteti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar.

b) Në rastin kur autoriteti kontraktor organizon konkurs projektimi, si pjesë të një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese për shërbime, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje 25 paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatin e suksesshëm të dalë në përfundim të konkursit të projektimit.

c) Në çdo rast, në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor duhet të bëjë të njohur qëllimin e tij për të marrë vetëm një projektide apo për të marrë projektide dhe shërbimin në lidhje me këtë projektide.

ç) Përveç kriterëve përjashtuese, të parashikuara në ne 26 propozimeve. Zarfet, që përmbajnë propozimet, hapen menjëherë pas mbarimit të afatit për dorëzimin e propozimeve. Çdo zarf që merret pas mbarimit të afatit, kthehet i pahapur.

e) Vlerësimi i propozimeve kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre dhe u komunikohet ofertuesve pjesëmarrës. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim. 4. Komisioni i vlerësimit duhet të përbëhet nga një numër tek anëtarësh (zakonisht shtatë), pjesëtarë ose jo të autoritetit kontraktor dhe ku shumica duhet të kenë të njëjtën licencë ose specializim të përcaktuar në kërkesat për kualifikim të

kandidatëve në dokumentet e tenderit, si dhe një përvojë 10 vjeçare në çështjet e projektit që do të prokurohet.

### **Neni 39**

#### **Kërkesa për propozime**

1. Kërkesa për propozim, sipas nenit 34 të LPP-së, është një procedurë prokurimi, e cila përdoret për kontratat me vlerë nën kufirin e ulët monetar, por mbi 800.000 (tetëqind mijë) lekë.
2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të APP-së, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla.
3. Afati kohor minimal për dorëzimin e ofertave është 10 (dhjetë) ditë nga data, në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.
4. Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.
5. Shqyrtimi i ofertave dhe njoftimi i klasifikimit të ofertuesve duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i ofertave.

### **Neni 40**

#### **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël**

1. Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë / mallra/ shërbim, kur vlera e përlllogaritur është më e ulët se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.
2. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar.
3. Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.
4. Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës duhet të përlllogaritë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që u drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit.
5. Në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël kryhet me mjete elektronike, anëtarët e komisionit ftojnë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, kur është e mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë për çdo të interesuar, në sistemin e prokurimit elektronik. Në çdo rast, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet autoritetit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet të njoftojë autoritetin kontraktor brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë. Në njoftim duhet të jepen arsyet, që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit. Autoriteti kontraktor mund të refuzojë ofertën e paraqitur nga një

operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël, të zhvilluar nga ky autoritet gjatë këtij viti, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim. Në çdo rast, autoriteti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e dhjetë të klasifikimit. Afati i fundit për pranimin dhe hapjen e ofertave nuk duhet të jetë ditë pushimi (e shtunë, e diel, festa zyrtare). Duke qenë se procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë procedura të thjeshtuara, për këto procedura nuk zbatohen përcaktimet e nenit 56, të LPP-së, për ofertat anomalisht të ulëta dhe përcaktimet e nenit 63, të LPP-së, për ankimin administrativ. Kryerja e procedurës me mjete elektronike të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

**6.** Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përlogaritur e mallrave dhe shërbimeve nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në të tilla raste emergjente ose ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimet mund të kryhen edhe nga persona që nuk janë anëtarë të komisionit.

**7.** Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë.

**8.** Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.

## **Neni 40/1**

### **Sistemi dinamik i blerjes**

Sistemi dinamik i blerjes është një sistem tërësisht elektronik që mund të përdoret për blerje të përsëritura. Ky sistem është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, që regjistrohen në sistemin e prokurimit elektronik dhe operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet. Autoriteti kontraktor përdor sistem të thjeshtuar të blerjes dinamike për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, në përputhje me udhëzimet e APP-së.

## **KREU V**

### **MARRËVESHJA KUADËR**

#### **Neni 41**

##### **Përkufizimi i marrëveshjes kuadër**

Marrëveshje kuadër quhet një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve kontraktore dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara.

#### **Neni 42**



### **Palët në marrëveshjen kuadër**

1. Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet:

- a) disa autoriteteve kontraktore dhe disa opera-torëve ekonomikë;
- b) disa autoriteteve kontraktore dhe një opera-tori ekonomik;
- c) një autoriteti kontraktor dhe disa operatorëve ekonomikë.
- ç) një autoriteti kontraktor dhe një operatori ekonomik.

2. Autoritetet kontraktore që kanë për qëllim të lidhin një marrëveshje kuadër duhet të përcaktohen në njoftimin e procedurës së prokurimit. Nuk është e lejueshme të përdorin një marrëveshje kuadër autoritetet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër. Të gjithë operatorët ekonomikë, që janë pjesë e marrëveshjes duhet të listohen në marrëveshje dhe nuk është e lejueshme të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë në marrëveshje, pas përfundimit të procesit të prokurimit.

### **Neni 43**

#### **Qëllimi**

Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen dhe nuk ka siguri për kohën e dorëzimeve/realizimeve e të ekzekutimit të kontratave. Ndryshimi ndërmjet një marrëveshjeje kuadër dhe kontratave të tjera që lidhen sipas procedurave të prokurimit të parashikuara në LPP është se kushtet e mallrave/shërbimeve/punëve, që do të prokurohen, nuk janë të përcaktuara në një marrëveshje kuadër. Autoritetet kontraktore mund të blejnë vetëm për të plotësuar nevojat e tyre dhe jo për nevoja të autoriteteve kontraktore që nuk janë pjesë në marrëveshjen kuadër.

### **Neni 44**

#### **Detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja kuadër**

Një marrëveshje kuadër është ligjërisht e detyrueshme për të dyja palët. Autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të prokurojnë një sasi të caktuar mallrash/shërbimesh/punësh të përfshira në marrëveshje. Por, në çdo rast gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, autoritetet kontraktore nuk lejohen të blejnë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra /shërbime/punë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, pasi kjo do të konsiderohej një shkelje e marrëveshjes. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të zbatojnë kontratën sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej autoriteteve kontraktore.

### **Neni 45**

#### **Prokurimi i marrëveshjes kuadër**

1. Marrëveshja kuadër prokurohet sipas këtyre rregullave. Ajo mund të lidhet vetëm pasi autoritetet kontraktore të kenë kryer një procedurë të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence ose me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Në kontratat sektorale autoritetet kontraktore mund të përdorin gjithashtu procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.

3. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në

përputhje me LPP-në dhe këto rregulla.

#### **Neni 45/1**

##### **Përlllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër**

1. Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përlllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.
2. Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t'u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përlllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.

#### **Neni 46**

##### **Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër**

1. Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se katër vjet.
2. Në raste të jashtëzakonshme, plotësisht të justifikueshme, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër mund të jetë më e gjatë se katër vjet.

#### **Neni 47**

##### **Llojet e marrëveshjes kuadër**

1. Marrëveshja kuadër mund të lidhet me:
  - a) një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
  - b) disa operatorë ekonomikë kur:
    - të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
    - jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.
2. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatitë ofertën e tij vetëm në lidhje me kushtet për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një kontratë bazuar në 30 marrëveshjen kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla.
3. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, të lidhura me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Në rast të përdorimit të kësaj lloji marrëveshjeje, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Kjo lloji marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të

përcaktohet një operator ekonomik fitues. Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë, nëse të tre operatorët ekonomikë i kanë përmbushur të gjitha kriteret e përzgjedhjes. Në rast të kundërt, autoritetet kontraktore mund të lidhin marrëveshje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy. Në përfundim të afateve të ankimit, operatorët ekonomikë të kualifikuar në marrëveshjen kuadër renditen sipas kriterit të vlerësimit. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla.

**4.** Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuar nuk konsiderohen kontrata, sipas LPP-së. Në rast të përdorimit të kësaj lloji marrëveshjeje, autoriteti kontraktor për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër, duhet të rihapë konkurrimin. Autoriteti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese gjatë rihapjes së konkurrimit mund të jenë të njëjta si ato të marrëveshjes kuadër ose autoriteti kontraktor mund të përdorë kritere të tjera me kusht që ato të jenë të përcaktuara në dokumentet fillestare të marrëveshjes kuadër. Këto kritere mund të jenë çmimet për volume të caktuara, informacion për konsulentat për një shërbim intelektual, koha e nevojshme për dorëzim ose orët e nevojshme për kryerjen e punimeve specifike. Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, për përzgjedhjen e fituesit për kontratat bëhet në formë të shkruar ose elektronike (e-mail, fax etj) dhe, në çdo rast, duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës. Forma e komunikimit përzgjidhet nga autoriteti kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për të ruajtur konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave, deri në vlerësimin përfundimtar të tyre. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet t'u dërgojë, në të njëjtën kohë, ftesën për ofertë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër. Kjo lloji marrëveshjeje kuadër nuk është e zbatueshme në rastet e kontratave sektoriale. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla.

## **Neni 47/1**

### **Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër**

**1.** Kontratat mund të jepen mbi bazën e marrëveshjes kuadër përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së saj. Periudha e vlefshmërisë së kontratave të lidhura mbi bazën e një marrëveshjeje kuadër mund të kalojë periudhën e vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

**2.** Në rastin e marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, gjatë rihapjes së konkurrimit autoriteti kontraktor është i detyruar të krijojë një komision vlerësimi për dhënien e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër. Nuk është e nevojshme që përbërja e komisionit të jetë e njëjtë me atë të komisionit të vlerësimit të ofertave, të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

**3.** Dhënia e kontratave në bazë të një marrëveshjeje kuadër të realizuar nga një autoritet kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës do të bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.

**3.1** Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet kontraktor, njoftimi i

kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik, nga autoriteti kontraktor. Ky njoftim do të dërgohet në formë të shkruar dhe elektronike (CD), jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim.

**3.2** Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik nga autoriteti kontraktor, në cilësinë e organit qendror blerës. Ky njoftim do të dërgohet në formë të shkruar dhe elektronike (CD), jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim.

**4.** Sasitë e parashikuara janë vetëm “sasi orientuese”. Autoriteti kontraktor mund të blejë më pak ose më shumë se sasitë e parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër).

**5.** Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të formojë një bashkim operatorësh ekonomikë dhe të paraqesë ofertë për një kontratë, pasi është bërë palë e kësaj marrëveshjeje kuadër.

**6.** Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të caktohet si nënkontraktor i një operatori ekonomik tjetër, që i është dhënë kontrata sipas së njëjtës marrëveshjeje kuadër.

**7.** Nëse një operator ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër, nuk përmbush më kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues në këtë marrëveshje, është i detyruar të njoftojë autoritetin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga momenti i ndodhjes së një ndryshimi të tillë. Në rast se autoriteti kontraktor konstaton mospërmbushjen e këtij detyrimi, duhet të veprojë në përputhje me nenin 47, të LPP-së..

#### **Neni 47/2**

##### **Ndryshimi në numër i palëve të marrëveshjes kuadër**

Nëse para mbarimit të marrëveshjes kuadër, të nënshkruar me disa operatorë ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, mbetet vetëm një operator ekonomik, autoriteti kontraktor nuk duhet të japë kontrata sipas kësaj marrëveshjeje kuadër. Kur lind një situatë e tillë, autoriteti kontraktor është i detyruar të njoftojë menjëherë operatorin ekonomik të mbetur në marrëveshjen kuadër. Vlefshmëria dhe efektiviteti i marrëveshjes kuadër pushojnë së ekzistuari me këtë njoftim. Në rast se një operator ekonomik nuk i përgjigjet dy herë radhazi ftesës së autoritetit kontraktor gjatë rihapjes së konkurrimit, ky operator nuk do të jetë më palë e marrëveshjes kuadër.

#### **KREU VI**

##### **PROKURIMI I KONTRATAVE SEKTORIALE**

#### **Neni 48**

##### **Autoritetet kontraktore që kryejnë procedura për kontratat sektoriale**

**1.** Autoritetet kontraktore që kryejnë veprimtari në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar do të zbatojnë dispozitat e këtij kreu dhe rregullave të përgjithshme për prokurimin publik, pavarësisht nëse ato operojnë në bazë të një të drejte ekskluzive apo të veçantë.

**2.** Këtyre rregullave mund t'i nënshtrohen edhe entet private. Në këtë rast, enti privat duhet, detyrimisht, të kryejë veprimtari në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar mbi bazën e një të drejte të veçantë ose ekskluzive të lëshuar nga një autoritet kompetent i

Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet çdo klauzole legislative, rregullatore apo administrative.

**3.** E drejtë e veçantë ose ekskluzive do të thotë një e drejtë që e kufizon të drejtën për kryerjen e veprimtarisë në fjalë, duke ua dhënë atë vetëm një apo më shumë shoqërive tregtare. Kjo e drejtë duhet ta vendosë entin në një pozicion monopoli ose oligopoli, në mënyrë që të mund t'ua kalojë kostot klientëve, meqenëse ata nuk do të kenë alternativë tjetër. Përveç kësaj, e drejta ekskluzive ose e veçantë duhet, gjithashtu, të ketë një ndikim të madh të sipërmarrjet e tjera që duan të kryejnë të njëjtin veprimtari dhe ta bëjë të vështirë, si nga ana ligjore ashtu dhe nga ana praktike, hyrjen e shoqërive tregtare të tjera në të njëjtin sektor, në të njëjtën zonë gjeografike. Nëse një e drejtë e veçantë ose specifike mund të merret nga të gjitha entet që e kërkojnë atë, këto shoqëri tregtare nuk u nënshtrohen këtyre rregullave, pasi ato operojnë në një treg konkurrues.

**4.** Entet private, që kryejnë veprimtari në sektorët e shërbimit ujour, energjetik, transportit dhe atij postar pas fitimit të një kontrate prokurimi, nuk u nënshtrohen këtyre rregullave edhe në rastet kur ato përfundojnë në një pozicion monopolistik ose oligopolistik.

## **Neni 49**

### **Kontratat sektoriale**

**1.** Kontratat sektoriale janë kontrata publike, të lidhura nga autoritetet kontraktore për qëllime të kryerjes së secilës prej veprimtarive të mbuluara nga sektorët e shërbimit ujour, energjetik, transportit dhe atij postar. Veprimtaritë e mbuluara nga rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale janë vetëm ato veprimtari që janë përcaktuar shprehimisht në LPP dhe që i ofrojnë një shërbim publikut.

**2.** Autoritetet kontraktore që prokurojnë mallrat/shërbimet/punët për kontrata sektoriale zbatojnë këto rregulla. Këto rregulla do të zbatohen edhe për rastet kur një autoritet kontraktor organizon një konkurs projektimi për të operuar në këto sektorë. Si rregull, autoriteti kontraktor do të zbatojë rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale për të gjitha blerjet, për sa kohë që objekti që do të prokurohet do të përdoret vetëm për veprimtaritë e kontratave sektoriale. Autoriteti kontraktor nuk mund të përdorë rregullat e këtij kreu për të prokuruar mallra/shërbime/punë, të cilat nuk janë planifikuar për t'u përdorur në sektorët e shërbimit ujour, energjetik, transportit dhe atij postar.

## **Neni 50**

### **Sektorët e shërbimit ujour, energjetik, transportit dhe atij postar**

**1.** Sektori i shërbimit energjetik mbulon ofrimin ose përdorimin e rrjeteve fikse që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime në lidhje me prodhimin, transportin apo shpërndarjen e energjisë elektrike, të gazit apo të nxehtësisë ose furnizimin me energji elektrike, gaz apo nxehtësi ndaj këtyre rrjeteve. Përbën përjashtim dhënia e kontratave sektoriale për furnizimin me energji elektrike, nxehtësi ose karburante për përdorim për prodhimin e energjisë. Kontrata të tilla nuk ka nevojë të prokurohen. Entet private mbulohen nga rregullat vetëm nëse ato operojnë në sektorin e energjisë, pas dhënies së një të drejte të veçantë ose ekskluzive.

**2.** Veprimtaritë, që përfshijnë shfrytëzimin e një zone gjeografike për qëllime eksplorimi me mundësinë për të nxjerrë naftë, gaz, qymyr apo karburante të tjera të ngurta, u nënshtrohen rregullave për kontratat sektoriale. Nëse entet private operojnë në atë zonë, ato përfshihen vetëm nëse atyre u është dhënë një e drejtë e veçantë ose ekskluzive.

**3.** Veprimtaritë, që përfshijnë shfrytëzimin e zonave gjeografike me qëllim ofrimin e aeroporteve dhe të porteve detare ose tokësore ose të strukturave të tjera të terminaleve për transportuesit ajrorë, detarë apo të ujërave tokësore, u nënshtrohen rregullave të sektorëve të shërbimeve

publike. Nëse entet private janë pronarë dhe operojnë në këtë zonë, ato përfshihen vetëm nëse u është dhënë një e drejtë e veçantë ose ekskluzive.

**4.** Veprimtaritë ujore u përkasin sektorëve të shërbimeve publike, nëse ato kanë të bëjnë me ofrimin ose përdorimin e rrjeteve publike fikse të prodhimit, të transportit a të shpërndarjes së ujit të pijshëm apo furnizimin me ujë të pijshëm ndaj rrjeteve. Kontratat e akorduara për punime inxhinierike hidraulike, vaditje dhe drenazhim u nënshtrohen gjithashtu rregullave të kontratave sektoriale, nëse volumi i ujit të përdorur për furnizim me ujë të pijshëm është jo më tepër se 20% e volumit të përgjithshëm të ujit. Ndjekja e veprimtarive për largimin ose trajtimin e ujërave të zeza konsiderohet, gjithashtu, pjesë e sektorit ujor, nëse veprimtaria kryhet nga një autoritet kontraktor, i cili operon gjithashtu në sektorin e ujit të pijshëm. Kontratat për furnizimin me ujë të pijshëm janë të përjashtuara dhe mund të prokurohen pa konkurrim.

**5.** Ofrimi dhe operimi i rrjeteve të synuara për ofrimin e një shërbimi ndaj publikut në fushën e transportit me hekurudhë, sistemeve automatike, tramvajeve, autobusëve elektrikë, shërbimeve me autobus ose teleferik u nënshtrohen rregullave të shërbimeve publike. Një rrjet konsiderohet se ekziston atëherë kur shërbimi ofrohet sipas të njëjtave kushteve të vendosura nga një autoritet kompetent. Kushtet përfshijnë itineneraret që do të shërbehen, kapacitetet që do të bëhen të disponueshme ose shpeshtësinë e shërbimit. Sektori i transportit publik nuk mbulon transportimin e mallrave, meqenëse këto transporte nuk u nënshtrohen kushteve të funksionimit të parashtruara nga një autoritet kompetent. Autoriteti kontraktor, që operon në transportin e mallrave, mbulohet në të kundërt nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik. Enteve private që operojnë në transportin e mallrave nuk u duhet të ndjekin ndonjë prej rregullave të prokurimit publik. Këto rregulla nuk janë të zbatueshme nëse shërbime të rregullta transporti mund të ofrohen prej agjencive të tjera të transportit në të njëjtën zonë gjeografike dhe në të njëjtat kushte. Sektori i transportit nuk përfshin edhe transportin publik që nuk është i mbuluar nga disa kushte funksionimi të caktuara, si transportin me autobusë privatë nga njëri qytet në tjetrin apo transportet private ndërkombëtare me autobus.

**6.** Shërbime postare quhen ato shërbime që kanë të bëjnë me zhdoganimin, klasifikimin, përcaktimin e itinerareve dhe dorëzimin e artikujve postarë. Kur autoriteti kontraktor ofron shërbime postare, edhe shërbime të tjera që kanë lidhje me to janë të mbuluara nga rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale. Nëse një enti privat i nevojitet një e drejtë e veçantë ose ekskluzive për të operuar një shërbim postar, ai është gjithashtu i mbuluar nga këto rregulla.

## **Neni 51**

### **Prokurimi që përfshin disa veprimtari të ndryshme**

Një autoritet kontraktor mund t'u nënshtrohet si rregullave të përgjithshme të prokurimit publik, ashtu edhe rregullave të prokurimit të kontratave sektoriale të këtij kreu. Kjo do të thotë që një autoritet kontraktor, në disa raste, duhet t'u përmbahet klauzolave të rregullave të përgjithshme dhe më pas të zbatojë klauzolat e këtij kreu, kur prokuron për një lloj tjetër veprimtarie. Në këto raste, do të përdoren rregullat për veprimtarinë kryesore për të cilën kontrata është e paracaktuar. Në disa raste, autoriteti kontraktor operon në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, transportit dhe atij postar, si dhe kryen veprimtari që nuk mbulohen nga rregullat e prokurimit të kontratave sektoriale.

## **Neni 52**

### **Kontratat e lidhura për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta**

Kontratat sektoriale të lidhura nga autoriteti kontraktor për qëllime të rishitjes apo dhënies me

qira palëve të treta nuk mbulohen nga rregullat e prokurimit publik, nëse nuk ekziston një e drejtë e veçantë ose ekskluzive në lidhje me objektin e kontratës. Kushti për përjashtim është që autoriteti kontraktor në asnjë mënyrë nuk i përpunon produktet, por vetëm i blen dhe i shet ato, pa pasur ndonjë të drejtë ekskluzive.

## **Neni 53**

### **Sipërmarrjet e lidhura**

1. Sipërmarrjet e lidhura përfshijnë mallrat, shërbimet dhe punimet. Përjashtimi ka të bëjë me faktin që për blerjet nga të ashtuquajturat sipërmarrje të lidhura (në parim, shoqëria tregtare nënë, motër dhe nëndegë të shoqërisë tregtare) apo brenda një bashkimi operatorësh, nuk është e nevojshme të prokurohen sipas rregullave të këtij kreu. Vetëm autoriteti kontraktor që kryen veprimtari në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, transportit dhe atij postar mund ta përdorë përjashtimin.

2. Sipërmarrjet e lidhura janë subjekt i xhiros mesatare të shitjeve të punimeve, furnizimeve ose kontratave të shërbimit të shoqërisë tregtare gjatë tri viteve të mëparshme. Të paktën 80% e xhiros duhet të vijë nga furnizimi i të njëjtave mallra/shërbime/punime që do të prokurohen, shoqërive tregtare me të cilat ajo është e lidhur. Autoriteti tjetër kontraktor mund të shesë deri në 20% të produkteve/shërbimeve/punimeve në fjalë në tregun e hapur. Kufizimi është hartuar për t'ua parandaluar shoqërive tregtare konkurrimin me shoqëri tregtare të tjera dhe për të shijuar përfitimet e të operuarit vetëm e pa konkurrencë për furnizimin e bizneseve me pozicion monopolistik ose oligopolistik. Nëse më tepër se një shoqëri tregtare e lidhur me autoritetin kontraktor ofron mallra/punë/shërbime të njëjta ose të ngjashme, është e domosdoshme të llogaritet duke iu referuar xhiros totale të të gjithave shoqërive tregtare të lidhura. Nëse xhiroja e krijuar nga shoqëritë tregtare të jashtme i kalon vlerën 20%, përjashtimi nuk është i zbatueshëm.

3. Kur shoqëritë tregtare të reja nuk kanë xhiro të tri viteve të fundit për ta paraqitur, këto shoqëri tregtare, në vend të kësaj, mund të përmbushin kërkesat që të paktën 80% të shitjeve t'i kenë bërë te shoqëritë tregtare të lidhura. Kjo do ta bënte më të lehtë përdorimin e këtij përjashtimi për grupet e reja të biznesit, si edhe për degët e sapoformuara.

4. Në mënyrë që të lehtësojnë bashkëpunimin në projektet madhore, autoritetet kontraktore që operojnë në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, transportit dhe atij postar mund të formojnë të ashtuquajturit bashkime operatorësh. Bashkimet e operatorëve mund të blejnë mallra /shërbime/punime nga njëri prej autoriteteve kontraktore që janë partnerë, pa e shpallur kontratën për konkurrim. Kushti është që autoritetet kontraktore të kenë formuar bashkimin e operatorëve ekskluzivisht për të kryer një veprimtari në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, transportit dhe atij postar.

## **Neni 54**

### **Sistemet e kualifikimit**

1. Autoritetet kontraktore në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, transportit dhe atij postar mund të krijojnë dhe të zbatojnë një skemë të veçantë për parakualifikimin e furnitorëve, një sistem kualifikim. Qëllimi i një sistemi kualifikimi është të kursejë kohë kur një autoritet kontraktor blen rregullisht disa mallra/shërbime/punime të caktuara. Sistemi zëvendëson fazën e parë të një procedure me përzgjedhje ose të negociuar dhe duhet të përmbajë kritere përzgjedhjeje që zakonisht u vihen furnitorëve në fazën e parë të prokurimit. Kriteret e përzgjedhjes duhet t'u bëhen të disponueshme të gjithë furnitorëve të interesuar.

2. Të gjithë operatorët ekonomike, që kërkojnë të përfaqësohen dhe që përmbushin kriteret e

përzgjedhjes do të përfshihen në sistem. Aplikimet do t'i dorëzohen autoritetit kontraktor, i cili duhet ta shqyrtojë aplikimin brenda gjashtë muajve. Një operator ekonomik, të cilit i janë refuzuar aplikimet, do të njoftohet për arsyet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit. Një operator ekonomik që është pranuar në sistem mund të përjashtohet vetëm për arsye të shprehura në rregullat e sistemit.

**3.** Kur duhet të prokurohen mallra/shërbime, autoriteti kontraktor mund t'i drejtohet drejtpërdrejt operatorit ekonomik në listë, pa pasur nevojë të shpallë blerje me konkurrim. Autoritetit kontraktor nuk i duhet të pyesë të gjithë operatorët ekonomikë të përfshirë në listë, por i duhet që gjithmonë të pyesë ata operatorë ekonomikë që kanë aftësinë për të përmbushur kontratën specifike.

## **Neni 55**

### **Procedura me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës**

**1.** Një autoritet kontraktor mund të akordojë kontrata sektoriale, nëpërmjet procedurës me negociim, pa shpallje të njoftimit të kontratës, në rastet kur:

a) nuk është dorëzuar asnjë ofertë apo nuk ka asnjë ofertë a aplikim të përshtatshëm në përgjigje e të procedurës së hapur, të kufizuar ose të negociuar me shpallje paraprake të njoftimit, me kusht që të mos ketë ndryshime thelbësore të kushteve fillestare të kontratës. Nëse nuk dorëzohen oferta si rezultat i gabimeve në dokumentet standarde të tenderit, dhe/ose si rezultat i një veprimi të autoritetit kontraktor, dhe/ose nëse është e nevojshme të bëhen ndryshime thelbësore në kushtet e kontratës, atëherë duhet të organizohet një procedurë e re e hapur ose e kufizuar. Autoriteti kontraktor duhet të ndërmarrë masat e nevojshme në mënyrë që të korrigjojë veprimet, që kanë shkaktuar dështimin e procedurës.

b) Për arsye teknike ose artistike apo për arsye që kanë lidhje me të drejtat ekskluzive të pronësisë intelektuale, kontrata mund të ekzekutohet vetëm nga një operator ekonomik i veçantë. Ky kusht përmbushet vetëm në rastin e prokurimeve për të cilat nuk ka konkurrim në treg dhe kur ky i fundit certifikohet nga autoriteti kompetent. Për sa u përket arsyeve teknike, duhet të jetë vetë rezultati që vetëm një operator është në gjendje të ofrojë, e jo procesi. Përjashtimi është i zbatueshëm këtu vetëm në rast se ekziston një e drejtë ekskluzive. Situata është e njëjtë edhe në rastin e përjashtimit për arsye artistike. Nëse disa artistë mund ta kryejnë kontratën, për këtë duhet organizuar një konkurrim.

c) Për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor, i parashikuar në nenin 43 të LPP për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim me shpallje, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Për të argumentuar përdorimin e një procedure me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, për shkak të një emergjence ekstreme, duhen përmbushur katër kushtet e mëposhtme:

- Duhet të ekzistojë një ngjarje objektivist e paparashikueshme, jo vetëm e paparashikueshme prej autoritetit kontraktor;

- Ngjarja nuk duhet t'i atribuohet autoritetit kontraktor; - Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të komunitetit në tërësi;

- Duhet të jetë e pamundur të ndiqet procedura standarde (e hapur, e kufizuar ose e negociuar me shpallje të njoftimit). Autoriteti kontraktor duhet të provojë, të justifikojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme ose situata emergjente nuk janë pasojë e veprimit apo mosveprimit të tij. Neglizhenca ose vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk do të merren



parasysh si shkaqe që mund të justifikojnë zbatimin e kësaj procedure. Kjo procedurë nuk do të zbatohet për të justifikuar përfundimin e kontratave afatgjata, por vetëm për të përballuar situatën emergjente. Në rast emergjence, autoriteti kontraktor do të marrë njëkohësisht të gjitha masat për kryerjen e procedurave normale të prokurimit.

ç) Një kontratë shpallet fituese bazuar në marrëveshjen kuadër, me kusht që të respektohen kërkesat e nenit 58/9 të LPP-së. Një autoritet kontraktor duhet të përdorë procedurën e hapur, të kufizuar ose me negociim me shpallje të njoftimit të kontratës kur prokuron një marrëveshje kuadër në sektorët e shërbimit publik. Nëse marrëveshja kuadër është prokuruar në bazë të rregullave të LPP-së, autoritetit kontraktor nuk i duhet të publikojë njoftim të kontratës për kontratat e përgatitura sipas kësaj marrëveshjeje kuadër.

d) Kur kemi të bëjmë me furnizime shtesë nga furnitori fillestar, të konsideruara qoftë si zëvendësim i pjesshëm i furnizimeve normale apo i instalimeve ekzistuese ose si zgjerim i furnizimeve aktuale, ku një ndryshim i furnitorit do të detyronte autoritetin kontraktor të blinte materiale që do të kishin specifikime të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në mospërputhshmëri ose në vështirësi të mëdha teknike gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Në këtë rast, kontrata shtesë do të nënshkruhet brenda një kufiri kohor prej 3 (tre) muajsh nga përfundimi i kontratës fillestare dhe vlera e saj nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare. Ky përjashtim nuk mund të përdoret si një justifikim për mosshpalljen e kontratës për konkurrim. Autoriteti kontraktor duhet të provojë, të arsyetojë dhe të dokumentojë se një ndryshim i furnitorit do të rezultonte në mospërputhshmëri ose në vështirësi të mëdha teknike. Neglizhenca ose vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk do të vlerësohen si shkaqe që justifikojnë zbatimin e kësaj procedure.

dh) Kur kemi të bëjmë me furnizime të kuotuar dhe të blera në tregun e mallrave të përdorimit të gjerë. Ky përjashtim bëhet sepse operatori ekonomik e ka dhënë tashmë çmimin më të mirë. Për këtë arsye, nuk është i nevojshëm një tjetër konkurrim.

e) Kur kemi të bëjmë me blerje me leverdi, kur është e mundur të prokurohen furnizime duke shfrytëzuar një mundësi veçanërisht të mirë, të disponueshme vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, me një çmim shumë më të ulët se çmimet normale të tregut. Çmimet e disponueshme duhet të jenë shumë më të ulëta sesa është normalisht e mundur të negociohen me një operator ekonomik normal.

ë) Kur kemi të bëjmë me blerje të furnizimeve me kushte veçanërisht favorizuese, qoftë nga një furnitor që mbyll përfundimisht veprimtarinë e biznesit të tij, qoftë nga përfituesit apo likuiduesit e një falimentimi, nga një marrëveshje me kreditorët ose nga një procedurë e ngjashme, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare në fuqi.

f) Kur kemi të bëjmë me punime apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, bëhen të domosdoshme për ecurinë e punimeve apo shërbimeve të përshkruara në kontratë, me kusht që kontrata t'i akordohet operatorit ekonomik që është duke i kryer këto punime a shërbime, për sa kohë që vlera totale e kontratave të akorduara për punimet dhe shërbimet shtesë nuk e kalon 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare, kur këto punime ose shërbime: - nuk mund të ndahen teknikisht apo ekonomikisht nga kontrata fillestare pa shkaktuar probleme të mëdha për autoritetin kontraktor; - megjithëse mund të ndahen nga kryerja e kontratës fillestare, ato janë tepër të domosdoshme për 37 përfundimin e saj.

g) Kur bëhen punime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e punimeve të ngjashme që i besohen operatorit ekonomik, me të cilin autoriteti kontraktor ka lidhur kontratën fillestare, me kusht që këto punime apo shërbime të jenë në përputhje me një projekt bazë, për të cilin është

lidhur kontrata fillestare, mbi bazën e një procedure prokurimi. Sapo projekti i parë është gati për tender, përdorimi i mundshëm i kësaj procedure do të bëhet i ditur në njoftimin e kontratës për kontratën fillestare dhe vlera e përafërt totale e shpenzimeve të punimeve do të merret parasysht nga autoriteti kontraktor. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm gjatë 3 (tri) viteve që pasojnë përfundimin e kontratës origjinale. Në asnjë rast, kontrata shtesë nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm në rast se është përmendur dhe përshkruar paraprakisht në njoftimin e kontratës bazë të prokurimit. Ajo është një lloj mundësie dhe autoriteti kontraktor mund të zgjedhë nëse do ta përdorë atë apo jo. Kushtet, si çmimi, duhet të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit. Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës së parë, AKP-ja duhet ta bëjë llogaritjen me vlerën e plotë të secilit prej këtyre punimeve shtesë.

## **KREU VII ZYRTARËT E PROKURIMIT DHE ZHVILLIMI I PROCEDURAVE**

### **Neni 56**

#### **Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar**

Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysht në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

### **Neni 57**

#### **Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit**

1. Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdher të veçantë personin/ personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik. Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit. Në varësi të numrit të procedurave të prokurimit të parashikuara për t’u zhvilluar, autoriteti kontraktor mund të caktojë më shumë se një person përgjegjës për prokurimin.

2. Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të pa ktën 38 një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoritetit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë. Në rast mungese personeli, autoriteti

kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm. Përveç sa më sipër, autoriteti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore.

**3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:**

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
  - Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;
  - Hartimin e urdhrit të prokurimit;
  - Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;
  - Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
  - Hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi, duke argumentuar përzgjedhjen e tyre;
  - Administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti; - Llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti;
  - Në kuadër të hartimit të dokumenteve të tenderit, bashkërendimin e punës me APP-në, me qëllim realizimin e kësaj detyre me efikasitetin dhe në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi;
  - Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;
  - Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;
  - Përcjelljen pranë APP-së të raportimeve mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, në rastet kur kërkohet, si dhe të raportimit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës.
- 4. Specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme:**
- Hartimin e specifikimeve teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera;
  - Përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
  - Hartimin e kritereve të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik;
  - Hartimin e kritereve të vlerësimit, nëse është rasti;
  - Përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i livrimit). Në rast se detyrat e sipërpërmendura nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet.

## **Neni 58**

### **Komisioni i vlerësimit të ofertave**

Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi

të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

## **Neni 59**

### **Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës**

1. Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme.
2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
  - a) çmimet e tregut; ose/dhe
  - b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
  - c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

## **Neni 60**

### **Urdhri i prokurimit**

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

## **Neni 61**

### **Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit**

1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit.
2. Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit. Nëse gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, përpara publikimit të një procedure prokurimi, njësia e prokurimit ka 40 nevojë për asistencë, komunikon me APP-në për të marrë një mendim të specializuar. Me qëllim dhënien e asistencës, ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e

mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, APP-ja në koordinim me personin/at përgjegjës për prokurimin mund të asistojë këto të fundit gjatë përgatitjes të dokumenteve të tenderit në përputhje me dokumentet standard të tenderit dhe rregullat e prokurimit publik. Për efekt shpejtësie, komunikimi me APP-në për koordinimin e veprimtarisë gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe marrjes së asistencës mund të bëhet me mjete elektronike (me e-mail). Afatet dhe procedura e detajuar e koordinimit të veprimtarisë së njësisë të prokurimit me APP-në në funksion të marrjes së asistencës dhe ngritjes së kapaciteteve rregullohen me udhëzim të APP-së.

**3.** Pas nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, personi/at përgjegjës për prokurimin dërgon/jnë dokumentet e tenderit për publikim, në përputhje me nenet 38 e 39 të LPP-së.

**4.** Autoriteti kontraktor mund t'i japë çdo operatori ekonomik të interesuar, kundrejt kërkesës, një kopje të dokumenteve të tenderit në përputhje me nenin 41 të LPP-së.

**5.** Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, publikimi i njoftimit të kontratës dhe dokumenteve të tenderit do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

## **Neni 62**

### **Ndryshimi i dokumenteve të tenderit**

Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 (pesë) ditë për prokurimet me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë dhe me 10 (dhjetë) ditë për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, në përputhje me nenin 42 të LPP-së.

## **Neni 63**

### **Dorëzimi i ofertave**

**1.** Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor, të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktor nuk shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe i kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit. Përveç sa më sipër, operatorët ekonomikë mund të jenë të pranishëm, nëse e kërkojnë, në procesin e hapjes së ofertave.

**2.** Në rastin kur procedura e prokurimit është me një fazë, zarfi i mbyllur duhet të përmbajë kualifikimet e kandidatit/ofertuesit, ofertën teknike, nëse përfshihet, dhe ofertën ekonomike. Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, në fazën e parë të kualifikimit, zarfi duhet të përmbajë vetëm dokumentet e kualifikimit, siç parashikohet në dokumentet e tenderit. Në fazën e dytë e në vijim, operatori ekonomik duhet të dorëzojë zarfin me ofertën teknike dhe zarfin me ofertën ekonomike. Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

**3.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.

## **Neni 64**

### **Hapja e ofertave**

**1.** Komisioni i vlerësimit të ofertave hap dhe lexon ofertat në përputhje me nenin 52 të LPP dhe me përcaktimet në këto rregulla.

**2.** Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave

nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës. Nëse evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.

**3.** Anëtarët e njësisë së prokurimit, që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve të tenderit, mund të jenë të pranishëm gjatë fazës së hapjes dhe të vlerësimit, por nuk kanë të drejtë të votojnë ose të ndikojnë në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japin mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe të kryejnë funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve.

**4.** Komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Më pas lexohet me zë të lartë oferta ekonomike dhe lista e dokumenteve ligjore, administrative dhe kualifikuese të paraqitura nga ofertuesi. Procesverballi dhe një vërtetim, që pasqyron të gjitha dokumentet, që shoqërojnë ofertën e tij duhet t'i vihet në dispozicion në bazë të kërkesës çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesve që kanë paraqitur ofertë, por që nuk janë të pranishëm ose të përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'u dërgohet njoftim për hapjen e procedurës. Oferta ekonomike nënshkruhet në pjesën e pasme të fletës nga të gjithë anëtarët e komisionit.

**5.** Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 12 të LPP-së.

## **Neni 65**

### **Ndërhyrja në ofertë**

Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën procedurë prokurimi. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

## **Neni 66**

### **Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave**

**1.** Pas hapjes dhe leximit të ofertës, siç përcaktohet më lart, komisioni i vlerësimit të ofertave, nëse gjykon se i nevojitet më shumë se një ditë pune për të përfunduar veprimtarinë e tij, vë në dijeni përfaqësuesit për orën dhe datën kur ofertuesve do t'u komunikohet rezultati i vlerësimit të ofertës, që përfshin atë teknike, nëse ka të tillë, ekonomike, si dhe klasifikimin përfundimtar.

**2.** Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

**3.** Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson

ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

**4.** Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

- Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se  $\pm 2\%$  e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

**5.** Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.

- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së.

**6.** Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e kandidatit dhe listën e të gjitha dokumenteve të kualifikimit, të paraqitura prej tij. Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, komisioni i vlerësimit përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për ofertën dhe ia komunikon këtë informacion menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje. Kandidatëve të kualifikuar, në përfundim të afateve të ankimit, u dërgohet një ftesë për ofertë, në përputhje me nenin 40 të LPP-së. Më pas, komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik. Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo çmim anomalisht të ulët sipas përcaktimeve në pikat 4 dhe 5, të këtij neni. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal. Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton renditjen përfundimtare, e cila duhet të komunikohet në kohën e njoftuar, por , në çdo rast, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e dorëzimit të ofertave.

**7.** Në rastin e procedurave me negociim, me ose pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në varësi të kompleksitetit të kontratës, komisioni mund të zhvillojë negociatën në faza të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës. Afati 10 (dhjetë)- ditor i parashikuar në pikat 2 dhe 6, të këtij neni, nuk zbatohet në këto raste.

**8.** Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë

fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.

#### **Neni 67**

##### **Klasifikimi i ofertave**

Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla.

#### **Neni 68**

##### **Raporti përmbledhës**

Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/ mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/ vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave.

#### **Neni 69**

##### **Njoftimi i fituesit**

Pas miratimit të raportit përmbledhës, autoriteti kontraktor dërgon për publikim në faqen e internetit të APP-së dhe Buletinën e Njoftimeve Publike njoftimin e fituesit në përputhje me nenin 58 të LPP-së.

#### **Neni 70**

##### **Lidhja e kontratës**

Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor.

#### **Neni 71**

##### **Publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar**

Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti kontraktor dërgon për publikim në faqen e internetit të APP-së dhe Buletinën e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar.

#### **Neni 72**

##### **Zhvillimi i procedurave me mjete elektronike**

Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, procedura e hapjes dhe e vlerësimit të ofertave do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

### **KREU VIII**

### **KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR ZBATIM**



## **Neni 73**

### **Mungesa e konkurrencës**

1. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e 44 vlefshme. Në të kundërt, autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit.
2. Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim nga njësia e prokurimit.

## **Neni 74**

### **Bashkimi i operatorëve ekonomikë**

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.
2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
4. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet.
5. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

## **Neni 75**

### **Nënkontraktimi**

1. Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t'ua transferojnë kontratën palëve të treta. Autoriteti kontraktor lejon në veçanti nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomikë.
2. Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nënkontraktimi, si dhe nëse autoriteti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit.
3. Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.
4. Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit.
5. Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 45 të LPP-së, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.
6. Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori të kriterëve të kërkuara, autoriteti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues.
7. Gjatë ekzekutimit të kontratës autoriteti kontraktor duhet të kontrollojë nëse pjesa e kontratës, e marrë përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori, po realizohet nga ky i fundit. Në rast se autoriteti kontraktor konstaton se nënkontraktori nuk po realizon pjesën e kontratës së marrë përsipër i kërkon kontraktorit kryesor të ndërpresë nënkontraktimin dhe të vijojë me zbatimin e kontratës.

## **KREU IX EKZEKUTIMI DHE MBIKËQYRJA E KONTRATËS**

### **Neni 76**

#### **Kohëzgjatja e kontratës**

1. Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shumëvjeçare.. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.
2. Autoriteti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur ose kërkesë për propozim.
3. Vetëm në rrethana të argumentuara, të shpallura në njoftimin e kontratës, që lidhen ngushtësisht me natyrën, kompleksitetin dhe financimin e saj, autoriteti kontraktor mund të lidhë një kontratë shumëvjeçare, nëse: - objekti i tyre është blerja, qiraja ose blerja me këste e mallrave, me ose pa mundësinë e kalimit të pronësisë, shërbimeve, që zgjat deri në pagimin e plotë të vlerës ose derisa pronësia t'i kalojë autoritetit kontraktor; - është kontratë komplekse, që kërkon financim shumëvjeçar ose të strukturuar, e cila nuk mund të zbatohet brenda vitit buxhetor (si për shembull, projektet komplekse në infrastrukturë) dhe ku financimi i saj është i garantuar. -objekti i tyre është furnizim me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në varësi të kërkesës së autoritetit kontraktor, të sasisë së përcaktuar të kërkuar, si dhe të çmimit

të bursës, sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri.

4. Autoritetet kontraktore, për plotësimin e nevojave me mallra dhe shërbime të vazhdueshme, në fillim të çdo viti, lejohen të zgjasin afatin e kontratës së fundit të lidhur pas përfundimit të një procedure konkurruese, nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate shtesë me të njëjtin kontraktues, deri sa të kryhen procedurat e prokurimit. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë në mënyrë të detajuar nevojën për zgjatjen e kontratës. Kontrata shtesë për mallrat apo shërbimet e vazhdueshme mund të bëhet deri në një vlerë maksimumi 20% të kontratës së fundit të lidhur pas përfundimit të një procedure konkurruese dhe fondet për këtë kontratë do të përballohen nga fondet e vëna në dispozicion të autoritetit kontraktor në buxhetin e atij viti. Në çdo rast, edhe pse nuk realizohen me procedurë prokurimi, planifikimi dhe realizimi i këtyre kontratave shtesë me vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimit 46 publik.

## **Neni 77**

### **Mbikëqyrja e kontratës**

1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

2. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

4. Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një ko pje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.

5. Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

6. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe

cilësinë e mallit të livruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori.

## **KREU X**

### **SHQYRTIMI I ANKESAVE**

#### **Neni 78**

##### **Ankesat në autoritetin kontraktor**

**1.** Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP-në, mund ta kundërshtojë këtë vendim.

**2.** Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen 47 e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP-së. Në rastin e procedurave me mjete elektronike, procesi i pezullimit bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

**3.** Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëlqes së pretenduar. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet. Nëse mungon ndonjëri nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet nga zyrtari përkatës. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 48 (dyzet e tetë) orëve pas njoftimit, ajo vlerësohet si e paparaqitur. Formulari i ankesës është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, të cilat janë të publikuara në faqen e internetit të APP-së.

**4.** Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-së. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP-së. Autoriteti kontraktor duhet të nxjerrë një vendimi brenda 3 (tri) ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 63, pika 6, të LPP-së.

**5.** Gjatë procedurës së prokurimit, ankesat kundër vendimeve të autoritetit kontraktor duhet të dorëzohen fillimisht pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme punës nga data kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për këtë shkelje të ligjit.

**6.** Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përrjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.

b) Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankesën dhe

për të ndihmuar komisionin/zyrtarin e ngarkuar për shqyrtimin e saj.

c) Vendimi në lidhje me ankesën duhet të merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e saj. Nëse kërkohet informacion tjetër nga ankimuesi, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri pasi autoriteti kontraktor ta sigurojë këtë informacion.

ç) Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave. Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor i komunikohet me shkrim ankimuesit. Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës i komunikon vendimin ankimuesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formul arin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit.

d) Autoriteti kontraktor, nëse nevojitet, duhet të zgjatë afatin kohor të procedurës së prokurimit aq sa zgjat periudha e pezullimit. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.

7. Për procedurat e prokurimit që nuk bëhet njoftim publik, sipas nenit 38 të LPP-së, nuk zbatohen dispozitat lidhur me procedurat e ankimit administrativ.

## **KREU XI**

### **SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MASAT DISIPLINORE**

#### **Neni 79**

##### **Sanksionet administrative**

1. Mosrespektimi i rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e LPP-së, kur përbën kundërvajtje administrative dënohet me gjobë, si më poshtë vijon:

a) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 20 000 deri 1 000 000 lekë;

b) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 15 000 deri në 30 000 lekë;

c) Mospërmbushja e detyrimit për formën e komunikimit, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, të përcaktuar në nenin 21, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 100 000 lekë; ç) Mospërmbushja e detyrimit të parashikuar në nenin 23, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë;

d) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 25, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

dh) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 28, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 1 000 000 lekë;

e) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 33, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 1 000 000 lekë; ë) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 38, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;

f) Mospërmbushja e njërit prej detyrimeve të përcaktuara në nenet 39, 40, 41 e 42, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë;

g) Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në nenin 43, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 500 000 lekë;

- gj) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 45, me përjashtim të shkronjës “ë”, të pikës 2, të këtij neni, dhe në nenin 46, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 30 000 deri në 500 000 lekë; h) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në shkronjën “ë”, të pikës 2, të nenit 45, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë;
- i) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 53, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë; j) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 56, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;
- k) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 63, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;
- l) Personat, që përpiqen të ndikojnë në vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me nenin 19/7, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.
- 2.** Në dhënien e masës administrative duhet të mbahen parasysh rrethanat, pasoja dhe roli i zyrtarit 49 në shkelje dhe, në çdo rast, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
- 3.** Kundër vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, personat e interesuar mund të bëjnë ankim në gjykatën kompetente.
- 4.** Autoriteti kontraktor përkatës ka përgje-gjësinë për vjeljen e gjobave të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni.
- 5.** Autoriteti kontraktor përkatës ka detyrimin të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik për zbatimin e masave të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, brenda afatit kohor të përcaktuar prej saj.

## **Neni 80**

### **Sanksionet për mosbashkëpunim**

- 1.** Refuzimi i autoritetit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe/ose Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë.
- 2.** Kundër vendimit të dënimit me gjobë, personat e interesuar mund të bëjnë ankim në gjykatën kompetente.

## **Neni 81**

### **Masat disiplinore**

- 1.** Në të gjitha rastet, kur personat përgjegjës nuk dënohen me gjobë sipas pikës 1, të nenit 79, si dhe në çdo rast tjetër të shkeljes së dispozitave të LPP-së apo këtyre rregullave, APP-ja propozon dhënien e masave disiplinore ndaj tyre.
- 2.** Në dhënien e masës disiplinore duhet të mbahen parasysh rrethanat, pasoja dhe roli i zyrtarit në shkelje dhe, në çdo rast, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
- 3.** Autoriteti kontraktor përkatës ka detyrimin të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik për zbatimin e masave të vendosura sipas pikës 1 të këtij neni, brenda afatit kohor të përcaktuar prej saj.

## **Neni 82**

### **Përgjegjësia penale**

Sanksionet administrative dhe masat disiplinore nuk përjashtojnë përgjegjësinë penale të personit përgjegjës për shkeljet.

## **KREU XII MANUALET DHE TRAJNIMI**

### **Neni 83**

#### **Manualet shpjeguese dhe trajnimi**

- 1.** APP-ja harton udhëzime dhe manuale shpjeguese për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore gjatë kryerjes së veprimtarive të prokurimit.
- 2.** Në fillim të çdo viti, APP-ja, në bazë të të dhënave apo kërkesave të autoriteteve kontraktore, planifikon nevojat e trajnimit të zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik.
- 3.** APP-ja vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera trajnimi dhe formimi profesional, që kanë ekspertizë në praktikat më të mira të BE-së në fushën e prokurimit, planifikon dhe ndërmerr trajnimet e nevojshme në funksion të përmirësimit të zbatueshmërisë së LPP, këtyre rregullave dhe udhëzimeve në procedurat e prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Dispozita tranzitore**

Procedurat e prokurimit të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi të vazhdojnë sipas rregullave të prokurimit publik, në bazë të të cilave ato janë shpallur.

**V E N D I M**  
**Nr. 918, datë 29.12.2014**

**PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË MËNYRË  
ELEKTRONIKE**

**I azhurnuar me:**

- VKM Nr.796, Datë 29.12.2017

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 1, e 75, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Të gjitha procedurat e prokurimit zhvillohen me mjete elektronike.
2. Përfshihen nga pika 1, e këtij vendimi:
  - a) (shfuqizuar)
  - b) faza e dytë e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence” dhe “Konkursprojektimi”;
  - c) (shfuqizuar)
- ç) procedurat e prokurimit me objekt “Blerja e energjisë elektrike”.
3. Vendimi Nr. 45, datë 21.1.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, të ndryshuar, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrë udhëzimet përkatëse në zbatim të pikës 1, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

**EDI RAMA**



## VENDIM

Nr. 521, datë 20.9.2017

### **PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE PËR KRYETAR DHE ANËTARË TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 19/2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidatave për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik për garantimin e profesionalizmit e të transparencës gjatë përzgjedhjes, mbështetur në kritere profesionale, për të përmbushur detyrat e përcaktuara në ligjin për prokurimin publik.
2. Përzgjedhja e kandidatave për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura të konkurrencës, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.
3. Procedura përzgjedhëse për kandidatët për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik zhvillohet nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe në përputhje me pikën 3, të nenit 19/2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ngrre një komision *ad-hoc*, të përbërë nga 3 anëtarë, nga të cilët një përfaqësues i Kryeministrit, një përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike dhe një përfaqësues i Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.
5. Anëtari i komisionit *ad-hoc* zgjidhet midis personave që plotëson këto kritere:
  - a) Të ketë mbaruar arsimin e lartë.
  - b) Për anëtarin përfaqësues të Kryeministrit dhe të Departamentit të Administratës Publike, të ketë punuar për jo më pak se 5 (pesë) vjet në nivel të mesëm drejtues dhe/ose të ketë njohuri në fushën e prokurimeve.
  - c) Për anëtarin përfaqësues të Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune dhe të ketë titull/gradë shkencore.
  - ç) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
  - d) Të mos ketë qenë anëtar i partive politike për 3 (tre) vitet pararendëse nga data e emërimit.
  - dh) Të mos ketë qenë i dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë.
  - e) Të mos jetë larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore.
6. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Kryeministrit, në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe të paktën dy herë në 2 gazeta me tirazhin më të lartë dhe ajo përmban:
  - a) kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushin kandidatët, sipas parashikimeve të nenit 19/3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006;
  - b) listën e dokumenteve që duhen paraqitur;
  - c) afatin e fundit dhe adresën ku duhet të paraqiten aplikimet;
  - ç) datën për shpalljen e rezultateve pas vlerësimit të dosjes;
  - d) datën për shpalljen e rezultateve për vlerësimin përfundimtar;
  - dh) mënyrën e njoftimit/komunikimit me aplikantët.
7. Komisioni *ad-hoc* i përzgjedhjes bën vlerësimin e kandidatave të paraqitura brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendrike nga data e mbylljes së aplikimeve, bazuar në jetëshkrimin e kandidatëve dhe intervistën e tyre me gojë. Nëse numri i kandidatave të paraqitura është i lartë, atëherë vlerësimi i tyre nga komisioni mund të zgjatet, por jo më shumë se 20 (njëzet) ditë kalendrike.

**8.** Fillimisht, komisioni *ad-hoc* i përzgjedhjes bën vlerësimin e dosjeve të aplikantëve, për të parë nëse ato plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni 19/3, i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, të ndryshuar. Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni *ad-hoc* përgatit listën me emrat e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për t'u emëruar dhe i njofton ata brenda 2 (dy) ditëve.

**9.** Komisioni *ad-hoc* i përzgjedhjes vazhdon me vlerësimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 19/3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006. Vlerësimi maksimal është 100 pikë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas një procedure që përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e mëposhtme:

a) vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, të përvojës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, deri në 70 pikë, sipas pikës 11, të këtij vendimi;

b) intervistën e strukturuar me gojë, deri në 30 pikë.

**10.** Çdo anëtar i komisionit *ad-hoc* të përzgjedhjes jep vlerësimin e tij individual për secilin kandidat. Vlerësimi përfundimtar për kandidatin llogaritet si mesatare e pikëve të vendosura nga secili prej anëtarëve.

**11.** Metoda e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve do të jetë si më poshtë vijon:

**11.1.** Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili do të kryhet në bazë të:

a) diplomës së shkollës së lartë:

i. jurist: 10 pikë;

ii. inxhinieri, ekonomik: 8 pikë;

iii. diplomë e nivelit master, doktoraturë etj.:

nga 2 deri në 5 pikë shtesë;

iv. certifikata apo kualifikime të tjera:

3 deri në 10 pikë.

b) Përvojës në punë, që duhet të jetë 8 (tetë) vjet:

10 pikë, si dhe:

i. përvojës mbi 8 (tetë) vjet:

nga 2-5 pikë shtesë;

ii. përvojës në pozicione drejtuese:

nga 2-5 pikë shtesë;

iii. përvojës si gjyqtar, ndërmjetësues apo arbitër:

2-5 pikë shtesë.

c) Përvojës në prokurime, që duhet të jetë 3 (tre) vjet:

10 pikë, si dhe:

i. mbi 3 vjet:

2 pikë shtesë;

ii. 5-10 vjet:

5 pikë shtesë;

iii. mbi 10 vjet:

10 pikë shtesë.

**11.2.** Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve për kryetar të Komisionit të Prokurimit Publik, që do të kryhet në bazë të:

a) diplomës së shkollës së lartë, jurist: 10 pikë, si dhe:

i. për diplomën e nivelit master, doktoraturë etj.:

deri në 3 pikë shtesë;

ii. për certifikatën apo kualifikimet e tjera:

deri në 3 pikë shtesë.

b) Përvojës në punë, që duhet të jetë 8 (tetë) vjet:

10 pikë, si dhe:

i. mbi 8 (tetë) vjet përvojë pune:

2 pikë shtesë;

ii. përvojë si gjyqtar, ndërmjetësues apo arbitër:

2-5 pikë shtesë.

c) Përvojës 2 (dy) vjet në pozicione drejtuese:

10 pikë, si dhe:

i. përvojës në nivelin e lartë drejtues (TND):

2 pikë shtesë;

ii. përvojës mbi 2 vjet:

nga 2 deri në 5 pikë shtesë.

ç) Përvojës në prokurime, 3 (tre) vjet:

10 pikë, si dhe:

i. mbi 3 vjet:

2 pikë shtesë;

ii. 5-10 vjet:

5 pikë shtesë;

iii. mbi 10 vjet:

10 pikë shtesë.

**12.** Në përfundim të vlerësimit, komisioni *ad-hoc* i përzgjedhjes rendit kandidatët në bazë të pikëve të marra dhe ia dërgon listën Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për vendimarrje

të mëtejshme nga Këshilli i Ministrave. Me qëllim vijimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, Këshilli i Ministrave dërgon në Kuvend listën e kandidatëve të kualifikuar sipas renditjes dhe listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për t'u emëruar.

**13.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, që, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, të nisë procedurat për ngritjen e komisionit *ad-hoc* të përzgjedhjes së kandidaturave për kryetar dhe anëtarë të KPP-së, në përputhje me pikën 4 të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI**

**Senida Mesi**

**VENDIM**  
**Nr. 81, datë 14.2.2018**

## **PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHEFUNKSIONIMIN E AGJENCISË SËBLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

### **VENDOSI:**

#### **I. KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË SË BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

1. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në vijim “Agjencia”, organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Brendshëm, në vijim ministri, me seli në Tiranë.
2. Agjencia, si organ qendror blerës, i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, ka si mision kryerjen e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës.
3. Agjencia ka buxhetin e vet, i cili është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Brendshme.
4. Agjencia ka stemën dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.
5. Agjencia drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj Agjencie dhe përgjigjet para ministrit.
6. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri.
7. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm.
8. Shërbimet mbështetëse dhe ato të buxhetit e të financës për Agjencinë realizohen nga strukturat përgjegjëse për këto funksione në Ministrinë e Brendshme.
9. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
10. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të punonjësve të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E AGJENCISË**

**11. Agjencia kryen detyrat, si më poshtë vijon:**

**11.1. Në rastin kur kryen procedura prokurimi për të nënshkruar marrëveshje kuadër:**

- a) zhvillon procedurat e prokurimit deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër;
- b) përlllogarit fondin limit për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen;
- c) unifikon specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendës a të huaj, dhe harton katalogët e standardeve, të cilët miratohen me udhëzim të ministrit;
- ç) shqyrton ankesat e operatorëve ekonomikë deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër;

d) në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa për kryerjen e procedurës së prokurimit, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, Agjencia verifikon arsyet e vonësës, shpall procedurën e re të prokurimit për këto kërkesa dhe njofton Agjencinë e Prokurimit Publik;

dh) monitoron, në çdo kohë, zbatimin e kontratave nga autoritetet kontraktore dhe për këtë qëllim harton një raport për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, një kopje e të cilit i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

**11.2** Në rastin kur Agjencia kryen procedura prokurimi për të lidhur kontratë, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Zhvillon procedurat e prokurimit të përqendruar të mallrave dhe të shërbimeve deri në shpalljen e fituesit;

b) Bashkërendon punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike që do të zhvillojë si organ qendror blerës;

c) Unifikon specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendës a të huaj, dhe harton katalogët e standardeve, të cilët miratohen me udhëzim të ministrit;

ç) Verifikon përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi;

d) Përlllogarit fondin limit për përcaktimin e të dhënave sasiore për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen, para publikimit të tenderit, dhe vë në dijeni autoritetet kontraktore;

dh) Shqyrton ankesat e operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit;

e) Në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa për kryerjen e procedurës së prokurimit, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, Agjencia verifikon arsyet e vonësës, shpall procedurën e re të prokurimit për këto kërkesa dhe njofton Agjencinë e Prokurimit Publik;

ë) Monitoron në çdo kohë zbatimin e kontratave nga autoritetet kontraktore. Në përfundim të monitorimit harton një raport për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, një kopje e të cilit i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

### **III. DISPOZITA TË FUNDIT**

**12.** Për nëpunësit civilë aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara, në rastin e ristrukturimit të institucionit, zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil.

**13.** Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

**14.** Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**